



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Pranimi Kë/Dana 24-01-2023

Nr./ organit Org.broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vrednuesi
01-060	01-08		



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008) dhe të nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, në nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e I të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **31.01.2023 (e Martë)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Kuvendit Komunal
2. Informatë(raport) për punën e kryetarit të komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2022.
3. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2022.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2023.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planeve të punës së komiteteve, komitetit për Shërbime publike, komiteti për Lirit të Drejtat Njeriut dhe Barazi Gjinore, komitetit për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale, komitetit për Planifikim rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtjen e Mjedisit, komitetit për Arsime Kulturë, Rini dhe Sport të gjitha planet për vitin 2023.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023.

Viti, më 24.01.2023





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË NJËMBDHJETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 28.12.2022 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari, z.Hasan Aliu; si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Ramadan Deliu, z.Sokol Shaqiri, z.Basri Sylejmani, znj.Valentina Mehmeti, z.Zejnepe Osmani, z.Ali Bajrami, z.Ekrem Ymeri, z.Arbnora Hajredini, z.Jakup Demiri, z.Liridona Bislimi, z.Sejdi Emiri, z.Nexhat Halili, z.Remzi Salihu, z.Durim Sylejmani, znj.Lindita Demelezi, z.Majlinda Shabani, z.Musli Neziri, znj.Vilsona Maliqi-Salihu, znj.Zyrafete, z.Veton Ramadani, znj.Anisë Zejnullahu, z.Reshat Azizi, ndërsa mungoi znj.Taibe Ibrahim, z.Sokol Hyseni, z.Taulant Haxhiu. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, zyrat e kryetarit, mediat elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e njëmbdhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, i nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive, zyre të informimit, media, qytetarë të Komunës së Vitisë, po fillojmë seancën e rregullt të kuvendit komunal të fundit për vitin 2022. Para se të ja fillojmë, kisha kërkua nga të gjithë të pranishmit të nderojmë me një minut heshtje për Jakup Jahirin, i cili ka ndrru jetë. I ndjeri ka qenë kryetar i kuvendit për një mandat. Për veprën e ti që ka qenë i palodhshëm për çështje kombëtare, si kryesues i kuvendit kërkoj një minut heshtje. Nderim jetës dhe veprës së Jakup Jahirit. Fillimisht dua të ju falënderoj për punën, për angazhimin gjatë gjithë vitit, për kontributin e dhënë nga të gjithë ju, për të gjitha çështjet që i kemi ngrit, për të gjitha çështjet që i kemi diskutu në interes të qytetarëve, në interes të vendit. Ju falënderoj për të gjitha votimet, propozimet për të gjitha punët që i kemi krye së bashku uroj që festat e fundvitit t'i kalojmë mirë, uroj që edhe në vitin e ardhshëm të kemi shëndet të mirë, të kemi punë më të mbarë për të gjithë popullin, të gjithë komunën. Në këtë urim të fundvitit i uroj edhe mërgimtarëve të cilët janë tu ardh shumë për festat e fundvitit. Ju urojmë që edhe ata të kalojnë sa më mirë në vendlindje. Gjatë kësaj periudhe kemi pasë një pjesë të mirë të akteve që është kthyer konfirmimi i ligjshmërisë, kemi te taksat, ngarkesa dhe gjoba. Na është kthyer prap një përmirësim që kjo të del në rend të ditës. Çështja e vendimit për obeliskun e “Medelin Olbright” nuk është në harmoni me planin zhvillimor na është kthyer që e kemi prapë te pikat e rendit të ditës, që do ta diskutojmë para se të hyn në rend të ditës. Tu e pas parasysh që është edhe fundi i vitit, besoj që të jemi më të shkurt, të jemi më të kthyer, se është edhe pjesa e pasditës debati publik i kryetarit, duhet ta lirojmë sallën. Para se të hy në rend të ditës, hapi debat. Kemi pas komitetin e kalum nga znj.Liridona është kërkua një informatë e shkurtë për 16 ditshin e dhunës gjinore.

znj.Merrushe Ahmeti, drejtoresha: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Sot ndjehem e nderuar dhe e vlerësuar që prej meje është kërkuar një raport i tillë, i cili praktikisht flet shumë për juve. Ashtu si në mbarë botën, qysh prej vitit 91, ashtu edhe ne jemi munduar me shënu me aktivitete të ndryshme, mirëpo normalisht që këto aktivitete ju kanë përshtatur kontestit tonë. Qëllimi 16 ditor i dhunës nuk mbetet vetëm 16 ditë për ne, mirëpo normalisht që ne mundohemi përmes aktiviteteve të ndryshme gjatë tërë vitit të shënohet ashtu si në mbarë botën këto 16 ditë hapen diskutimet me qëllimin që të kemi eliminim të dhunës gjinore. Më lejoni të ju prezantoj me aktivitetet që janë mbajtur për nder të 16 ditshit, nga punonjësi i shërbimit social z.Shaqir Zuka në bashkëpunim me zyrtarin e policisë, z.Muhamet Ajeti, ka mbajtur ligjërata me nxënësit e shkollës “Jonuz Zejnullahu” në Viti, në “Kongresin e Manastirit” Pozheran, në shkollën “Njazi Rexhepi” në Sllatinën e Epërme. Po ashtu në gjimnazin “Kuvendi i Lezhës” në Viti dhe në shkollën fillore në Trestenik. Më lejoni të citoj se, këto janë bërë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe në bashkëpunim me DKA-në në Komunën e Vitisë. Ajo çka i ka dhanë përmbushje kësaj ligjërata është pjesëmarrja edhe e policisë, ku së bashku zyrtari i shërbimit social me z.Muhamet Ajetin i kanë paraqitë para nxënësve këndvështrimet nga ana e tyre profesionale. Po ashtu përmes komunikimit të drejtpërdrejt me nxënësit është synuar që të përcillet mesazhi që, dhuna nuk është zgjidhje dhe janë përcjellur mënyra e komunikimit dhe raportimit të dhunës. Më lejoni po ashtu të citoj se, çka bëjmë ne si Komunë e Vitisë. Me raste të tilla Komuna e Vitisë participon me pagesë në strehimoren e Gjilanit, në kuadër të Qendrës për Punë Sociale dhe të DSHMS-së ne ofrojmë këto shërbime, si: asistim social, këshillim psikosocial, ofrimi i mundësisë së kontaktit prindër fëmij, po ashtu dhe në bazë të nevojave shëndetësore, mirëpo ajo çka dua me cek është se, këto shërbime ofrohen në bazë të kontekstit të rastit. Nuk vlejnjë asnjëhere të njëjtat për secilin person, mirëpo veprohet në bazë të rastit. Ne bashkëpojmë me organizata të ndryshme, më saktësisht me programet e tyre që ju përshtaten personat të cilët kanë nevojë për shërbime sociale. Punonjësit e shërbimit social në Komunën e Vitisë janë në kujdestari, ata janë 24 orë në dispozicion. Një falënderim të veçantë, se ata bëjnë një punë shumë të madhe dhe shumë humane, mbi të gjitha duke ofruar shërbime, pavarësisht mungesave të shumta teknike që ata i hasin në punën e tyre. Statistikat të cilat janë në komunën e Vitisë sa i përket dhunës në bazë gjinore të raportuar, statistikat janë shumë të mirëseardhura në punën time dhe i dua shumë veçanarisht në marrjen e vendimeve dhe paraqitjen e problemeve, mirëpo më lenë me dyshu në statistikat të cilat janë faktikisht i kemi për momentin 48 raste prej muajit Janar deri në muajin Dhjetori, ku 35 janë gra dhe 13 burra. Kjo është një statistikë, nëse e zberthejmë me përqindje është një përqindje e vogël, mirëpo ndoshta lë shumë për të dëshiruar në qoftëse qasemi më fell, ndoshta është numri shumë më i madh sa që është kjo. Është e trishtë rastet e fundit që i kemi parë nëpër media, viktimat e dhunës, mënyrat se si kanë përfunduar, por është edhe më e trishtë akoma ku këto gjëra bëhen dhe thirren në emër të moralit, religjionit ose në kuadër të shoqërisë patriarkale, padyshim që gjeja më me vlerë e një njeriu është liria, dhe çdo njëri në shoqëri ka vlerë për ne, prandaj neve na mbetet shumë punë për përmisimin e mirëqenies së tyre. Pasi që jemi në fundvit, kisha shpreh dëshirën të ja uroj festat e fundvitit dhe ju uroj një vit sa më të mbarë.

z.Ali Bajrami: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Një here shfrytzojë edhe rastin të gjithë qytetarëve të Komunës së Vitisë dhe të Republikës së Kosovës të ju uroj festat e fundvitit. Unë për këtë seancë kam dy pyetje, njëra është për drejtorin e bujqësisë, me na informu sa është vlera e përgjithshme e subvencioneve me të cilat është mbështetur fermeri vitias, dhe pyetja e dytë shkon për Drejtorinë e Arsimit. Drejtoreshë, është shpërnda nëpër shkolla rregullorja: a është rregullore që ka psu ndonjë ndryshim apo është rregullorja e vjetër e 2014 por vetëm që keni kërku që të implementohet? Faleminderit!

z.Musli Neziri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Një përshendetje speciale shkon edhe për diasporën, e cila këto ditë veç ka fillu të vërshon në Komunën e Vitisë, si dhe shfrytëzoj rastin të ju uroj gjithë besimtarëve katolik festen e Krishtlindjeve për fundvit. Unë kam dy pyetje, përgjigjen mund ta jep njëri, sepse ka të bëjë me dy drejtoritë. Si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë vizitave që i kemi pas në shoqëritë kulturore, ata kanë edhe kërkesat e tyre, prandaj një kërkesë e tyre që ka dalë është që, hapësira e përgatitjeve të shoqërive

kulturore per aktivitetet te cilat i bejne ata kane hapesira apo dhoma te zhveshjeve apo ushtrimeve. Aty eshte e nxënë me disa mjete të punës, të Drejtorisë së Shërbimeve Publike apo punëtorët të cilët punojnë për pastrim, prandaj ata e kanë këtë kërkesë si shqetësim që të mund të ushtrojnë aktivitetet e tyre kulturore. Përgjigjen mund ta jap ose drejtori i kulturës ose drejtori i shërbimeve publike, por ata kërkojnë një hapësirë të shfrytzojnë aktivitetet e tyre kulturore. Pyetja e dytë ka të bëjë me drejtoreshën e arsimit. Javën e kalume na ka ardh një vendim në shkolla që, si vendim ka pas një efekt jo të mirë, sidomos te shkollat e mesme, ku aty është kërku që, pushimi i gjatë të shfrytëzohet në hapësira brenda shkollave, të mos dalin jashtë dhe ai vendim të nxënësit nuk është pranë mirë. Ne për dy ditë radhazi jemi ballafaqu me një situatë jo të mirë në shkolla, si mësimdhënës që jam në shkollën e mesme “Jonuz Zejnullahu”, por e njëjta ka ndodhë edhe në gjimnaz, prandaj se si është marr ai vendim, mendoj që ka qenë gabim, sepse të merret një vendim për një veprim të përgjithshëm të shkollave, mendoj që duhet të jetë dikush përbrenda ose të konsultohen drejtorët e shkollave. Unë për sa kam njohuri, drejtoritë e shkollave nuk janë konsultu ose nuk kanë dhanë pajtimin që të bëhet një veprim i tillë, dhe unë mendoj që nuk ka qenë e menduar mirë, sepse pastaj situata ka qenë jo e mirë për të gjithë neve. Edhe tjetra, zakonisht si kërkesë në të jetë kjo që, kur të diskutohet për arsimin e përgjithshëm në Komunën e Vitisë, Komiteti për Arsim, kërkoj që të jemi gjithmonë të ftuar, nëse normalisht ne mendojmë që japim kontribut secili aty, që do të mund të jemi në takime që diskutohet arsimi. Kërkoj që të jemi edhe ne aty të përfshim përshkak të njohjes rrethanave. Nuk po them që jemi ku me ditë sa ekspert, por kontributin mundemi me dhanë rreth asaj se çka mund të punojmë bashkarisht.

znj.Majlinda Shabani: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë ju bashkagjitem urimit të gjithë qytetarëve të Komunës së Vitisë për vitin 2023. Shpresoj që viti 2023 me na gjetë më mirë se viti 2022. Unë po ju bashkangjitem çështjes që kolegu asamblist e ngriti si pyetje. Unë po du me qenë pak më konkret, po du me pyet drejtoreshën e arsimit, se në bazë të cilit udhëzim administrativ ose rregullores është marr ky vendim. Edhe çështjen që ne si komitet jemi lanë komplet anash edhe nuk jemi pyet për këtë vendim që është marrë, andaj unë po besoj që, kjo ka qenë tejet shqetësuese, për shkak që unë i kam parë edhe videot që janë bërë nëpër shkolla dhe si ka qenë gjendja. Pikërisht aty pyetjen e dytë e kam që ka të bëjë me Qendrën e Mjekësisë Familjare në Viti kam marrë informacion se është bërë furnizimi me drunjë. Unë kisha dashtë me ditë se sa metra drunjë janë parapar që të bëhet furnizimi dhe në bazë të cilit kod ose linjë buxhetore është bërë furnizimi i drunjëve. Faleminderit!

z.Illir Zuka: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Fillimisht ja uroj festat e fundvitit të gjithëve. Punën e shkollës në Pozheran, drejtoresh e kemi bërë që çdo seancë me ngrit, po seancën e kalume mungova ke qetë, Pozherani nuk i ra në mend askujt për shkollë, kështu që kisha pas qef me ditë një informatë çka është ka ndodh me të. Këto ditë e kemi pasë një reklamim të madh prej partisë opozitare në Komunën e Vitisë, nivelin nacional qeverin e ka livdu buxhetin që ka kalu, një nder buxhetet më të mëdhenj në Kosovë, por jam befasu me ta se si nuk ju ka ardh keq kur 3 kërkesa për Komunën e Vitisë nuk kan kalu, zgjerimi i rrugës Kllokol, Pozheran, Sojevë nuk është votu nga deputetet e Komunës së Vitisë, unaza që lidh Vitin nuk ka kalu, edhe e kisha një kërkesë prej asamblistit të Vetvendosjes nga ana ime: a qëndron hala rreth autostradës, se e ka ngritë shumë? z.Sejdi për ty është, për autostradën e kam fjalën. Domethanë ke kërku protesta, gjithçka. A i qëndron fjalëve tua ende, kisha pas qef me ditë? Edhe një pyetje për drejtoreshën. Drejtoreshë, kur të vish në Pozheran, ne kemi administrator. Çdo kërkesë që ki me ngrit, nisu prej administratorit. Mos shko shkallën e dytë e të tretë me mbajtë takime për një punë që është mu kry në Pozheran, hirarkinë respektoje. Ti me siguri e dinë për Qendrën për Persona me Nevoja të Veçanta u kanë mirë me u konsultu paraprakishtë me administratorin edhe Pozherani e ka një kshill ka gjithqka domethan që ke mujtë me i konsultu jo me shku në shkallën e dytë të tret me u taku.

z.Nexhat Halili: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Edhe unë ju uroj festat e fundvitit. Kam një pyetje. Renovimi dhe zgjerimi i rrugës “Kongresi i Manastirit”. Pyes, deri ku ka mbërri kryerja e punëve për këtë projekt? Kontrata është e lidhur me 29.09.2022, me kohëzgjatje prej 2 vite, me vlerë 569 mijë e 724.50 euro me datën

25.11, autoriteti kontraktues, perkatesisht Zyra e Prokurimit ka publikuar proceduren e negociuar per publik te njoftimit te kontratës për renovimin dhe zgjerimin e rrugës “Kongresi i Manastirit”, faza e dytë, demolimet në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këtë e kemi kërku edhe në seancën e kalume në bazë të juve, që me ardh inxhinerat dhe me u konsultu me këto. Vetëm nëse bënë shkurt, se jemi marrë vesh me kërkesën e Jakupit, që në këtë seancë me ardhë me u marrë me këto. Grupi i juaj kanë kërku që mos me ardhë në këtë seancë.

z.Nexhat Halili: Puna shtesë. Ne e dimë në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik parashihet 10%, tash në bazë të procedurës negociuese, të cilën e kanë publiku autoriteti kontraktuese, Zyra e Prokurimit, nuk është 10%, por është 20 e diçka %. Në bazë të cilit nen, cilit ligj është parapa 20%. Edhe në kuadër të kësaj pyetje, të gjitha procedurat e prokurimit, kontratat të cilat janë lidhë për punë, të gjitha, mos të them 100% po shumicën e tejkalojnë buxhetin e parapamë për këto projekte. Pyetje e dytë është për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. A keni bërë ndonjëhere ndonjë vizitë te Njësia e Zjarrfikësve. Ajo njësi, në bazë të kushteve të cilat egzistojnë te objekti janë mizore. A keni bërë ndonjë kërkesë për vazhdimin e projektit, e cila është investu në atë objekt? Dhe pyetja tjetër për pajisjet e zjarrfikësve. Në bazë të disa informatave, gati më shumë se gjysma e pajisjeve të zjarrfikësve kanë kaluar afatin dhe kur shkojnë te kontrollat teknike, më shumë se gjysma dalin të pakompletum, domethanë nuk e kalojnë kontrollen teknike. Një pyetje tjetër e kam. Te Drejtoria e Bujqësisë nuk e di apo këta kur e bëjnë publikimin në web faqe të komunës apo Drejtoria e Bujqësisë. Te subvencionet, nëse i marrim listën e përfituesve me sperkatse, publikimin edhe numrin e personave të cilët kan marrë subvencione është me datën 05.12, ndërsa publikimi bëhet me 25.11. Plus tjetra, është te njoftimi për dhënie të kontratës, në realitet është me 21.12, a më së pari jepen tani lidhet kontrata.

znj.Liridona Bislimi: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Urimet të mëparshme të gjithë kolegeve për festat e fundvitit. Njëashtu i bashkangjitem edhe unë, njëashtu duke ju bashkangjitur edhe asaj fushatës sensibilizuese kundër konsumimit të produkteve serbe, ne e dimë që në fundvit, me ardhjen e mërgatës jemi popull që furnizohemi më së shumti me ushqime, mirëpo kisha kërku prej qytetarëve, por njëkohësisht edhe prej gjithë të pranishmëve që, të i ikim sa më shumë barkodeve të cilën bartin produktet serbe. Unë e kisha falenderu drejtoreshën për diskutimin në paraqitje në raportin që e dha. Kam një pyetje për të. E kam parë një kronikë që është bërë në Plus Televizion, pra në mediat lokale, ku është diskutu për çështjen te shërbimi social. Edhe ne siç e dimë, te shërbimi social kemi shumë raste të ndryshme që kan probleme të ndryshme edhe me psikolog. Shërbimet të cilat kryhen prej stafit aty, pjesa dërmuese ose mos të themë të gjithë kan shkollim juridik. A keni angazhu ndonjë psikolog tek shërbimi social për rastet të dhunës, për shkak se siç e ceket edhe ju, kemi rritje të shumta. Nuk po flas vetëm në Komunën e Vitisë, kjo është një rritje që është duke ndodhur në të gjithë shoqërinë tonë, gjithashtu nënkryear e kam një kërkesë prej studentëve në përgjithësi, mirëpo më specifikisht e kam tek studentët të cilën presin transport publik prej fshatit Skifteraj për me shku në Ferizaj. Ata kanë nevojë për një kabinë për pritje të transportit publik, është një mungesë mjaftë e madhe dhe tashti normalisht që jemi në stinën e Dimrit, edhe është jashtzakonisht shumë problematike në këtë kohë ata të presin transportin publik, mirëpo mos ta kenë një kabinë për pritje.

z.Sejdi Emini: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Së pari si vërejtje pata te 1 minut heshtje që mbajtëm për profin Jakup. Unë mendoj që kemi pas obligim si kuvend komunal ta mbajmë një mbledhje komemorative në kohën e duhur për njerëz dhe figura si është profi Jakup, por sa e di unë edhe dy mandate ka qenë anëtar i kuvendit komunal. Herave tjera është mirë me marrë msim prej këtij rasti, që me u mbajtë një mbledhje taman zyrtare edhe me ja bë nderin edhe respektin aq sa e meriton. E dyta, i përgjigjem pyetjes së Ilirit, direkt bëri pyetje për mua rreth kyqjes së autostradës. Po Ilir, është shumë e vërtet që në kohën më herët kam kerku që edhe të protestohet. Qëllimi ka qenë që të mrrihet kyqja në autostradë, ajo për çfarë e ndiej veten mirë dhe më bënë krenar, sepse kyqjen e autostradës e kam shnëdrru në një kauzë ku i kam shti të merren krejt qeveritë një pas një, edhe njerëzit me ndikim politik brenda Vitisë, që janë të gjithë për sa di unë dhe sa kam informatë unë. Çështja

e kyqjes ne autostrade eshte ne procedure ku 3 prona jane ne shpronesim, nese arrin me u shpronsu ato 3 prona dhe nese nuk behet kyqja atëher unë rri në fjalët e mia që i kam thënë në kohën kur kam bërë thirrje. Unë për protestë ju nuk jeni bashkangjijt, por nese nuk bëhet unë ju bashkangjitem pa problem kur është interesi qytetarit gjithëher jam mundu me bë kërkesa në interes qysh është edhe kyqja e Vitisë që ka me qenë një ndihmës dhe një interes shumë i madh i qytetarëve të Vitisë e ki edhe rrugën mbrapa që po bëhet tashti edhe atë rrugë e kam inicu e dini qysh e kam arsyetu dhe si po bëhet. Unë jam i gatshëm kur të është interesi i qytetarit me qit në rend të parë.

z.Naim Pira, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! U parashtun 2 pyetje, një nga ana e z.Aliut dhe një nga ana e z.Nexhatit rreth Drejtorisë së Bujqësisë. Këtë vit Drejtoria e Bujqësisë ka qenë e kujdesshme sa i përket hargjimit të buxhetit, i cili ka qenë i dedikuar për Drejtorinë e Bujqësisë. Mund të them kështu që, me disa projekte që kanë mbet nga viti i kaluar dhe nga ky vit diku janë përkrah bujqit vetëm nga të hyrat komunale, nga subvencionet komunale me një vlerë mbi 200 mijë euro, ndërsa sa i përket pyetjes së z.Nexhatit rreth asaj se a është publiku me kohë, unë po e them që atë ditë që është përpilu lista nga ana e komisionit është bërë publike. Këtu para sallës kuvendit në dritare dhe meqenëse Zyra e Informimit e dinë që web faqja për një kohë të gjatë kohës sa ka qenë jofunksionale. Unë i kam dergu me kohë momentin që është rihap faqja dhe e kam lutë shpeshhere edhe z.Mustafen edhe z.Agronin, që momentin që të hapet faqja të bëhet publike. Ndoshta është bërë me vonesë, por sidoqoftë ne i kemi informu me kohë edhe mua. Më lejoni të ju uroj të gjithë qytetarëve festat e fundvitit. Uroj që ky vit i ri të jetë një vit më i suksesshëm, me prespirativë për të gjithë qytetarët e komunës sonë.

z.Nexhat Halili: Publikimi është shpërnda para kohe.

z.Naim Pira, drejtori: Nuk është e vërtet, nese ka mujte të behet ndonjë gabim teknik. Për pyetjen që e parashtrove, pikërisht në projektin i kam parë të zinjte e ullirit. Përmi 2-3 here kam qenë në OSHP për këtë projekt mos me na humb dhe në momentin e fundit 1 javë para se me u mbyllë kemi arritë të zgjidhet operatori, për shkak se në momentin e fundit dikush tjetër ka jek dorë nga ajo, për shkak të jo funksionalitetit OSHP-së, jo Komunës së Vitisë, as drejtorisë së bujqësisë. Kjo është përgjigja, tjetër nuk kam.

z.Basri Aliu, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit dhe ju uroj një punë të mbarë dhe përfundim të një viti! Ishalla viti tjetër do të jetë më i suksesshëm se ky, kështu edhe unë po ju bashkangjitem urimeve për fundvit. Ke një pyetje prej asamblaistit Nexhatit lidhur me ndërtesën e zjarrfikësve e cila është ende e papërfunduar. Është fakt Nexhat që kushte te zjarrfikësit janë të vështira. Përpjekjet tona pse ka qenë një projekt i ministrisë që përfundon, ajo ka ardh deri te një përfundim jo i duhur, për shkak se u ndërpre kontrata me operatorin e mëhershëm dhe janë bërë prerjet e punimeve, ndërsa gjatë prerjes së punimeve të cilat i kanë bërë Ministria e Punëve të Brendshme, ka ardhë një përfundim që duhet të invesohet një vlerë marramendëse që për neve krejt objekti ka kushtu 200 mijë euro, ndërsa ata e kanë bërë një projekt tjetër që kushton 450 mijë euro. Kam kërku dy here takim me sekretarin e Ministrisë së Brendshme, të treten here nuk më kanë pranë, kështu që më kanë drejtu te agjencioni AMEA, sepse ne veç i kemi bërë prerjen e punimeve dhe kemi bërë paramasen. Tashti nuk është detyrë e jona kam shku te AMEA. Ata thonë që është problemi që ata e kanë bërë paramas të madhe. Ne kaq mjete nuk kemi, kështu që në bisedë e sipër kemi ardh deri te një përfundim që ta bëjmë një paramas tjetër që me inxhinierat tonë komunal ta bëjmë një paramasë. Ato çka janë të nevojshme në mënyrë që ta funksionalizojmë ndërtesën e zjarrfikësve, që ata të kalojnë atje dhe me bashkëfinancim. Domethanë që edhe komuna ka shpreh gatishmëri që edhe ne të invesotjmë në mënyrë që ta perfundojmë edhe këtë proces, ndërsa sa i përket aparaturës nuk të kuptova për cilën aparaturë e ke fjalën.

z.Nexhat Halili: Për të gjithë kamionat e pajisjet lëvizëse.

z.Basri Aliu, drejtori: Nuk është e vërtetë, ki paisje për fikjen e zjarreve. Duhesh me kuptu që, zjarrfiksat janë edhe kompetencë e AMEA-së dhe ata munden me i furnizu. Ne i rrimë gati në këtë kuptimin për mirëmbajtje dhe nuk është që nuk janë krejt funksionale, por edhe ato janë vjetru.

z. Valmir Sahiti, drejtori: Pershendetje per te gjithë te pranishmit! Me lejoni qe fillimisht t'ju bashkëngjitem urimit me rastin e festave të fundvitit dhe po ashtu ju uroj të gjithë mërgimtarëve pushime të këndshme në vendlindje. Më lejoni të ju përgjigjem pyetjes të drejtuar nga këshilltari komunal, z. Musli Neziri, rreth hapësirave brenda shtëpisë së kulturës. E para, dëshiroj ta konfirmoj që shoqëritë kulturo artistike e kanë të gjithë hapësirën e nevojshme për zhvillimin e vepritarisë së tyre dhe Komuna e Vitisë është njëra ndër komunat shembull që pothuajse për të gjitha organizat tjera joqeveritare ka siguruar objekte tjera përcjellëse, përveç hapësirave ku atje i zhvillojnë veprimtaritë në koncerte dhe prova. Është e vërtetë që një pjesë e hyrjeve të sallave të koncerteve është e zënë me mjete pune, por në konsultim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike do ta trajtojmë shumë shpejtë dhe do të gjejmë zgjidhjen për këtë rast.

znj. Merrushe Ahmeti, drejtoreshë: Faleminderit për pyetjen! Atëhere, për momentin i kemi 320 metra drunj, pritet me i marr edhe 400 metra, ndërsa sa i përket kodit, është kodi për furnizim me drunj dhe pelet, më saktësisht me numër 13760, ndërsa sa i përket pyetjes së Liridones, është e vërtetë se te Qendra për Punë Sociale, shumica e punonjësve janë të profilit jurist, janë të punsime edhe 2 femra që janë të begandit të psikologjisë, të shkencave sociale, mirëpo a e ushtrojnë detyrën e psikologes, nuk e parashih një ligj, një statut, që Qendra për Punë Sociale duhet me pas psikolog edhe duhet të ushtrohet detyra vetëm e psikologut, ndërsa sa i përket çështjes së rekrutimit dhe seleksionimit, është zyra përgjegjëse e burimeve njerëzore.

znj. Fatbardha Emini, drejtoreshë: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Ju faleminderoj të gjithëve për këtë bashkëpunim që kemi pas gjatë këtij viti, uroj që viti 2023 të jetë me shëndet të mirë dhe me suksese të përbashkëta. U parashtrun disa pyetje që kanë të bëjnë me funksionimin apo mbarëvajtjen, suksesit arsimor nëpër shkollë. Ali Bajrami parashtrorë pyetje, a është ndryshu rregullorja. Jo, nuk është ndryshu, sepse rregulloret komunale ndryshohen në kuvendin komunal. Unë e kam përcjellë një qarkore njoftuse për shkollat. E dini që qarkorja njoftuese është një thjeshtësim i bazës ligjore, i Ligjit mbi Arsimin nëpër Komuna, i arsimit parauniversitar dhe i rregullores komunale. Kam kërku që këto akte të zbatohen dhe të gjejn zbatueshmëri në institucione edukativo arsimore në bazë të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar. Po ndërlihdna edhe me pyetjen e kolegeve tjerë, meqë është një çështje e njëjtë sa i përket qarkores së fundit njoftuses. Kjo ka ardhë në sajë të takimit të rregullt që i kemi me drejtorët e shkollave, në sajë të takimit të rregullt që e kemi me Këshillin e Prindërve Komunal me Këshillin mbi Sigurinë në Bashkësi dhe me këshillin mbi sigurinë në shkollë, që së fundi e kemi edhe këtë këshill që ka të bëjë vetëm me sigurinë në shkollë. A është dashtë të zbatohet një rregullativë e tillë, mendoj që më herët ne ndoshta jemi komuna e fundit që i kemi shkollat e hapura edhe gjatë procesit mësimor, domethënë shkoni në Gjilan, në Ferizaj, në Prishtinë në shkollat e mesme, sidomos nuk mundet unë personalisht javën e kaluar kam qenë në Gjilan dhe është dashtë me dorëzuar letërnjoftimin tek sigurimi në oborrin e shkollës për të hyrë në shkollë. Kjo është në sajë të parimit themelor të Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar, një prej parimeve themelore, siguria dhe mirëqenia e nxënësve. Ne përpos që duhet të kujdesemi për rritjen e cilësisë, për rezultate më të mira, objektivi jonë si Drejtori e Arsimit është edhe siguria e nxënësve. E dinë, javë më parë pavarësisht që nuk ka ndodhë në oborr të shkollës, ka ndodhë në qytet, është therur një nxënës, domethënë këtë ne nuk mundemi me kalu në heshtje edhe me u bërë që nuk po ndodhë asgjë, ne nuk mundemi me kalu në heshtje që nxënësit tanë nuk përdorin mjete të dëmshme që sjellin në të ardhmen, që dëmtohen edhe karakteri i tyre apo personaliteti, ka pasoja përderisa ndodhë në shkollat e regjionit edhe tek ne duhet te ndodhë. Ne kemi kërku edhe me këshillin e prindërve, vetëm kam kërku të zbatohet rregullativë edhe sa i përket mirëmbatjes edhe sa i përket disiplinës së msimdhënësve edhe gjitha këto, domethënë nuk ka nevojë pavarësisht respektit që kam për komitetin për arsim, por ne jemi dy organe të ndamë ekzekutivi dhe legjislativi. Ju na monitoroni, na kritikoni, na këshilloni kur ne bëjme gabime, por vendimmarrja është e ndarë, sepse këtë na e ka ndarë Ligji mbi Vetqeverisje Lokale. A është dashtë me u konsultu, nuk e di që duhet me u konsultu për me zbatu një rregullativë ligjore ju, e sidomos profa Musli, jeni profesor aty dhe unë konsideroj që duhet të jeni avokuesi më i madh i kësaj rregullative, sepse personalisht jeni idhëtar i rendit, bile disa rekomandime të juaja i kam marrë shumë për bazë, sidomos ndalimi i

ketyre testave neper shkolla edhe çdo rekomandim qe ka te beje me sigurine, rendin dhe diciplinën, jo vetem Komiteti për Arsim, po kushdo qoftë ne kemi me u ulë në Drejtorinë e Arsimit kemi me diskutu po ashtu në takimin e fundit që kemi pasë me OSBE-në, drejtorët e arsimit dhe ministria, nga hulumtimet e fundit kanë dalë që shkollat në Kosovë kanë dalë jo të sigurta dhe mbi 85% e nxënësve dhe msimdhënësve kanë kërku të sigurohen nga policia. Domethanë kjo nuk është një informatë me hudhë poshtë, por ne duhet me marrë masa preventive në planifikimin e 2023-së. Do të ketë edhe sigurim fizik për shkollat e qytetit të Vitisë menjëhere në Janar do të filloj me procedura, pastaj ndoshta në kampusin pas rivitalizimit të gjimnazit do ta bëjmë edhe ne një hapësirë ndoshta edhe më të sigurt në kampus. Në shkollat e mesme ne kemi mësim gjysmë dite, nuk është mësim githëditorë, edhe shujtat nxënësit munden t'i marrin nga shtëpia apo munden ta kenë një shujtë edhe në shtëpi, por mbi të gjitha ne duhet të kujdesmi për sigurinë e nxënësve, sepse nuk është imazh i mirë për shkollat që ne nxënësit t'i shohin nëpër kafe gjatë procesit mësimor, edhe nxënësit kur dojnë me hy në shkollë edhe kur të dojnë me dalë, ne nuk jau kemi ndalu me dalë prej shkolle, por me leje të kujdestarit dhe të menaxhmetit të shkollës, për shkak se prindi e dërgon fëmijën në shkollë dhe ai e dinë që është në shkollë, dhe ne duhet të kujdesemi që ai të qëndrojë në shkollë. Prej kësaj nuk ka kthim mbrapa dhe kërkoj ta zbatoni edhe si shkollë e mesme profesionale, me që aty ka rezistencë edhe më shumë siç duket edhe nga ana e nxënësve, mirpo kjo nuk ka kthim mbrapa, sepse shumë më lehtë me mbajtë 15 minuta pushim për nxënësit i dergon në kafe, por duhet ta kesh përgjegjësinëm por edhe këto 15 minuta të pushimit duhet t'i kesh në monitorim. Kaq kisha, kjo është në të mirë të nxënësve, në të mirë të sigurisë, në të mirë të shkollave. Vetëm kam kërku të ketë rregullativë. Po ashtu edhe sa i përket asaj qarkore, janë edhe disa kërkesa për mirëmbajtje nëpër shkolla edhe për msimdhënësit, por edhe për drejtorët, sepse është një kontratë që secili e ka nënshkru. Unë kam kërku t'i përmbahen kriterëve të kontratës që e kanë nënshkru. Kaq kisha për këtë. Sa i përket shkollës së Pozheranit, vërtetë është shqetësuese, definitivisht nuk di as fjalë me gjetë me përshkru. Sipas njofitmit jozyrtar, sepse i kam shkru shumëhere dhe nuk kam marrë përgjigje prej Ministrisë së Punëve të Brendshme. Është në rishqyrtim, tashti a kanë fillu me procedura të re të tenderimit nuk e di në këtë rast, nuk e di çfarë veprime duhet të bëjmë ne, vetëm të ju drejtohem i avokatit të popullit që po e bëjnë një shkelle për nxënësit në Pozheran dhe msimi nuk po zhvillohet në mënyren se si zhvillohet në shkollat e tjera. Ngritje me vend liri, por definitivisht unë, personalisht i kam qu durt si person, por jo edhe sa i përket letrave, sepse duhet të ju drejtohem i. Kam shkru te ministria, por ndoshta duhet të ju drejtohem i edhe organve pak më të larta se ministria.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Me knaqësi të veçantë vij në Kuvend, falë angazhimit edhe të juajit, falë angazhimit edhe shërbyesve civil edhe drejtorëve të drejtorisë. Edhe pse ishte një vit ndoshta më i rëndë gjatë ushtrimit të funksionit tim, e dimë për shkak se janë dy rezultate, për shkak që gjithëherë komunat vrapojnë edhe investimet kapitale janë të realizuar diku mbi 97%, 98% që rrallë komunë do t'i ketë në nivel republike të Kosovës, njëashtu edhe të hyrat vetanake i kalon grumbullimin e 100%, andaj këtë meritë do të ja kisha dediku të gjithë atyre të cilët janë taksapagus, por edhe ata të cilët i kanë realizu projektet. Prandaj janë dy lajme të mira për qytetarët e Komunës së Vitisë dhe në këto lajme të mira do të ja kisha bashkangjitë edhe urimin që me ju uru të gjithëve, që viti 2023 të na gjejë me rezultate edhe më të mira dhe me familje e me punë më të mirë për qytetarët e Vitisë. Unë besoj që kësaj radhe drejtorat i dhanë përgjigjet, megjithatë unë i shënova dy plotësime dhe një skjarim për mos me pas keqkuptime. Nuk jam idhtar i atyre çështjeve, por ndoshta skjarimin duhet ta jap Nexhati. Nuk kisha kurrfarë tendence kur reagoja. Ne fillimisht e patëm një takim me kreysuesin dhe kërkuam që ta zbatojmë rregulloren. Kur them që ta zbatojmë rregulloren, do të ishte praktikë e mirë që, edhe qytetarët me i zbatu vendimet. Ju që i bini, në rast se qytetarët e shohin që ne nuk e zbatojmë rregulloren, atëherë çka pritët prej qytetarëve. E dyta, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, po e skjaroj nga shefi i këshilltarëve të grupit tanë është kërku se, në Janar të vijnë inxhinerat e të gjitha zyrave, të skjarohej të gjitha punët, prandaj për këtë nuk kishte kurrfarë tendence dhe dashta me kalu atë pyetjen e parë të cilën e shtrova plotësim, do të kisha bë besojë. Majlinda, këshilltarja e bëri një pyetje shumë të mirë.

Drejtoreshe, është tjala për turnizimin me drunje, është e heres të fundit që është bere, për të cilin jam në rrjedh dhe konsideorj që e preki këtë pikë. Atje ka qenë një mosmarrveshje, ndoshta të cilit i ka ik një gabim teknik dhe dy herë janë zotu nga 22 mijë euro, dhe tashti zotimi i atyre mjeteve ka qenë e dedikume për drunjë dhe janë marrë 22 mijë euro drunjë më shumë. Kjo është dhe nuk kemi pasë opsion tjetër, prandaj kjo është e nderuara kshilltare. Unë besoj që kur janë kordinu me mua kam thënë ne të shkon drunjët nëse janë tepricë, ata do të jenë edhe për vitin e ardhshëm këtë plotësim të pyetjes dhe një plotësim të cilin e shtroj si pyetje këshilltari. Faleminderit prej Sejdes, në përgjigje nuk keve kur thave ke kërku protesta. Atëhere kemi thanë po, veç t'i shterrim mjetet institucionale. Kjo ishte ajo formë, kurr nuk kemi thanë nuk po dalim, kemi pasë një dakordim të fortë sa i përket kuvendit dhe një informim të cilit do ta kisha bërë se kam marrë obligim në seancën e kaluar kujtoj se ka dalë nga grupi i Vetvendosjes që është kërku një raport nga ana e policisë. Unë kam bisedu 2 here me kapitetin, ai e ka gadishmërinë mometin kur kuvendi komunal është i akordum jo si subjekt politik për shkak që kuvendi komunal është shtyllë tjetër dhe ata i ikin subjekte politike, ju i drejtoni kryesuesit, kryesuesi e bënë me shkrim dhe vijën na informojnë për gjendjen e sigurisë në Viti. Faleminderit!

z.Ramdan Deliu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Veç dashta, kur e përmendi nënkryetari që i ka ftu inxhinierat pse me i thirrë kur është nënkryetari, janë drejtortitë, çka ka pyetje mundet me u drejtu tek ju.

z.Musli Neziri: Drejtoreshë, faleminderit për përgjigjen. Asnjëherë nuk jam idhtar i asaj që të mos ketë rend dhe ligj në shkollë, sepse pa disiplinë të mirfilltë nuk mund të kemi as cilësi në arsim, as arritje të rezultateve, por të rekomandimi nëse është dhanë si rekomandim i gjithë atyre institucioneve të cilët i permende, nuk jam i asaj që nuk e regjistroj atë dhe jam idhëtare me i zbatu rregulloret dhe ti e dinë fortë mirë që edhe takimet që kemi pas, edhe bashkëpunimet që kemi pas, asnjëherë nuk e kam për qëllim të përzihem në kompetenca. Domethanë ana ligjore, ana vendim marrëse ju takon juve. Ne e dimë atë, por kërkoja që situatat që na kanë dal, edhe unë vetë si mësimdhënëse në një farë forme i kam pas duart e lidhta, se nuk kem pas çka bënë, prandaj përmbrenda proceseve mësimore ata të cilët janë aty së paku të konsultohen. Unë me sa e di, drejtorët e shkollave nuk e kanë dhënë përgjigjen për këtë, kështu e kam informatën prej drejtorit të "Jonuz Zejnullahu". Është mirë me pas ligj, ndërsa ajo pjesa që nxënësit pjesë të kafeneve, ato duhet me fol realitetin, duhet me shku deri në fund anës ligjore, por duhet edhe përgjegjësi të lypet, pastaj të kontrollohen të kenë përgjegjësi dhe besoj që zgjidhen këto, ndërsa nuk po hy më në detaje, se gjendjen se si munden me shfrytzu, sepse nëse komunat tjera ofrojnë një siguri të tillë, duhet pyetet, a kanë përmbrenda diçka, a afrojnë. Ne ende nuk kemi një shoqëri që shujtat nxënësit i marrin me vete. Ne e dimë atë se ku jemi si shoqëri, po flas nuk jemi në përfundim që fëmija ta merr shujtën me vete, e kështu me radhë. Domethanë i japim zor me shku anej, por shpresojmë që të bëhemi ashtu. Faleminderit!

z.Ilir Zuka: Si duket vetëm unë qenka shqetësuar në këtë kuvend, domethanë për shtirjen në buxhet të nivelit qendror, që ke zgjerimi i rrugës, unaza e gjerat tjera. Nuk u ngrit kush, nuk u marrë kush me atë kërkesën time. Ju kërkoj falje, ndoshta paska qenë pa vend ky shqetësim.

z.Nexhat Halili: Përshendetje edhe një here! Drejtor, unë kur e bëra pyetjen për subvencione, unë e kam dokumentacionin që keni publiku vetë Zyrën e Prokurimit edhe në web faqe. Tashti ose nuk keni koordinim me këta të web faqes dhe Zyrën e Prokurimit, kur unë e kam dokumentacionin, njoftimin për nënshkrim të kontratës me 20.12.2022, shpërndarja e subvencioneve është bërë 05.12.2022.

znj.Majlinda Shabani: Edhe unë po mundohem me qenë shumë e shkurt. Drejtoresha në fakt me argumentet që i dha u mundu me spjegju gjendjen faktike, për të cilat pajtona, por nuk pajtohem me mënyrën e trajtimit. Edhe mekanizmat që janë duke u përdor prej DKA-së fillimisht, por nderlidhem te njoftimi që është bërë drejtoreshë, mesa e kemi informimin, nëse rasti ka ndodhë gjatë pushimit të gjatë, atëhere i bjen që faktorë ka qenë pushimi gjatë, mirëpo a ka me na siguru, a ka me të siguru ty si drejtoreshë që vendimin që ti e ke marr ka me ndiku që këto raste mu eliminu ose mu paksu. Domethanë jemi duke fol për një çështje shumë të ndjeshme, për shkak që në seancën e kaluar unë e kam përmend rastin në fjalë dhe kam thanë që, duhet një mbështetje institucionale.

me hanger shendetshem, jo fast food apo ushqime te tjera. Une konsideroj qe kjo eshte ne te mire te te gjitheve dhe eshte ne bazë të legjislacionit.

z.Remzi Salihu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Nuk dashta me diskutu fare, por megjithatë po dua me u ndërlihd pak me këtë vendim apo qarkoren e cila na ka ardhë nëpër të gjitha shkollat. Nuk do të kisha thënë se është jashtëligjore apo me tendenca, por megjithatë unë këtë e kam parë një far tendece që për të arsyetuar dobsitë e deri tanishme, kjo qarkorja është marrë pikerisht tani. Kjo qarkore ndoshta ka pas nevojë të jetë shumë më herët sesa tash, por kjo është bërë vetëm në raste kur na ka ndodhë kjo tragjedia e therjes së nxënësve, megjithatë pra, para se të bëhet kjo qarkore kam dashtë që të bëhen kushtet dhe të rregullohet infrastruktura dhe të rregullohet kampusi pak më herët se sa të merren masat paraprake, prandaj këtu është njëfar mënyre të mbulohet dështimi i deritashëm në mënyrën të shpejtë, rapide, por megjithatë unë nuk e kisha kontetsu si një vendim, kështu se nuk është vendim se e tha edhe drejtoresha që, nuk është vendim, por është një qarkore. Megjithatë ka qenë dashtë së pari kushtet pastaj qarkoren, edhe pa qenë qarkorja këto masa është dashtë me i përfill, por nuk jan përfill tashti dështim i kujtë është ajo këtu lenë për të diskutu pak më tepër nëse e shtrojmë problemi kështu për së mbari. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit Remzi! Unë po them që menaxhimi i shkollave është kompetencë e drejtorit, drejtori ka përgjegjësinë për mbarvajtjen e procesit mësimor, për rendin dhe zhvillimin e procesit mësimor. Të njëjtat shkolla këto vendime mundem me i marrë edhe vetë në bazë të ligjit, për rregullimin e brendshëm të procesit mësimor. Ne duhet me ditë, e kemi një keqkuptim, se mësimi në Kosovë, në Komunë të Vitisë nuk është mësim tërditorë. Mësimi tërditorë e ka edhe shujtën, ndërsa mësimet që nuk janë tërëditore nuk e kan shujtën. Ne e kemi keqkuptu këtë që pushimi gjatë do të thotë që duhet me marrë bukë, është jo në rregull. Ne e dimë që edhe pas pushimit të gjatë gjysma e orës na shkonë kot, për shkak ushqimit tu hanger nxënësit që nuk mundesh me ja ndërpre. Në kushte normale, me ligj, pushimi gjatë mund të jetë jashtë vetëm nëse nuk mundet me dalë prej aborrit nxënësi, prej aborrit të shkollës. Nuk mundet me dalë në qytet, kjo është rregull, kjo është ligj. Domethanë që, rregullohet procesi mësimor për mbarvajtjen, për respektim të ligjit. Ajo është e percaktume me ligj. Tashti është marrë një vendim, ky vendim që është marrë tashti mos me dalë prej shkollës është një punë më e madhe, në shkollë është bërë qe 2 ditë, e shohim edhe 1 javë, besojmë që të bëhen edhe matjet a është pozitiv apo negativ.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Për këtë seancë kemi parapa këto pika:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e rregullt e KK-së.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësimit të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2023.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-1057, të datës 29.09.2022 për taksa, ngarkesa dhe gjoba.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit Nr.01-110/05-1071 për caktimin e lokacionit për ngritjen e obiliskit "Madelein Albriht" në qytetin e Vitisë, të miratuar nga KK-Viti, me datë 28.09.2022
6. Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2022.
7. Informatë për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë.
8. Informatë për zbatimin e planit te KKS-së për vitin 2022.

z.Jakup Demiri: Pershendetje per te gjithë te pranishmit! Fillimisht me lejoni te ja uroj testat e fundvitit ne emrin tim dhe në emrin e Levizjes Vetëvendosje në Viti, të gjithë juve dhe qytetarëve të Komunës së Vitisë. Unë e kam një propozim që, pika e dytë e rendit të ditës të hiqet nga kjo séance, te ndryshimet statutore, për shkak se e kemi edhe ligjin tashti që bëhet për vetëqeverisje lokale dhe të sherbyesve civil, dhe me thënë të drejtën ka edhe sene që kisha pas qef në të ardhmen të l jepet kohë edhe diskutimit, të dimë edhe rreth drejtorive që ndahen, por edhe rreth këshillave të fshatrave, që me thanë të drejten te puna e këshillave të fshatrave, unë për vete personalisht, por edhe si subjekt politik i kemi dilemat tona, se a bënë të bëhet ashtu apo nuk bënë. Kështu që, propozimi jonë është që të hiqet nga rendi i ditës për këtë séance. Faleminderit!

z.Naim Pira, drejtor: Faleminderit kryesues! Më lejoni që ta përshëndes edhe kryetarin e komunes, meqë ju bashkangjit punimeve të kuvendit. Unë e kam një kërkesë nëse e gjej mirëkuptimin e juaj, prej z.kryesues edhe juve kshilltarët komunal. Në seancën e fundit kemi miratu një vendim për formimin e kodeve për participim, meqenëse me 21 na është kthyer nga ana e ministrisë me një arsyetim të paqëndrueshëm. Vendimi është arsyetu për faktin se nuk kemi pas mjete që t'i realizojmë këto projekte, ndërsa mjetet janë pagu realisht, mirëpo gjatë përpilimit të tabelës. Unë si drejtor i bujqësisë kam bërë një gabim teknik dhe në vend që me shënu 2220 e kam shënu 2200. Do të thotë e kam harru një 20. Nëse e gjej mirëkuptimin e juaj, kjo duhet të kaloj përmes kuvendit, vetem ta bëjmë këtë ndryshim, ta bëjmë 2220 aty ku është participimi te sperkatset e plehit dhe vlëra, në vend të 8800 të jetë 20 euro më pakë ky është gabimi që është bërë dhe duhet patjeter të kaloj përmes kuvendit. Më kanë sygjeru nga Zyra e Financave dhe po shpresoj që gjejë mirëkuptimin e juaj dhe ta bëjmë këtë ndryshim. Faleminderit!

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: E kemi një kërkesë unë edhe kryetari nga Qendra për Gjenocid në Kosovë - Plani i Hapur, i cili ju ka drejtu të gjitha institucioneve të Kosoves, Presindencës, Qeverisë dhe kuvendeve komunale të miratohet deklarata që, lulëkuqja të jetë simbolizim i gjenocidit në Kosovë. Shumica i kanë miratu, disa të tjera më vonë, sepse 15 Janari është Dita e Gjenocidit në Kosovë, që paraqet kjo. Lulëkuqja me 4 petale paraqet vrasjet, dhunimet seksuale, spastrimin etnik dhe shkatërrimin e objekteve. Unë kisha kërku mirëkuptimin që bashkë me të gjithë kuvendet komunale edhe ne ta miratojmë këtë deklaratë unike që është në të gjithë Kosovën. Me gjithë respektin që kemi diskutu edhe para kuvendit edhe me grupin parlamentar të VV-së dhe të tjerë, te statuti është edhe një mirëkuptim që të jetë edhe një statut që të votohet nga të gjithë, është kërku edhe pak kohë për shkak të disa konsultimeve e kisha tërheq piken e statutin nga rendi i ditës sot, e qesë në votim rendin e ditës pa piken 2 të statutit me pikën që dha drejtori i bujqësisë edhe deklaratën që të miratohet. Me ngritje të dorës a jeni që të miratohet rendi i ditës me ngritje dorës? 24 janë prezent, nga të gjithë u miratua rendi i ditës.

Kryetari i Komunës, z.Sokol Haliti, i cili ishte i pranishëm në këtë seancë, i cili përshëndeti anëtarët e kuvendit komunal, nënkryetrin, drejtorët, të gjithë të pranishmit, të cilët i falenderoj për punën e mirë dhe bashkëpunimin deri më tani, duke ju uruar festat e fundvitit me dëshirën që të kemi shëndet edhe suksese në vitet e ardhshme.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit kryetar!

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjet e rregullt e KK-së

z.Musli Neziri: Faleminderit kryesues! Përshendetje Kryetar! Te procesverbali kryesues, dashta me diskutu po përfillen shumë here gabime, prap po flasim për gabimet gjuhësore. Ne pe dimë që gabime gjuhësore po nuk po e di a nuk është tu funksionu, nuk jam tu e kuptu çka është ka bëhet. Përshembull, faqe 1, te renditja e emrave znj.Zyrafete Rama, Veton Ramadani, as emrat mirë nuk shkruhet te faqe 14, te diskutimi im, aty janë citu disa gabime prapë. Unë pe di që mund të ndodhin gabime, por ata po na përsëriten vazhdimisht, është diçka kualccion është shkru kualicon kërkon nuk përputhen një korrektues shumë i thjesht i gjuhës shqipe i gjenë këto gabime. Unë e kam më shumë shqetësuese që po përsëriten vazhdimisht.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kush është për që të miratohet proces verbali me këto përmisime? Nga të gjitha votat miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e listës së veçant të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2023

z.Ajet Sallahu, drejtori: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në bazë të asaj që e tha nënkryetari, në bazë të ligjit jemi të obliguar që për vitin e ardhshëm të paraqesim listën e veçant për pronat e paluejtshme të

komunes, qe planifikon per dhenie ne shtrytezim kontorme Ligjit UoL-09 / per Dhenie ne Shtrytezim dhe Këmbim të Pronës Komunale. Lista është bërë, e keni para veti, mirëpo unë kërkoj mirëkuptimin me vërejtjen te Komiteti për Politikë dhe Financa kanë kërku që për prona që janë në procedurë, që janë aprovu njëherë, mirëpo tashti për shkak të procedurës kalojnë në vitin e ardhshëm, i kemi futë edhe 4 prona që janë, në Devajë janë 3 dhe 1 në Smirë, që do t'i bashkangjiten listës, do të thotë do të ja ofrojmë sekretarisë, prandaj kërkoj nga ju që ta miratoni këtë listë për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale.

z.Musli Neziri: Unë gjatë shfletimit të materialit, krejt çka kisha kërku te shpallja e listave të veçanta, e pronave, a ka mujtë të jetë edhe një skicë, me u ditë me skicë se cilat janë parcelat, se ne nuk i dimë ku janë, janë sipërfaqjet, këtu është në rregull për tokë bujqësore ose për rritjen e vendit të punës. Nuk po hi anej, po veç kisha kërku që të jetë e bashkangjitur edhe me skica. Mua nëse si kshilltar më pyet dikush për cilat janë këto, unë mundem me thënë që i kemi shpallë me interes për komunën, por nuk di me të tregu për cilat zona bëhet fjalë, po flas për konkretisht në Zhiti, mos të flasim për fshatrat tjera, Budrikë e Epërme, Sodovinë, Goshicë etj. Prandaj kisha kërku drejtor që, të jetë edhe një pjesë e skicave. Mendoj që është e lehtë me inxhinerat e printojnë edhe i dimë sakt na vjen materiali më i kompletum.

z.Ali Bajrami: Drejtor, faleminderit për informatat edhe sqarimet! Qëllimi është më i mirë që të krijohen të hyrat në komunë, të kemi gjenerim të vendeve të punës, ngastrat kadastrale janë interes me i dhanë, mos me mbet vjerrina. Ne si grup parlamentar e mbështesim, e votojmë pro këtë propozim vendim që na ka ardhë.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Këshilltari me të drejtë kërkoj, por i nderumi këshilltar, kjo është initiale, ne u dashke me zanë hapin që vërtet organeve më të larta mbikëqyrse me ja u dorëzu listën apoksimatrike të mundeshme. Nëse ne gjejmë investitorë që me pasë mundësinë. Më vonë kemi kohë kur të bëhen vendime veç e veç nëse gjejmë investitorë që na ofrohen dhe mi detaju. Kjo është listë fillestare, për afatin ligjor nënkupton edhe në kuvend me miratu edhe në ministri me dorëzu, kjo është arsyeja, përndryshe ajo që po thua ti qëndron, edhe drejtorja e bënë veç e veç patjetër.

z.Musli Neziri: Faleminderit kryetar! Nëse nuk u keqkuptum, unë nuk pata diçka, thashë kur na ka ardhë kjo ka mujtë me u kanë menjëherë e bashkangjitur edhe ajo, që me ditë për çka po votojmë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Zakonisht komunat i indetifikojnë të gjitha pronat që i kanë të lira, që mund të kenë kërksa gjatë viteve në vijim, për me ju jap mundësi bizneseve, zhvillimit në të ardhmen.

z.Jakup Demiri: Pajtohem me kolegun, Muslien, për shkak se është kogja njoftim i mirë ta dimë se, ku është ajo parcelë. Unë e kam pasë njëherë një takim me një qytetar të fshatit Budrikë, i cili ka pas pengesa në kryerjen e punëve të tyre në ara, në parcelat e veta, pikerisht për atë të një prone të cilën e ka dhanë komuna. Aty është pengu, mandej ka pas disa telashe. Kështu, është mirë, nuk po flas për telashe, por po e cekim vetëm një rast ndonëse është mirë. Ne e votojmë vetë me u kanë i interesum, nuk e di ku është parcela edhe e dyta, drejtori nuk është e thamë, por është kanë mirë me na njoftu për ato parcelat cilat i ka dhanë komuna në shfrytëzim sa ka pasë komuna të hyra. Nëse është afat për para vitit të ri, ne si grup parlamentar do ta votojmë.

z.Sokol Haliti, kryetari i komunës: Faleminderit shumë këshilltar! Personi për të cilin po e përmend ti në Budrikë, vendimi gjyqësor për atë pronë të atij ka rrejdhe shumë më vonë, ndoshta 1 vit e gjysë apo 2 vite më vonë nga gjyqi. Se sa që ne i kemi marrë vendimet institucionale, edhe në nivel lokal edhe qendror për zyrën ekonomike me plan rregullativ e me të gjitha kriteret ligjore, me licensim, me të gjitha. Ju e dini që për një zonë ekonomike kur të krijohet, janë 5 ministri dikaster profesional ku merret licenca, letra, tu e përfshi Ministrinë e Ambientit, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Tregëtisë, Industrisë dhe Zhvillimit Ekonomik, etj. Vendimi i kuvendit, plani rregullativ, janë bërë një varg i punëve planifikuese, vendimmarrëse, legjitime, legale, për me u kry ajo. Ajo parcelë kontestuese nuk ka qenë në atë kohë, ajo kishte qenë në gjykatë, vendimi është marr shumë më vonë, prandaj në këtë kuptim ne nuk jemi tregu natyrisht injorant ndaj vendimit të gjykatës si institucion, por thashë edhe më herët, ne vendimet e organeve më të larta, pavarësisht a mendojmë personalisht a janë të drejtë apo të padrejtë, a janë me vonesë apo me kohë, a janë shumë vonë. Kemi vendime edhe para 23 viteve. Qe na ka ardhë para 1 jave një vendim që nuk është i lehtë, por edhe me atë duhet mu ballafaqu, mi rishqyrto, mi trajto përmes Zyrës Ligjore, kështu që nuk ka asnjë problem, atje edhe ai problem është i zgjidhur. Qasje kanë edhe ata, por ne edhe te zona ekonomike ku e pata më herët fjalën, drejtori e din, kemi kërkesa edhe rreth zonës ekonomike me marrë hapësira për ndërtimin e fabrikave të reja, shumë më të mëdha hapësirën. Ne kemi mundësi si kuvend, duhet me reflektu dhe me ju dhanë dhe me ju kriju qasje, për shkak se ata investitor potencial ndërkombëtar edhe nivele që janë më të lartë, nuk vijnë shpesh. Neve na nevojitet zhvillimi ekonomik, na

nevojitet gjenerimi i punesimit te te hyrave me shume se kurre, sidomos kete kohe kur rinia po na shkon jashte. Në këtë kuptim, letrën initiale e ka qu drejtorja, në mënyrë që më vonë mu detajizu. Kur t'i kemi kërkesat veç e veç për pronën të cilën investitorët janë të interesum, se ne nuk mundemi me ja imponu.

z.Ajet Sallahu, drejtor: Faleminderit kryesues! Ashtu siç tha kryetari, ashtu janë edhe procedurat, megjithatë nëse janë të interesum tashti për tashti është gjeoportali 2022 që veç ja qet numrin e parcelës edhe mundem me pa edhe në laptopat që i kanë aty, janë mundësitë me i pa përmëniher.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kisha kërku me ngritje të dorës të votohet kjo listë e pronave për shfrytëzim. Kush është për, kundër a ka? Abstenim nuk ka. Nga të gjithë të pranishmit miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3.Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-1057, të datës 29.09.2022 për taksa, ngarkesa dhe gjoba

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Për herë të dytë na është kthyer kjo rregullore. Këta e shpjegojnë edhe më mirë. Herën e parë është kthi qajo pjesë pozitiv, që është në rregull, tash na është kthi nuk ish në rregull hera e parë.

z.Besnik Imeri, drejtor: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Si e tha edhe kryesuesi, ata herën e parë që e kemi dërgu nuk e kanë vërejtë që ka mungu një udhëzim administrativ edhe e kanë kthi në pajtueshmëri me ligjet dhe pastaj Ministria për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë ta citoj paragrafin, nenin te rregullorja bazë, te neni 10, te Drejtorja e Kadastrës, Pronës dhe Gjeodezisë, për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me numër 01-110/05-1057, të datës 29.09.2022, i shtohet edhe udhëzimi administrativ nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me numër 05/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ numër 09, 2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluejtshme.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka dikush me diskutu? Pasi që nuk ka për diskutim, kisha kërku me ngritje të dorës të votohet. Kush është për, kundër a ka? Abstenim nuk ka. Nga të gjithë të pranishmit miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-1071 për Caktimin e Lokacionit për Ngritjen e Obiliskit "Madelein Albriht" në Qytetin e Vitisë, të miratuar nga KK Viti, me datë 28.09.2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Na është kthyer që, rregullorja që vendimin për obelisk nuk është në planin e hapësinor dhe ka kërku dokumenta shtesë, kanë dërgu drejtoritë, mirëpo prapë është kthyer. A ka dikush me diskutu për këtë çështje.

z.Ali Bajrami: Po më intereson vetëm një sqarim këtu e kemi votu në seancën e shtatorit 28.09.2022 në MAPL ka shku me 05 që e keni dërgu si kryesues me 11.10 është kthi njoftimi prej MAPL-s që është e kundër ligjshme u dashtë me kalu edhe seance e tetorit nëntorit me na ardhë neve materiali që me shfuqizu se është i kundërligjshëm në seancën e tetorit si kryesues ju e keni konfirmu që të gjitha aktet gjitha propozim vendimet jan të ligjshme tash ku ka ngec kjo procedur qka qe 3 muaj është diferenca kohore që është konfirmu prej MAPL-s që është i kundër ligjshëm Faleminderit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit z.Bajrami, drejtorja për urbanizëm edhe drejtorja për kadastër kan dergu dokumenta shtesë që kanë kërku pjesa e obileskut nuk parashihet të jetë në planet urbanisitike dhe këta i kan pasë disa mbështetje që janë bazu dhe ato ministrit e lindjes ata i kan vonu kërkesat tashtë kanë ardhë në këtë seancë. Unë i kisha sjellë menjëherë, sepse nuk e marr përgjegjësinë, sepse është përgjegjësi për mua direkt nëse nuk e sjelli me kohë. Për atë arsye jemi mundu që të pranohet me dokumente shtesë që i kanë dërgu dy drejtoritë.

z.Jakup Demiri: Nuk deshta me zgjat, se edhe më herët nuk e kemi diskutu. E dimë se si ka kalu puna e obileskut. Sa i përket vendimit të dokumentit në kuvendin komunal, e bëri pyetjen, përgjigjen e morrëm të gjithë që është vonu, për shkak se kanë dashtë të bëjë diçka më tepër drejtoritë. E kam një kërkesë pavarësisht se nuk jemi kundër këtyre personaliteteve që vendosën këto obiliska nëpër qytetin tonë, por vetëm se është pak shqetësuse për vendin tonë. Ky vend a ka edhe shtetas tonë që kanë kontribu për këtë vend apo ta mbushim qytetin vetëm me figura të huja dhe figura që nuk i takojn pjesës me origjin shqiptare.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit z.Jakupi! I ash qe eshte tu pergatit Plani zhvillimor dhe harta zonale, është mirë me i parapa në hapësirat për figura, se kjo po e shohim që është një praktikë që nuk ka me pas mundësi me vendos më asgjë, mirëpo duhet me i parapa ne në planin çka është tu përgatit. Ne e dimë që kur e kemi miratu këtë vendim veq se kanë pas fillu punimet, mirëpo kjo mbet që të inkurporohet që më vonë të jetë e ligjshme. E qesë në votim. Kush është pro shfuqizimit këtij vendimi? Kush është për votim? 21 pro, kundër 1, abstenim nuk ka. Atëhere miratohet shfuqizimi i këtij vendimi.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

5. Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Materialin e keni marrë me kohë dhe në material janë puna e kuvendit dhe e komiteteve. Unë në pika të shkurtura po them që, në kuvendin komunal. Tash e kemi senacen e 11 të rregullt, 1 seancë e kemi mbajtur të jashtëzakonshme, 5 mbledhje i kemi mbajtur soleme, 81 vendime pa të sotit që janë deri tashtë, 1 rregullore, 2 plotësim ndryshime të rregullores dhe një deklaratë deri në seancën e sotme që i kemi miratu ne si kuvend komunal së bashku Komiteti për Shëndetësi; Komiteti për Shërbime Publike; Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport. Komiteti për Liri dhe të Drejtat e Njeriut i ka mbajtur ka 6 mbledhje që janë edhe me ligj të parapamë, ndërsa Komiteti për Planifikim dhe Rregullim të Hapësirave dhe Mbrojtje të Mjedisit i ka mbajtur 4 deri tani. Kjo ka qenë një punë në pika të shkurtura, ndërsa për punën e komiteteve i keni edhe materialin. Nëse ka dikush për diskutim, ndonjë pyetje, janë edhe anëtarët e komiteteve këtu, që mundën të ju përgjigjen. Pasi që nuk ka për diskutim, kjo nuk ka nevojë për votim, pasi që është vetëm informatë.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Informatë për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Faleminderit kryesues! Është formuar një komision i cili e ka bërë edhe hartimin e informatës lidhur me zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë, por njeri prej tyre është në trajnim dhe tjetri kishte probleme shëndetësore, prandaj më obligun që unë të ja u paraqes para juve. Megjithatë besoj që e ka lehtë punën edhe sekretaria e kuvendin komunal, ku me kohë e keni marr edhe materialin. Jeni të njoftum se Komuna e Vitisë e ka të hartuar planin e integritetit dhe në plan janë të përcaktuar edhe fushat e rrezikut, dhe prandaj në kuadër të fushave të rreziikut janë edhe masat e parapara që i ka marr ekzekutivi për eliminim e rreziqeve të cilat mund të paraqiten nëpër fusha. Këtu i keni të detajuar në informatë Prandaj nuk kisha me zgjatë, për ndonjë pyetje shtesë jemi në dispozicionin tuaj.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Informatë për zbatimin e planit të KKS-së për vitin 2022

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Faleminderit kryesues! Prandaj aspekti ligjor i funksionimit në kuvendin komunal edhe si themelues, por donë edhe çështjen e dhënies së informatës apo të raportit për trupat të cilët burojnë nga ky kuvend dhe nga ky kuvend ka buru edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Domethanë, ju e dini që çdo fillim të mandatit themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, të cilët udhëzimi administrativ e specifikon edhe antëtarët e mundshëm të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, por megjithatë vulën e veprimit të këshillit komunal ja jep kuvendi, prandaj ne kemi parapa gjithëherë pasi që është trup që ka punu nga kuvendi të kemi edhe informatën në fundvitit dhe në Janar do ta keni edhe Planin e Punës për Vitin 2023, nuk e kanë lanë të njëjtën seancë, prandaj kjo është informatë që Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi brenda viti 2022 ka pasur aktivitetet e veta. Unë nuk po i lexoj për me ju lodhë, për shkak se materialin e keni marrë me kohë, për çdo pyetje shtesë jamë në dispozicionin tuaj.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e kodeve për participim

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për diskutim, ju ftoj që të votoni këtë pikë të rendit të ditës. Nga të gjithë të pranishmit u miratua kjo pikë e rendit të ditës.

S1 pike e nente e rendit te dites:

9. Miratimin e deklarates pas shqyrtimit të kërkesës së qendrës “Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur”, që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol i viktimave të gjenocidit në Kosovë

Kryesuesi, z.Bekim Azizi lexoj para të pranishmve deklaratën dhe kërkoj që të miratohet kjo deklaratë. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo deklaratë me 24 vota pro, 0 kundër, 0 apstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:00 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prillogje Maqedonia 24-01-2023 Viti

Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetli Prillog	Vlera Vendnost
02-052	02-65		

KOMUNA E VITISË

Informatë (Raport) e Punës së Kryetarit të Komunës për Periudhën Janar – Dhjetor 2022



VITI, JANAR 2023

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

- Hyrje	3
- Përmbledhje ekzekutive	3

KAPITULLI II

Zyrat e Kryetarit të Komunës	4
- Njësia për Auditim të Brendshëm	4
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	4
- Zyra për Barazi Gjinore	6
- Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete	7
- Zyra për Prokurim	7
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun	8
- Zyra Ligjore	11
- Avokati Publik i Komunës	11
- Zyra për Integritet Evropian	12
- Zyra për Projekte	12

KAPITULLI III

Raortet e Drejtorive	13
- Drejtoria për Administratë	13
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	17
- Drejtoria për Inspeksion	20
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	23
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	28
- Drejtoria për Arsim	43
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	48
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	50
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi	54
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	58

KAPITULLI I

Hyrje

Përmbledhje ekzekutive

Të nderuar Këshilltarë të Kuvendit të Komunës!

U bë një vit i plotë që nga çasti kur morra besimin e qytetarëve për mandatin e tretë për të udhëhequr komunën tonë, vit ky, i cili u karakterizua me suksese të shumta në të gjitha segmentet që janë në fushëveprimtarinë e Komunës.

Ajo që kisha primare që në fillim të marrjes së mandatit të parë, ishte t'i përgjigjem zërit të kërkesave të qytetarëve, që për neve ishin edhe udhërrëfyes për projektet e përbashkëta programore, ku realizimi i tyre i suksesshëm nuk ka munguar as në vitin të cilin po raportojmë.

Viti 2022 karakterizohet si një vit mjaftë i suksesshëm, kjo falë angazhimit tonë institucional dhe qytetarëve shumë të rrespektuar, me të cilët kemi pasë një bashkëpunim shumë të sinqertë në realizimin e objektivave tona programore. Dëshmi tjetër është komunikimi i vazhdueshëm dhe i shkëlqyer mes sektorëve të administratës komunale, këshilltarët komunal dhe bashkëpunimi i ngushtë me grupe të ndryshme të interesit. Në vitin të cilin po raportojmë, kemi realizuar programin tonë qeverisës për investime kapitale mbi 98%. ndërsa kemi grumbulluar të hyra vetanake mbi 108%, që do të thotë se kemi tejkaluar planifikimin, kjo si rezultat i punës sonë të palodhshme dhe besimit të qytetarëve në institucionet komunale për t'i kryer obligimet që kanë ndaj komunës. Për rezultatet të cilat kemi treguar si komunë, jemi çertifikuar të pakualifikuar nga Auditori Gjeneral, jemi shpërblyer me grant të performancës nga Ministria për Pushtet Lokal, dhe nga shumë organizata ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Raporti bazohet në aktet juridike të miratuara nga Kuvendi i Komunës, strategjitë me objektivat specifike në disa lëmi dhe përmbledh punën e organeve komunale, por edhe përmban informacion të konsoliduar dhe të dhëna mbi punën njëvjeçare të Komunës.

Në këtë periudhë njëvjeçare kemi miratuar shumë vendime, programe, plane vjetore, strategji lokale si dhe akte tjera juridike, të cilat kanë si qëllim ta shndërrojnë Komunën në institucion ku vendoset mbi perspektivën dhe mirëqenien e qytetarëve. Fokus të veçantë i kemi dhënë arsimit, shëndetësisë, bujqësisë dhe infrastrukturës në përgjithësi, por edhe resorët e tjerë që në përgjithësi janë vlerësuar lartë nga ana e organeve mbikqyrëse të Komunës, duke spikatur angazhimin konkret për një jetë më të mirë të qytetarëve, për shëndetin, për arsimim të gjeneratave të reja, për një të ardhme në agrokulturë dhe agrobiznes, si degë të zhvillimit ekonomik të komunës, e të tjera.

Kemi pasur një bashkëpunimin të mirë me organizata ndërkombëtare dhe investitorë të huaj, në shumë projekte, si me USAID-in, GIZ-in gjerman, Bashkimin Evropian, Caritas Luksemburgun, Projektin DEMOS, OSBE-në, Ambasadën Suedeze, Ambasadën Norvegjeze dhe organizata të tjera.

Në vazhdim të informatës janë të prezantuar aktivitetet e zyrave dhe drejtorive respektive komunale, të cilat në bashkëpunim me stafin janë angazhuar që përmes aktiviteteve të ndryshme të realizojnë me sukses objektivat strategjike të planifikuara për vitin 2022.

KAPITULLI II

Zyrat e Kryetarit të Komunës

Njësia për Auditim të Brendshëm (NJAB)

NJAB për aktivitetet e kryera përgjatë vitit që raportojmë është bazuar në Planin e Punës për Vitin 2022, i cili ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës, ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin për Auditim të Brendshëm (LAB), Udhëzimet Administrativ për Auditim të Brendshëm, Doracakuan e Auditimit të Brendshëm, instruksionet lidhur me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Aktivitetet e kryera janar – dhjetor 2022:

Për vitin 2022 janë planifikuar 4 auditime, ndërsa janë kryer 3. Auditimet të cilat janë kryer janë:

1. Emërtimi i auditimit:

Auditimi Nr.DSHS-22/01

Tema e auditimit: Zbatimi i procedurave të prokurimit public për furnizime me mallra, shërbime dhe punë për vitin 2021

2. Emërtimi i auditimit:

Auditimi Nr. DSHS-22/02

Tema e auditimit: Të hyrat nga Tatimi mbi pronën e paluajstshme për vitin 2021

3. Emërtimi i auditimit:

Auditimi Nr. DSHS-22/03

Tema e auditimit: Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve për mallra e shërbime, komunale dhe subvencione në Administratën Komunale për Vitin 2021 dhe TM -2/2022

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Pavarësisht sfidave që kemi pasur në vitin e kaluar 2022, (greva në sektorin publik), NjMBNj-ja ka gjetur rrugë dhe mundësi për të funksionuar normal dhe për të përmbushur objektivat dhe detyrat që ia ka dhënë vetës në planin e saj të punës.

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2022, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Zyratet Publik, Ligji për Vetqeverisje Lokale, Ligjin e Punës, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën Shtetërore si dhe aktet tjera nën ligjore: Statuti i Komunës dhe Vendimi mbi organizimin e organeve komunale dhe aktet tjera nën ligjore të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Njësia për menaxhimin e Burimeve Njerëzore për vitin 2022 në bashkëpunim me kryetarin e Komunës ka hartuar planin e Personelit në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria për Administratë Publike, Departamenti për Shërbim Civil si dhe drejtoritë përkatëse, në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Mbështetur në këtë kemi klasifikuar këto aktivitete: Konkursat dhe zhvillimin e procedurave të konkursit e kemi kryer në harmoni ashtu si e parashohin ligjet për procedurat e rekrutimit. Komisioni ka qenë profesional dhe vlerësimet i ka bërë në bazë të meritokracisë. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka asistuar sipas kërkesave teknike dhe profesionale ligjore.

Njësia për menaxhimin Burimeve Njerëzore ka bërë këto rekrutime të pozitive:

- **Drejtorja për Administratë, këto pozita:** Katër (4) zyrtarë të gjendjes civile; një (1) zyrtar për mbështetje administrativo teknike të Kuvendit Komunal. Është anuluar për shkak se nuk ka pasur

kandidatë të interesuar. Një (1) zyrtar i Depos. Për këto pozita është shpallur konkursi publik. Konkursit ju janë nënshtruar 38 kandidatë.

- **Drejtoria për Inspektion, këto pozita:** Një (1) inspektor i mjedisit dhe një (1) udhëheqës i Sektorit për Inspektime dhe inspektor i ndërtimit, për të cilat pozita është shpallur konkursi publik. Pozita inspektor i mjedisit është anuar dhe pritet në të ardhmen të procedohet. Konkursit ju janë nënshtruar 3 kandidatë.
- **Drejtoria për Shërbime Publike, këto pozita:** Një (1) zyrtar finaciari (lëvizje paralele), por nuk kemi patur kandidat të interesuar, andaj kjo pozitë është rekrutuar si pozitë e pranimit të jashtëm dhe është përfunduar me sukses. Konkursit ju janë nënshtruar 10 kandidatë.
- **Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster, këto pozita:** Kemi zhvilluar pozitën e lirë për gjeodet në dy fazat (lëvizje paralele dhe të jashtëm), por nuk kemi patur kandidatë të interesuar, andaj kjo pozitë është anuluar dhe së shpejti do të procedohet sipas procedurave ligjore.
- **Drejtoria për Arsim, këto pozita:** Pesë (5) konkurse në muajin Janar, Mars, Qershor, Gusht dhe Dhjetor. Nga të dhënat që rezultojnë në këto konkurse kanë konkuruar mbi 300 kandidatë, duke përfshi personel arsimor: profesor/eshë lëndor, mësimdhës lëndor 6-9, mësimdhënës klasor 1-5, educator/e, punëtor Teknik, psikologë, sekretar, mësimdhënës/e mbështetës, Asistent/e për fëmijë me nevoja të veçanta. Kurse në kuadër të Drejtorisë për Arsim janë pranuar dy (2) zyrtarë: zyrtar për arsimin e mesëm të ulët dhe zyrtar i personelit në DKA. Nga të dhënat statistikore, nga këto konkurse janë pranuar në punë 87 persona, prej tyre disa me kontratë me kohë caktuar, disa zëvendësime.
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, këto pozita:** Dy (2) zyrtarë për mirëqenie sociale dhe një zyrtar për shërbime sociale. Udhëheqes i sektorit të shërbimeve sociale dhe zyrtari ligjor. Konkursit iu janë nënshtruar 27 kandidatë. Në konkursin për pozitën mjekë të përgjithshëm, procedurat e konkursit kanë përfunduar me sukses ku janë pranuar pesë (5) mjekë të përgjithshëm dhe drejtori/eshë e QKMF-së. Kurse procedurave të konkursit ju janë nënshtruar 11 kandidatë.
- **Drejtoria për Financa, këto pozita:** Tre (3) zyrtarë për tatim në pronë janë pranuar sipas konkursit të jashtëm, një (1) zyrtar ligjor (lëvizje paralele), dhe zyrtari i pasurisë (konkurs i brendshëm). Procedurave të konkursit ju janë nënshtruar 29 kandidatë, janë pranuar 5 persona.
- **Drejtoria për Bujqësi, këto pozita:** Poziten, udhëheqës i Sektorit të Pylltarisë (lëvizje paralele), është përfunduar, por pa kandidat të interesuar, pritet të publikohet jashtë. Zyrtar të bujqësisë, procedurë e pranimit të jashtëm, ku kjo procedurë është përfunduar me sukses. Dy (2) roje pylli, është përfunduar procedura e pranimit me sukses. Procedurave të konkursit ju janë nënshtruar 12 persona.
- **Zyra e Kryetarit të Komunës, këto pozita:** Udhëheqes i Auditimit, është përfunduar rekrutimi. Konkursit ju janë nënshtruar 2 kandidatë.

Duke u mbështetur në legjislacionin primar dhe sekondar, e drejta për shfrytëzim të mjeteve juridike në procedurë administrative është parim primar, prandaj mbështetur në këtë, gjatë fazës së rekrutimit si dhe punës së përditshme të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Viti, palët në procedurë administrative kanë shfrytëzuar mjetet juridike. Mbështetur në kompetencë dhe profesionalizëm, këtyre mjeteve juridike u janë përgjigjur komisionet përkatëse.

- Ankesa kemi pasur të cilat i ka shqyrtuar komisioni i ankesave dhe ju ka dhënë përgjigje mbi 15;
- Vendime të shkuarjes në pension të rregullt të tre zyrtarve të shërbimit civil, përpiluar nga zyrtarë të NJMBNJ-së;
- Vendimet për një pagë përcjellëse për tre zyrtarë të shërbimit civil, përpiluar nga zyrtar të NJMBNJ-së;

- Vendimi mbi nderprejen e marrëdhënies së punës për zyrtarët të cilit kanë ndrruar jetë në shërbimin civil, përpiluar nga zyrtarë të NJMBNJ-së;
- Kemi pranuar 5 kërkesa për kompenzime për vdekjet e anëtarëve të ngushtë të familjes, si dhe vendime, shkresa të ndryshme rutinë, që janë natyrë e punës administrative dhe zyrtare, ku vetëm KPMSHCK-së ju jemi përgjigjur me 25 shkresa.

Në kordinim me drejtoritë përkatëse, për të gjithë zyrtarët publik është bërë vlerësimi i rezultateve të punës konform rregullave që janë në fuqi. Ky proces është bërë duke respektuar rregullat, ku mbikëqyerësit të drejtpërdrejt kanë vlerësuar rezultatet në punë të zyrtarëve të tyre, në kuadër të departamentit përkatës. Kurse NJMBNJ-ja ka monitoruar dhe ka sistemuar vlerësimet në dosjet e tyre personale.

Zyra për Barazi Gjinore

Në raport janë prezantuar aktivitetet të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara përgjatë vitit 2022, ku prej tyre veçojmë:

- Takime dhe tryeza me shoqërinë civile, OJQ-të, grupe të ndryshme të interesit, për implementimin e ligjeve të aplikueshme në funksion të të barazisë gjinore (6 takime);
- Organizimi i trajnimeve për obligimet që dalin për komunat nga Strategjia për Mbrojtje nga Dhuna në Familje si dhe procedurat, standarde të veprimit, trajnime këto të organizuara për anëtarët e mekanizmit komunal kundër dhunës në familje (2 trajnime);
- Analiza gjinore dhe përgatitja e buxhetimit gjinorë në kategoritë ekonomike: paga mëditje, subvencione dhe investime kapitale;
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera: zhvillim ekonomik, punësim/mirëqenie sociale, shëndetësi dhe procesin e vendimmarrjes;
- Organizimi i trajnimit për buxhetim gjinor;
- Dhënia e rekomandimeve në fushën e barazisë gjinore në përgjithësi për aktet normative komunale të aprovuara në KK përgjatë vitit 2022 (integrimi gjinor në politika publike komunale).
- Organizimi i fushatës kundër trafikimit me qenie njerëzore, e cila u mbajt nga 18 Tetor dhe përfundoi me 18 Nëntor, ku në kuadër të kësaj fushate është mbajtur një tryezë me akterët relevant që punojnë në këtë fushë (nga niveli qendror dhe lokal), ligjërata nga ekipet e specializuara nga Policia e Kosovës në shkollat e mesme të larta;
- Organizimi i 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore, e cila fushatë ka filluar me datë 25 Nëntor me moton "As edhe një më shumë, raporto mos duro", ku janë realizuar aktivitete të shumta sensibilizuese për parandalimin e këtij fenomeni dhe janë përmbyllur me datë 10 Dhjetor në shënimin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut;
- Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve për vetëpunsim) përmes ndarjes së granteve për zhvillimin e bizneseve (biznese për përpunimin e ushqimit), në partneritet me IADK, IKC, Caritas Zvicerran;
- Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit, për të pranuar ankesat e qytetarëve të Komunës së Vitisë për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet;
- Kemi formuar Këshillin Komunal për Personat me Aftësi të Kufizuara, i cili këshill ka ndërmarr iniciativë të reja për hartimin e politikave komunale për përmirësimin e cilësisë së jetesës së PAK-ve dhe jemi në process të hartimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit 2023-2025;
- Bazuar në Udhëzimin Administrativ për të Drejtat e Fëmijëve, kemi formuar ekipen për të drejtat e fëmijëve, e cila do të jetë me mandat të kryetarit të komunës dhe do të veprojë në bazë të UA-së, si dhe aktivitete tjera kontinuele.

Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete

- Janë kthyer 14 persona gjithsej, ka të kthyer edhe vitet paraprake por të palajmëruar në ZKKK;
- Familje 1 edhe ate nga Suedia (grua me dy fëmijë), e që më vonë e njëjta është transferuar në ZKKK në Gjilan, meqë gruaja e divorcuar ishte banore në Komunën e Gjilanit;
- Një individ nga SHBA, personi ka plotësuar një deklaratë sipas udhëzimit që kam marrë nga Zyrja Regjionale në Gjilan;
- Të gjithë të kthyerit janë kthye me dhunë.

Janë kryer edhe këto punë sipas detyrës zyrtare:

- Vërtetime si dëshmi riatdhesimi 26 persona;
- Formular riatdhesimi me kërkesë të palëve 18;
- Kërkesa 2;
- Vendime për pagesë të qiras 2;
- Monitorime me Zyrën Regjionale në Gjilan, gjithsej 12;
- Mbledhje-takime të KKR (Komisioni Komunal për Riatdhesim) 5 mbledhje KKR;
- Bashkëpunim me OJQ-të, me OJQ “Awo Nurnberg” – Prishtinë;
- Bashkëpunim me OJQ “BGD”, ndihmë psikosociale për të riatdhesuarit;
- Bashkëpunim me Caritasin Zviceran gjithashtu ndihmë psikosociale;
- Trajnim dyditor në Gjilan me temën: ”Zbatimin në praktikë të Rregullorës (QKR) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar”;
- Trajnim tre ditë në Gjilan me Caritasin Zviceran;
- Trajnim 4 ditë në Bogë-muaji tetor: ”Hartimi i Planit të Veprimit Komunal 2023-2025”;
- Trajnim 4 ditë në Bogë – tema “Refugjatët dhe sfidat e tyre”.

Zyra për Prokurim

Bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, Zyra e Prokurimit ka përgaditur këtë raport për kryetarin e komunës, duke përmblodh të gjitha aktivitetet e prokurimit për vitin 2022, në të cilin janë të përfshirë aktivitetet e realizuara të prokurimit deri në lidhjen e kontratave dhe aktivitetet tjera. Me këtë raport do të paraqesim të përmblodhur aktivitetet e prokurimit, të zhvilluara për ofrimin e shërbimeve, zhvillimin e punëve gjegjësisht investimeve kapitale dhe furnizimeve me gjëra të ndryshme bazuar në kërkesat dhe nevojat e AK-së, që janë domosdoshmëri për plotësimin e aktiviteteve të komunës, bazuar në kërkesën e njësive shpenzuese dhe për realizimin e shpenzimeve buxhetore, si dhe për plotësimin e kërkesave të njësive buxhetore dhe mbarëvajtje pa pengesa të aktiviteteve të komunës, si dhe për realizimin e investimeve kapitale të planifikuara sipas buxhetit të këtij viti, e që është në interes të komunitetit dhe rritjen mirëqenies qytetare në përgjithësi, punët dhe aktivitetet që zyra e prokurimit i zhvillon.

Në periudhën e vitit 2022, duke u bazuar në kërkesat e njësive shpenzuese, zyra ka inicuar 68 aktivitete të prokurimit, duke i ndarë ato sipas kategorive ose llojit të ndara në punë: Shërbime dhe furnizime, kemi këto të dhëna: 21 aktivitete me lëndë prokurimi (shërbime), 17 aktivitete me lëndë prokurimi (punë) dhe 30 me lëndë prokurimi (furnizime). Nga këto aktivitete, 63 janë përmbyll si aktivitete, 4 të tjerat janë anuluar, ndërsa një është në procedurë. Ndërsa lloji i procedurave të udhëhequra janë si vijon: 44 raste është përdorë procedura e hapur, 20 raste procedura e kuotimit të çmimit, 1 aktivitet procedurë me vlera minimale dhe 2 aktivitete procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, një miniprocedurë. Prej këtyre aktiviteteve të zhvilluara: 68 aktivitete të prokurimit, janë përmbyll 63 dhe janë finalizuar me nënshkrimin e kontratave, ndërsa 4 aktivitete të prokurimit janë anuluar, një (1) aktivitet është në procedurë të ankimimit.

Zyra e prokurimit përveç këtyre aktiviteteve ka realizuar edhe pagesa për operatorët ekonomik që kanë kryer punë, furnizime apo shërbime sipas kontratave që kanë me komunën tonë.

Shuma e përgjithshme e shprehur në vlerën e kontratave të lidhura është **11,576.929.57 €**.

Ndër aktivitetet që zhvillon Zyra e Prokurimit është edhe nxjerrja e urdhërblereve dhe procedimi i pagesave. Gjatë kësaj periudhe kohore janë lëshuar **1188 urdhërblere** për pagesën e OE-së të kontraktuar, duke udhëhequr lëndët për kompletim dhe janë dërguar në thesar për pagesë, gjegjësisht ekzekutim. Zyra e Prokurimit ka kryer edhe **122 rekomandime** për vendimet e ndryshme të komisioneve për hapje dhe vlerësim dhe komisioneve tjera.

Në fund duhet potencuar se, Zyra e Prokurimit gjatë viti fiskal 2022 ka kryer punë dhe shërbime të ndryshme sipas kërkesave dhe nevojave të të gjithë njësive shpenzuese, duke ofruar këshillime dhe shërbime profesionale, me qëllimin e mbarvajtjes së punëve në komunë dhe respektimin dispozitave ligjore në fuqi, por edhe ka pranuar dhe proceduar të gjitha kërkesat që kanë ardhur nga këto njësi.

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë vitit 2022, respektivisht periudhës Janar-Dhjetor, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e Komunës së Vitisë ka qenë e angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të institucioneve komunale. Fatkeqësisht ky vit është karakterizuar kryesisht me mos funksionimin e rregullt të ëebfaqës standarde të komunave kk.rks-gov.net, që është në përgjegjësi të nivelit qendror. Megjithatë kjo zyre ka vazhduar punën duke përcjellë aktivitetet e rregullta, por edhe të veçanta, si dhe ka njoftuar publikun e gjerë për zhvillimet e gjithmbarshme në Komunën e Vitisë, kryesisht në llogarinë e saj në facebook (për shkak të mos funksionimit të ëebfaqës). Po ashtu nga ZIMP janë përdorur edhe kanalet e tjera informative, si: platforma e konsultimeve publike.

Risi gjatë këtij viti është se, me një vendim të veçantë të kryetarit është caktuar edhe zyrtarja përgjegjëse në platformën e konsultimeve publike. Më poshtë keni disa përmbledhje të publikimeve të bërë në uefaqen zyrtare të komunës, që janë kryesisht më të pakët në krahasim me publikimet e bëra në facebook, për shkak të problemeve të lartëpërmendura:

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun gjatë kësaj periudhe ka publikuar dokumente mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimi në punë;
- Nga procedura e prokurimit janë publikuar 42 kontrata të nënshkruara, 89 njoftime për kontratë, 60 njoftime për dhënie të kontratës, dhe Plani i Prokurimit Publik për Vitin 2022;
- Janë publikuar gjithashtu edhe 172 njoftime publike, 86 vendime të kuvendit komunal, 40 vendime të kryetarit të Komunës, të gjitha draft dokumentet të cilat janë parapar të shqyrtohen në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal;
- Po ashtu janë publikuar edhe disa plane e raporte si dhe dokumentet të cilët ndërlidhen me shpenzimin e paras publike;
- Një bashkëpunim të ndërsjelltë dhe shumë të mirë kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga Komuna e Vitisë edhe përmes fotografive;
- Zyra për Informim publik ka përcjell aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren;
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë;
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tenderë, Njoftime etj;

- Ndërkaq në kuadër të punës së Zyrës për Informim Publik, janë pranuar dhe shqyrtuar 22 kërkesa për Qasje në Dokumentet Publike nga to 17 sosh janë aprovuar plotësisht dhe 5 kanë mbetur pa përgjigje (Sipas raportit final të dërguar në AIP);
- Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtoritë dhe mbledhjet e ndryshme që lidhen me punën e kësaj zyre;
- Janë mbajtur edhe dy debatet e rregullta të kryetarit të komunës me qytetarë;
- Gjithashtu me qëllim të planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2023-2025 në organizimin e Kuvendit Komunal dhe në bashkëpunim me DEFZH janë mbajtur diskutime publike me qytetarë dhe grupet e interesit;
- Më poshtë keni një tabelë të takimeve publike të mbajtur me qytetarë gjatë vitit 2022;
- Nga 9 takime për buxhetin ku kanë marrë pjesë, 254 qytetarë kanë marrë pjesë, 131 janë femra dhe 123 meshkuj.

Evidencat nga pjesëmarrja e takimeve publike Janar-Dhjetor 2022-TAKIMI	Gjini a M	Gjini a F	Gjithëse j	Data
Diskutimi publik për planifikim të buxhetit 2023-2025 me personelin arsimor dhe shëndetësor	25	32	57	16.08.2022
Diskutimi publik për planifikim të buxhetit 2023-2025, gupet sportive dhe komunitetin artistik	23	23	46	17.08.2022
Diskutimi publik për planifikim të buxhetit 2023-2025, gjininë femërore	0	36	36	18.08.2022
Diskutimi publik për planifikim të buxhetit 2023-2025, fermerët dhe bizneset vitiase	25	11	36	18.08.2022
Diskutimi publik për planifikim të buxhetit 2023-2025, Sllatinë e Epërme	9	10	19	18.08.2022
Diskutimi publik për planifikim të buxhetit 2023-2025, Gjylekar	13	6	19	22.08.2022
Diskutimi publik për planifikim të buxhetit 2023 - 2025, Pozheran	20	4	24	22.08.2022
Diskutimi publik për planifikim të buxhetit 2023 – 2025, Komuniteti pakicë	5	2	7	24.08.2022
Diskutimi publik për planifikim të buxhetit 2023-2025. Qyteti i Vitisë	3	7	10	23.08.2022
Konsultim publik për Draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2022-2026	57	17	74	02.11.2022
Konsultim Publik për Propozim Rregullorën për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha për vitin 2023	10	5	15	06.09.2022
Konsultim Publik për Planin e Punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023	12	2	14	06.09.2022
Shqyrtimi publik për PZHK 2022-2030 në Sllatinë të Epërme	6	0	6	24.11.2022
Shqyrtimi publik për PZHK 2022-2030 në Smirë	21	1	22	22.11.2022
Shqyrtimi publik për PZHK 2022-2030 në Pozheran	16	1	17	22.11.2022
Shqyrtimi publik për PZHK 2022-2030 në Skifteraj (Gjylekar)	15	2	17	15.11.2022
Shqyrtimi publik për PZHK 2022-2030 në Viti	35	10	45	18.11.2022
Totali	295	169	464	

Lektori

Gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2022, si lektor Administratës së Komunës dhe i Kuvendit të Komunës së Vitisë kam kryer punë dhe detyra të punës sipas përgjegjësisë zyrtare dhe përshkrimit të detyrave të vendit të punës. Kam lekturuar dokumente zyrtare për Zyrën e Kryetarit, për Kuvendin e Komunës, për drejtoritë, për njësitë dhe zyrat komunale etj.

Gjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2022 kam lekturuar këto dokumente:

1. Informatë (raport) e punës së kryetarit të Komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2021; Informatë (raport) e punës së kryetarit të Komunës për periudhën Janar-Qershor 2022; Kërkesë dy ministrive (27.06.2022), Konkurs 2022-2023 (27.06.2022), Kërkesë për qarkore ligjore (24.01.2022), Konkursi për nxënës 2022, Konkursi për çerdhen e fëmijëve; Konkursi për bursa 2022-2023; “Gëzimi Ynë” 2022, Propozim Vendim (29.04.2022), raporti Janar-qershor 2022 i DKA-së, Aktvendim mbi uzurpimin e tokës (17.03.2022), Kërkesë (07, 09, 24. 03.2022), Informatë nga manifestimi “Flakadani i Karadakut”, Vendim (24.03.2022), Debat publik, KPF (10.06.2022), Vendimet 23.03.2022 (8 vendime), Vendimet 15.02.2022 (9 vendime), Vendimet 20.06.2022 (9 vendime), Vendimet 25.05.2022 (8 vendime), Vendimet 27.01.2022 (8 vendime), Vendimet 27.04.2022 (8 vendime), Vendim i datës 09.09.2022; Vendime 22.07.2022 (7); Vendime 23.09.2022 (15); Vendime 24.10.2022 (5); Vendime 22.11.2022 (5); Plotësim ndryshimi i statutit 16.05.2022), Fakturë 07.03.2022. Vendime 22.06.2022 (3 vendime), Vendime 3.2.2022 (1 vendim), Vendime 19.05.2022 (1 vendim), Vendime 28.02.2022 (1 vendim). Shkresë ministrisë për interpretim ligjor 02.06.2022, Letër OSB-së 23.02.2022, mirënjohje LPK-së 15.06.2022; Njoftimet e ankandeve 12.10.2022, 31.10.2022; Njoftim i DSHPE-së 05.10.2022; Shkresë Ministrisë së Infrastrukturës 02.11.2022; Leje për hapësirë publike 12.10.2022; Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022-2026;
2. Procesverbalet e Kuvendit Komunal (I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX), ftesa për KK (i, II, seanca solemne), Kërkesë 14.01.2022 (2 kërkesa).
3. Procesverbalet e KPF-së (I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX).
4. Procesverbalet e KKS-së (I, II, III, IV, V). Ftesat në KPF (I, III, V).

Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë (Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022-2026).

Zyra Ligjore

- Zyra Ligjore ka ofruar ndihmë juridike, shërbime dhe këshillime për drejtori, zyra dhe sektorë;
- Ka shqyrtuar projekt rregulloret që propozuesit ia kanë dërguar për miratim komiteteve kompetente dhe Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmërinë me ligjet ekzistuese në fuqi dhe Statutin e Komunës;
- 280 propozim vendime;
- 900 përgjigje në kërkesë;
- 20 marrëveshje të bashkpunimit;
- 1200 interpretime ligjore.

Avokati Publik i Komunës

Për vitin, kohën tani për të cilën po raportojmë Janar-Dhjetor 2022, avokati publik i Komunës ka kryer këto punë:

Lëndët e regjistruara gjyqësore për vitin-kohën për të cilën tani që po raportojmë, të të gjithave procedurave gjyqësore janë **41 lëndë të regjistruara**, **24 lëndë** janë lëndë nga procedura civile-në procedurë kontestimore të natyrave të ndryshme, **5 lëndë** janë të procedurës jashtkontestimore, **12 lëndë** janë të procedurës penale, për të cilat lëndë janë ushtruar kallxime penale, të cilat sipas detyrës zyrtare I udhëheqë prokurori i shtetit,

Prej lëndëve kontestimore në procedurën civile të cilat në numër janë **24**, ku avokati kundër këtyre lëndëve ka ushtruar **20 përgjigje** në padi kundër paditësve dhe 7 padi. Të gjitha këto lëndë janë duke u zhvilluar në procedurë gjyqësore, ndërsa nga lëndët e bartura nga vitet paraprak të cilat janë ende në procedurë prej këtyre

landëve të bartura për të cilat janë mbajtur shumë seanca gjyqësore me vite në këtë periudhë, që tani po raportojmë janë përfunduar me aktvendim, aktgjykim, të formës së prerë nga Gjykata e Apelit e R. së Kosovës me mjetin e rregullt juridik, me ankesë dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës me mjete të jashtzakonshme, me Revizion, janë përfunduar 2 lëndë në favor të Komunës së Vitisë, lënda e sharrit e aprovuar në shkallën e parë, dhe me revizion është prish aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, ndërsa 24 lëndët kontestimore, civile të cekura më lartë për periudhen tani që po raportojmë, Janar- Dhjetor 2022 këto, lëndë janë të gjitha në procedurë gjyqësore, disa janë duke u zhvilluar me mjete juridike të rregullta, me ankesë ku kemi ushtruar 9 ankesa, të cilat janë në procedurë ndërsa në përmbartimore kemi pesë lëndë, ku kemi 5 prapsime, ndërsa 12 lëndët penale për veprat penale për uzurpime të pronës komunale-shtetërore nga neni 332 parag.1 i KPRK-ës, që sipas detyrës zyrtare i udhëheq Prokurori i Shtetit. Të gjitha këto janë në procedurën e shqyrtimit gjyqësor, ndërsa lëndë penale të bartura nga vitet paraprake në vitin 2022 janë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë 5 lëndë siq e cekem edhe më lartë. Po ashtu kemi pranuar edhe 22 padi me kërkesëpadi për kompenzim të shpërblimeve jubilarë. Këto padi i përkasin punëtorëve të QKMF (shërbyes publik). Të gjitha janë në procedurë.

Zyra për Integritet Evropian

Zyra Komonale për Integritet Evropian, zyrtari për integritet evropian gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, ka kryer këto aktivitete:

- Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2022 dhe iu ka rekomanduar Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të Kryetarit të Komunës, për plotësimin e objektivave që dalin nga Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2022;
- Kemi mbajtur takim njoftues me Zyrën e Kryetarit të Komunës, Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit;
- Kemi marrë pjesë në takimin e Kolegjiumit të ZKI-ve, me AKK dhe MAPL-në;
- Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së;
- Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës;
- Kemi marrë pjesë në komisionin për riintegrim, në bordin e drejtorve;
- Takime me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për instrumentet financiare të BE-së, informata për TAEX dhe kemi kryer punë shtesë sipas vendimeve të kryetarit të komunës.

Zyra për Projekte

Bazuar në detyrat e punës nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe kërkesat e Zyrës së Projekteve gjatë periudhës Janar - Dhjetor të vitit 2022, kemi punuar në hartimin e projekteve, raporteve të pranimi të tyre dhe mbikqyrjes së zbatimit të projekteve.

Përveç hartimit të projekteve të lartëpërmendura kemi kryer edhe këto punë, si:

- hartimin e detyrave projektuese;
- Pranimin teknik të hartimit të projekteve të ndryshme;
- Pranimin teknike të projekteve të përfunduara;
- Komisione të ndryshme për vlerësim;
- Menagjimi i zbatimit të projekteve;
- Angazhime tjera shtesë sipas kërkesave të menagjimentit.

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

Drejtoria për Administratë

Raporti i Drejtorisë për Administratë për vitin 2022, pasqyron punën e kësaj drejtorie, e cila është realizuar në përputhje me Statutin e Komunës, Planin e Punës, ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative që aplikohen në drejtori.

Si një segment i rëndësishëm i komunës, ku qytetarët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre civile, Administrata ka bërë përpjekje që gjatë tërë vitit të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, duke ju ofruar qytetarëve të saj, si në aspektin kohor dhe atë cilësor, realizimin e të drejtave të tyre me kohë maximale të pritjes 5 minuta, për të gjitha shërbimet që i ofron administrata. Në këtë drejtim fokusi ka qenë realizimi i synimeve programore, respektimi dhe zbatimi i ligjit si dhe akte të tjera juridike, të gjitha këto si parakushte për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, gjithmonë në shërbim të përmbushjes së kërkesave individuale dhe të përgjithshme të qytetarëve, pa asnjë dallim. Këto synime sipas planit tonë të punës dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, avancim të metodës së punës, transparencë dhe efikasitet në punë.

Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie.

I. Sektori për Punë Administrative

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Kryetarit të Komunës, Këshillit të Drejtorëve dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë. Ky sektor ka përgatit ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Këshillit të Drejtorëve, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 11 seanca të rregullta, të jashtëzakonshme 1, solemne 5, urgjente 0. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 10 mbledhje të rregullta. Komiteti për Komunitete ka mbajtur 10 mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta. Kuvendi i komunës ka miratuar: 2 rregullore dhe 1 plotësim-ndryshim të rregullores dhe 85 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të Kuvendit janë përgatit për procedurë për nënshkrim dhe protokollim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrim të Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve. Gjatë kësaj periudhe raportuese Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje konsultative, ditore, javore dhe mbledhje të rregullta, ku janë shqyrtuar materiale të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatit materiali si dhe janë hartuar procesverbale për këto mbledhje. Për nevojat e kryetarit të komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar dokumente të ndryshme, si: vendime, marrëveshje të ndryshme, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Dokumentet e hartuara janë të natyrave të ndryshme, si: propozim vendime për kuvend, të ndarjes së ndihmave financiare, vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve, etj. Zyrtari për përkthim ka përkthyer në mënyrë simulante në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu ka përkthyer edhe të gjitha materialet të cilat kanë dal nga mbledhjet e Kuvendit, KPF, KKSB, Komitetit për Komunitete dhe Këshilli i Drejtorëve.

II. Sektori për Gjendjen Civile

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën Janar - Dhjetor 2022:

Nr	Përshkrimi i Lendeve	totali
1	Ekstrakt nga regjistri qendrori gjendjes civile	17059
2	Certifikata Lindjes	10752
3	Certifikata e martesës	5179
4	Certifikata e Vdekjes	1817
5	Certifikata Vendbanimi	994
6	Deklaratë për bashkësinë familjare	5521
7	Certifikata e gjendjes martesore	1258
8	Certifikata e Shtetësisë	285
9	Vërtetim nga Arkivi	629
10	Vendimet	140
11	Aktvdekjet	208
12	Vërtetimi Mjeteve	51
13	Vizita	86
14	Regjistrimet në LAL të jashtme	213
15	Regjistrimet në LAL të brendshme	24
16	Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme)	71
17	Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme)	148
18	Regjistrimet në LAM të jashtme	93
19	Kurorëzime të reja	476
20	Shkurorëzime	58
21	Humbje Shtetësie	26
22	Fitim Shtetësie	23
23	Clajmrim i vendbanimit	9
	Totali i dokumenteve të lëshuara	45120

Numri i përgjithshëm i dokumenteve të lëshuara për periudhën Janar – Dhjetor 2022 është 45120 dokumente.

III. Sektori për Zyrën Pritëse dhe Arkivin

Zyra Pritëse në kuadër të aktiviteteve të saj të cilat i ka kryer për këtë periudhë raportuese, për periudhën Janar - Dhjetor 2022 janë, si: regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtrësive, shërbimet postare për organet e administratës komunale, ofrimin e ndihmës juridike qytetarëve për plotësimin e kërkesave dhe regjistrimin e kërkesave në protokoll.

Numri i kërkesave të pranuar në Zyrën Pritëse është paraqitë në formë tabelore.

. Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve -L.A.V nga jashtë	48
. Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve -L.A.M nga jashtë	92
. Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve -L.A.L nga jashtë	255
Kërkesa për regjistrim në LAV brenda vendit	118
Deklarata për vendqëndrim	0
Deklarata për trashëgimi	206

Deklarata për përkujdesje financiare	66
Deklaratë për regjistrimin të më vonshëm në LAL	5
Deklarata për regjistrim në LAV	52
Gjithsejtë:	842

LËNDËT E ARKIVUARA

Drejtoritë	Nr. i lëndëve të arkivuara
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	321
Drejtoria për Administratë	35528
Drejtoria për Arsim	1504
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	159
Drejtoria për Financa Ekonomi, dhe Zhvillim	5825
Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport	295
Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit	227
Drejtoria e Inspeksionit	64
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	923
Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	5888
Kuvendi i Komunës	13
Zyra e Kryetarit	767
Zyra për Komunitete	2
Totali	51516

IV. Sektori për Administrim

Ky sektor përfshin shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë: kujdesit për mirëmbajtjen e auto veturave zyrtare të organeve të administratës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Vërejtje: Për punë më efikase dhe menaxhim më të suksesshëm në këtë sektor, duhen të bëhet renovimi i objekteve komunale, autoparkut dhe krijim i hapësirave të nevojshme për punë.

Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën Janar – Dhjetor 2022.

Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë; 35.872.00euro.

- Administrata.....13.060.00€,
- Shëndetësia 13.271.00€ dhe
- Njësia e zjarrfikëseve..... 9.541,00€

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, gjenerator, nxehje qendrore dhe autorizime për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: 61698 lit.

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: 46210 litra

- Administrata17210 litra (Zyra e kryetarit, DKA dhe autorizimet),
- Shëndetësia 18619 litra, dhe
- Njësia e zjarrfikës10381 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për nxehje qendrore për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: 12521 litra naftë.

- Administrata..... 10030 litra
- Drejtoria për Kulturë..... 0 litra
- Shëndetësia 2491 litra,
- Njësia e zjarrfikësve.....0 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësitë shpenzuese janë:
2967 litra.

- Administrata..... 620 litra,
- Shëndetësia..... 1044 litra,
- Njësia e zjarrfikësve 288 litra.
- DKA-ja (shkollat) 1015 litra.

Shpenzimet e sigurimeve te automjeteve: 8.983.0 Euro.

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësor, në veçanti:

- Ka zbatua hardëere, Softuerin Kompjuterik dhe të qasjes me internet;
- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kycje sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2022

Nr.	Emërtimi	Nr.Intervenimeve	Vërejtje
1	Risetimi i passëord të Domenit	150	
2	Hapja e Userve të Domenit	45	
3	Hapja e Userave të Intranetit	13	
4	Intervenimet në Usera	100	
5	Intervenimet në rrjetin qeveritar	150	
6	Intervenimet në programe	150	
7	Konfigurimi i sëiqit	0	
8	Intervenimet në Gjendjen Civile	150	
9	Intervenimet në Tatimin Pronë	65	
10	Futja e kompjuterëve në Domen	90	
11	Instalimi i softëare	00	
12	Instalimi i computerhardëaredevices	00	
13	Rregullimi kablllove të internetit	70	
14	Intervenimet në E-mail	150	
15	Hapja E-mail Zyrtar të reja për zyrtar Komunal	35	
16	Intervenimet në Intranet	150	
17	Monitorimi i Kuvendit përmes Teleprezencës	0	
18	Drejtoria Arsimit	30	
19	Qendra për punë sociale	60	
20	Telefonave VOIP	35	
21	Asistimi ne rregullimin e fotoko.,printe etj	250	
22	Përkrahja ne takime virtuale	32	
	Gj i t h s e j	1855	
1. Mirëmbajtja e Serverit çdo ditë 2. Mirëmbajtja e Intranetit çdo ditë 3. Mirëmbajtja e Gjendjes Civile çdo ditë 4. Mirëmbajtja e pasurisë çdo ditë			

5.Sistemi për menaxhimin dhe arkivimin elektronik të dokumenteve çdo ditë

6.Menagjimi i disa kontratave

7.Trajnime të ndryshme virtuale dhe fizike

Zyrtari për pranimin e mallit, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 ka punuar në harmoni me përshkrimin e vendit të punës, ku ka realizuar objektivat që parashihen me planin e punës gjatë kësaj periudhe.

Pranues i mallrave ka kryer këto detyra të punës:

- Pranimin dhe regjistrimin e mallrave në sistemin e menaxhimit të Pasurive (E-Pasuria), ku në të përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet komunale ku vlera e këtyre materialeve është 49104.95 € apo mbi 87 lëndë.
- Janë bërë mbi 120 kërkesa për furnizime me material për zyre dhe inventar.
- Janë bërë furnizime me material shpenzues si dhe inventar për të gjithë njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë, duke përfshirë Zyrën e Kryetarit dhe të gjitha drejtoritë tjera dhe komunitetet.
- Kemi asistuar në disa paramasa për furnizim me material shpenzues, si dhe ka kryer detyra tjera që iu janë besuar nga menagjimenti i Komunës.

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

Raporti i DFEZH, është një përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të cilat janë kryer përgjatë vitit 2022
Aktivitetet e kryera:

I . Sektori për Buxhet dhe Thesar

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor, Sektori për Buxhet dhe Thesar ka kryer këto punë:

- Përgatitjen e pasqyrave financiare të vitit 2021, në mënyrë analitike, barazimi me sistemin e freebalancit dhe arhivën komunale për vitin 2021 dhe nxjerrjen e analizës të ekzekutimit të buxhetit për vitin përkatës;
- Përcjellja e fondit të pagave dhe sistemimi i punëtorëve në sistemin e pagave nëpër të gjitha programet sipas planifikimit të buxhetit për vitin 2022 në ato programe ku është dashur të bëhen ndryshime.
- Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare Janar - Dhjetor 2021 – (barazimi me MFPT-in), dërgimi i tyre në MFPT;
- Përgatitja dhe regjistrimi i të dhënave dhe aprovimi në Sistem të Cash- Planit për vitin 2022;
- Kemi përgatitur raportin e vetëvlerësimit të Komunës së Vitisë dhe dërguar në MF;
- Punët e vazhdueshme me MFPT-në, Departamentin e Buxhetit Komunal dhe Departamentin e Thesarit;
- Kërkesën për bartje të buxhetit nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022, i tëri i shpërndarë në kategorit ekonomike e programe buxhetore;
- Kontrollimi i deklaratave të disponueshmërisë së mjeteve në kategori të ndryshme ekonomike dhe nënshkrimi i tyre, duke u bazuar në planifikimin e buxhetit për vitin 2022, në bazë të planifikimit të prokurimit për vitin 2022;
- Dhënia e informacioneve për të gjithë udhëheqësit e programeve buxhetore mbi gjendjen e rrjedhës së parave të gatshme për tremujorin e vitit;
- Barazimi i regjistrave të pasurive mbi 1000 € të regjistruar në freeballanc si dhe regjistrimi në regjistra interne të pasurive me kode ekonomike dhe me programe buxhetore si dhe të dhënat e tjera, si: amortizimi edhe regjistrimi në programin e aseteve nën 1000 €, “E pasuria”;
- Zotimin e mjeteve (2469 lëndëve) për të gjitha programet buxhetore dhe në të gjitha kategoritë ekonomike, varsisht nga kërkesa e autorizuesve të buxheteve përkatëse;
- Raportimi i shpenzimeve në MFPT-në, departamenti i thesarit, për çdo muaj;

- Raportimi mujor i obligimeve të papaguara dhe raporti i obligimeve kontraktuale në MFPT-në; Departamentin e Thesarit deri më datë/dita fundit e muajit, kurse raporti më datë 15 të muajit raportues;
- Përgatitja e pasqyrave financiare e tremujorit të parë, tremujorit të dytë dhe tremujorit të tretë 2022;
- Ofrimi i dokumentacionit rreth përgaditjes së PVF-2021, me auditorin gjenaral dhe komentimi i dokumenteve rreth përgaditjes së PVF-së për vitin 2021;
- Përgatitja e Qarkores së parë dhe të dytë interne komunale 2023/01 dhe shpërndarja e saj tek autorizuesit e programeve buxhetore;
- Përgatitja e KAB-it komunal 2023-2025 dhe dorëzimi në KPF dhe Kuvendin Komunal për aprovim;
- Konsultime të vazhdueshme me drejtorët e drejtorive rreth inicimit të shpenzimeve të ndryshme komunale në kategoritë ekonomike, si: në mallra e shërbime, subvencione dhe shpenzime kapitale;
- Regjistrimi i të hyrave vetanake komunale në periudhën Janar - 19 Dhjetor, në vlerë prej 945,114.49 €, si dhe të hyrat indirekte në vlerë prej 173,877 €. Do të thotë totali i të hyrave vetanake Janar - Dhjetor në vlerë prej 1,118,991.49 €, do të thotë realizimi i planit vjetor prej 113.27 %, të hyrat e mbrendshme – participim i qytetarëve, shuma prej 36.006 € si dhe të hyrat e grantit të performances, shuma prej 219,130.89 €;
- Përgatitje e plan buxhetit për vitin 2023-2025, përgatitja e të dhënave në sistemin e BDMS-së dhe dërgimi në MFTP; dhe punë e detyra tjera sipas paraqitjes së nevojave komunale, etj.

II . Sektori për Tatim në Pronë

- Ofrimi i shërbimit të qytetarëve për kryerjen e detyrimeve tatimore nga tatimi mbi prone;
- Ofrimi i shërbimit për pagesën e taksës komunale për automjete dhe mbajtja shënimeve tjera;
- Ofrimi i shërbimit për biznese dhe punë tjera sipas kërkesave të palëve;
- Dhënia e këshillimeve palëve për kushtet e pagimit të tatimit;
- Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2022 janë shërbyer mbi 3311 qytetarë me vërtetime për shërbime të ZKK-së dhe nevoja personale, vërtetime sociale janë shërbyer 607 qytetarë, humbje të shtetësisë janë shërbyer;
- 92 qytetarë me vërtetime, korrigjim të emrit dhe mbiemrit janë shërbyer 49 qytetarë me vërtetime.
- Janë inkasuar 488,877.47 € nga tatimi në pronë dhe 99,191.00 € nga taksa e automjeteve. Realizimi i planit vjetor për tatimin në pronë shprehur në përqindje është 82.50 %. Këtë inkasim e kemi arritur me rastin e kushtëzimeve të dhënies së vërtetimeve për ZKK-ë dhe me rastin e përpilimit të listës për të përmbaruesi privat prej: 113 obliguesve mbi 1,000.00 €, ku 50 prej këtyre tatimpaguesve kanë bërë marrëveshje për pagesën me këste dhe janë dërguar 398 letër kujtesa për obliguesit mbi 300.00 € deri 1,000.00 €. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi 22,181.04 € më shumë inkasim nga tatimi në pronë, kurse nga taksat për automjete janë inkasuar 7,820.00 € më shumë në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar;
- Rianketim dhe Anketim: Janë rianketuar 2815 prona, janë regjistruar 607 objekte të reja dhe kemi bërë rishikimin e lëndëve dhe shënimeve për tatimpaguesit gjatë viteve të tjera dhe punë të tjera administrative, duke përmirësuar shumë gabime në evidencat e bëra nga vitet e kaluara, duke verifikuar gjendjen në teren dhe marrjen e fotove;
- Raportimi për të hyrat e realizuara nga tatimet dhe taksat në periudha të caktuara kohore, javore, si dhe mbajtja e shënimeve dhe evidencave.

III. Sektori për Ekonomi dhe Zhvillim

Gjatë kësaj periudhe kohore në kuadër të Sektorit për Ekonomi dhe Zhvillim kemi kryer një sërë aktivitete, ndër to do t'i veçoja:

- Shqyrtimi i tetë lëndëve (kërkesa) të qytetarëve për shfrytëzim të pasurisë publike, të cilat Drejtorinë e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Mbajtem takim me zyrtarët komunal për hartimin e planit zhvillimor ekonomik lokal;
- Takim pune me zyrtarët për pranim të investimeve;
- Përpunim i materialit për projektet investive publike (PIP) për vitet 2022, 2023 dhe 2024;
- Plotësimi i formularit (pytësori), i cili do të mundësoj ekipit punues në hartimin e programit nacional për zhvillim ekonomik lokal;
- Prezentimi i strategjisë së Planit Zhvillimor Ekonomik Lokal 2022 – 2026, me nxjerrjen e formës së parë draftë. Ky dokument u paraqit në dëgjim publik, pastaj u paraqit në Komitetin për Politikë dhe Financa, e në fund u paraqit në séancë të Kuvendit Komunal, ku ju dha edhe forma finale.

IV. Zyra për Regjistrimin e Bizneseve

- Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2022 janë regjistru 197 biznese të reja;
- Ndryshime në biznese 116;
- Gjatë kësaj periudhe janë shuar 34 biznese;
- Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 267 punëtorë.

V. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2022 të financuara nga buxheti i Komunes së Vitisë , buxheti i nivelit qendror dhe donacionet.

1	Asfaltimi i rrugës Viti-Sllatinë e Ultë
2	Asfaltimi i rrugëve rurale
3	Rregullimi i rrethojave të Ambulantave
4	Rregullimi i kanalizimeve
5	Rregullimi i rrugëve me zhavor
6	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik
7	Rregullimi i hapsirave gjelbruese – publike
8	Rregullimi i fushave sportive
9	Rregullimi i lumenjëve (kanaleve) dhe prrockave
10	Riparime nëpër shkolla
11	Renovim i ambulantave në proces të prokurimit
12	Paisje mjeksore
13	Rregullimi i rrugës Anton Qeta – Sejdiu Stubëll e Epërme
14	Ndërtimi i shkolles fillore në Pozheran
15	Palestra e sporteve në Drobesh (Punimi i konstruksioni të kulmit me kapriate) në proces të realizimit
16	Rregullimi i rrugës Viti-Korbliq-Kaqanik
17	Ndërtimi i infrastructures në parkun industrial Budrike
20	Renovimi i objektit për incubator të biznesit

21	Renovimi dhe zgjerimi i rrugës Kongresi i Manastirit në Viti faza II
22	Rregullimi i ujësjellësve në Komunën e Vitisë (CDI)
23	Asfaltimi rrugës Viti – Mjak

Drejtoria për Inspeksion

Gjatë kësaj periudhe një vjeqare, është bërë punë e konsiderueshme në të gjithë sektorët në Drejtorinë e Inspeksionit, me një qëllim të vetëm që të jemi në shërbim të qytetarëve në ruajtjen dhe kujdesin e ambientit të përgjithshëm duke e respektuar ligjin dhe duke bërë inspektime të rregullta.

Inspektorët për treg

- Procesverbale në aspektin e zbatimit të ligjit për Nr:03/L-181 63;
- Inspektime UA. 03/2022 për Rregullimin e Çmimeve të produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtitshëm, ku gjatë kontrolleve të ushtruara janë verifikuar edhe çmimet furnizuese dhe shitëse, në disa raste, disa biznese kanë operuar me çmime më të ulta se çmimet tavan, si dhe mbi 5 raste, ku nuk kanë funksionuar tabela e çmimet elektronike, por me urdhërverbal në ditët tjera janë funksionalizur 25;
- 42 kërkesa për pranim teknik të lokaleve në shumë prej 2305.00 €;
- Aktvendime për pranim teknik të lokaleve sipas kërkesave të parashtruara 42;
- Proqesverbale të komisionit për pranim teknik 42;
- Ankesa të konsumatorve, e në dy raste janë zgjidhur në favor të konsumatorve, ndërsa një ishte në dobi të shitësit 3;
- Inspektime në fushën e kontrollit, identifikimit të rritjes së çmimeve të artikujve bazik. siç janë vaji dhe produktet tjera bazike dhe në bashkrendim me institucionet e inspektoratit të tregut në kuadër të MTI-së dhe udhëzimeve të pranuar 17;
- Kontrollë të përbashket gjatë oreve të natës me PK-në, Njësia Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 1;
- Inspektime në aspektin e vendosjes së flamurit pran artikujve sipas prejardhjes së produkteve 15;
- Kontrolle mbi kualitetin, cilësinë, sigurinë e produkteve në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve;
- Jane kontrolluar edhe banratorët bujqësorë, ku vërehet një mungesë e artikujve elementar për mbjelljet vjeshtore si dhe ngritje e madhe e çmimeve furnizuese;
- Kontrolle për ndalim të artikujve – lodra për fëmijë, imitim i rrezikshëm i produkteve ushqimore, kryesisht inspektimet janë fokusuar në veprimtaritë gjithëçka 1 €, por edhe në supermarketet që posedojnë artikuj të tillë 8;
- Inspektime në autoparkingjet, ku janë urdhëruar vendosjen e çmimoreve për shërbimet e tyre dhe orarin e punës 3;
- Inspektime mbi çmimet dhe sasinë e dhe llojin e furnizimit të plehut artificial në barnatoret bujqësore, ku janë evidentuar furnizuesit e shitësve me pakicë, çmimet, llojet dhe sasia në dispozicion për fermeret 10;
- Gjatë kësaj periudhe si biznesi që kanë startuar kryesisht në veprimtarisë, si: banmatoreve farmaceutike dhe ordinancave të tjera mjekësore, masazhet dhe kafiteritë apo restorantet;

- Vizita tjera në biznese në aspektin e zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-181, dhe dispozitave tjera mbi peshen dhe njësitë matëse, çmimet e artikujve, shpallja e emërimit të biznesit, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë, e pajisje me pranim teknik të lokalit 45.

Inspektori për komunikacion

- Kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarë të ndryshëm, si dhe subjekte, si Operatorët e Transportit, po njëjstu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjithë përfaqësuesit e Auto-Shkollave, dhe subjektet tjera që ishin të lidhur apo të interesuar për Gjendjen në Komunikacion, si Shoqëri civile Media etj;
- Kemi menaxhuar furnizimin dhe vendosjen e shenjave të komunikacionit sipas vendimit të kryetarit të Komunës në tërë territorin e Komunës së Vitisë;
- Është shenjëzuar vija e ndarë e mesit të rrugës e ndërprer, e thjesht reflektuese.....4276 m;
- Është shenjëzuar vija e ndarë e mesit të rrugës e ndërprer, e plastifikuar.....7218 m;
- Është shenjëzuar vijë e plotë ndarëse e mesit të rrugës, e plastifikuar.....3990 m;
- Është shenjëzuar vija e plotë e mesit të rrugës, e thjesht, reflektuese.....7673m;
- Është shenjëzuar vija anësore me ngjyrë të thjeshtë, reflektuese.....222203m;
- Janë shenjëzuar vendkalimet për këmbësor, të plastifikuara.....1707.23 m2;
- Janë vendosur shenja vertikale të ndryshme.....79 copë;
- Janë vendosur shtylla gyp i zinguar Ø60 mm L=3M121 copë;
- Kemi përpiluar procesverbale sipas detyrës zyrtare, si: leje, vërejtje, njoftime.....10;
- Kemi përpiluar procesverbale mbi shikimin e automjetit për transport publik – taxi.....54;
- Procesverbale për kontrollimin e autobusëve.....4;
- Kemi përpiluar një procesverbal për kuqe në rrugë.....1;
- Kemi përpiluar fletëpagesa për taksa komunale dhe ate për kontrollimin e automjeteve, autobusëve dhe Pëlqime për kuqe në rrugë57;
- Kemi lëshuar leje për vendosjen e pengesave në rrugë.....4;
- Kemi bërë pranimin teknik të lokaleve së bashku me ins. e tregtisë.....42.

Udhëheqësi i sektorit për inspektime dhe uzurpime

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë kryer punët dhe detyrat nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon:

- Kompletimin e lëndëve në lëminë e uzurpimeve të tokës në pronësi publike-komunale;
- Evidentimin e rasteve të reja sa i përket Uzurpimeve të pronës publike;
- Lirim të pronës së uzurpuar publike dhe lirim të hapësirave publike me qëllim të relizimeve të investimeve në infrastrukturë publike nga ana e institucioneve komunale;
- Inspektimet së bashku me inspektorin e tregut lidhur me inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, mbrojtjen e konsumatorit;
- Inspektimet e punimeve dhe pajisjes me leje përkatëse nga Ministria dhe sipas kërkesave për raste konkrete, si dhe ndalimi i punimeve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme;
- Inspektimi së bashku me inspektorin e Ambientit dhe Shërbimeve publike rreth ndotësve të ambientit, inspektimi i tregjeve, rrugëve, trotuareve, e sidomos inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale;
- Inspektimi së bashku me inspektorin e Ambientit dhe Shërbimeve publike sa i përket shfrytëzimit të hapësirës publike nga lokalet në Viti dhe Pozharan, dhe obligimi i tyre për tu pajisur me leje përkatëse nga Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- Janë kryer edhe punët tjera sipas kërkesave të Drejtorit të drejtorisë dhe obligimeve ligjore për inspektime në teren;

Gjatë periudhës raportuese Janar-Qershor 2022, në kuadër të Sektorit për Inspektime janë realizuar këto aktivitete nga udhëheqësi i sektorit e të cilat janë të veçanta nga inspektimet e përbashkëta:

➤ Inspektime	75
➤ Procesverbale.....	50
➤ Kallëzime penale.....	01
➤ Vendim për lirimin e pronës publike.....	2
➤ Kërkesa për lirim të hapsirës publike	10
➤ Lirim të hapsirave publike (Kioskat te posta)	8
➤ Kërkesa dhe pergjegje të ndryshme	15

Inspektori për mbrojtje të mjedisit

➤ Proqesverbale të shkruara në teren	69
➤ Inspektime të objekteve pa leje mjedisore komunale	2
➤ Deklarata në Policinë e Kosovës lidhur me vjedhje të aseteve të pronës publike.....	01
➤ Shpërndarje të njoftimeve për mbrojtjen e Mjedisit	10
➤ Inspektime në teren në gjithë territorin e Komunës së Vitisë.....	251
➤ Vendosja e tabelave ndalohet hudhja e meturinave.....	6
➤ Trajtimi i qeneve endacak me kastrim, vaksinim dhe hospitalizim	241
➤ Trajtim me eutazi i qenve endacak	37
➤ Trajtim me largim nga rruga i qenve endacak	6
➤ Rast per polici dhe prokurori për marrjen e dheut ne bankinat e lumit “Morava”	1
➤ Dalje në teren lidhur me mbeturinat në hapësira publike	65
➤ Dalje në teren pas perfundimit të orarit të punes.....	16
➤ Gjoha mandatare të shqiptuara sipas Rregullores Komunale për Gjoha dhe Ngarkesa....	13
➤ Konsultime me palë në zyrë lidhur me kerkesat e tyre.....	145
➤ Marrja pjesë me inspektime te perbashkta me inspektorin e shërbimeve publike dhe të uzurpimeve.....	50
➤ Kërkesa dhe Përgjigje në kërkesa.....	5

Inspektori për shërbime publike

➤ Proqesverbale të shkruara në teren	56
➤ Deklarata në Policinë e Kosovës lidhur me vjedhje të aseteve të pronës publike	03
➤ Shpërndarje të njoftimeve të bizneset që shfrytëzojn hapsirën publike komunale	50
➤ Inspektime të bizneseve se a janë pajisur me leje për shfrytëzim të hapësirave publike	50
➤ Dalje në teren me zyrtarin e ShP-së për matjen e hapësirave për dhënien e lejeve.....	15
➤ Dalje në teren me zyrtarin KRU “HIDROMORAVA”	16
➤ Dalje në teren lidhur me mbeturinat në hapësira publike.....	45
➤ Dalje në teren pas përfundimit të orarit të punes	13
➤ Gjoha mandatare të shqiptuara sipas Rregullores Komunale për Gjoha dhe Ngarkesa....	05
➤ Proqesverbale me autorizim nga inspektori i uzurpimeve.....	01
➤ Takime konsulatative me administratorët e fshatrave	52
➤ Konsultime me palë në zyrë lidhur me kerkesat e tyre	70
➤ Inspektime me inspektorin e ambientit nga Minsitria e Ambientit.....	07
➤ Inspektime të përbashkta me inspektorin e ambientit dhe inspektorin e uzurpimeve.....	21

Inspektori për ndërtim

- Vizita në teren dhe inspektime të objekteve 125
- Procesverbale mbi inspektimin e objekteve të reja ndërtimore 50
- Inspektime të objekteve me leje ndërtimore.....25
- Inspektime të objekteve pa leje ndërtimore.....21
- Vendime për nderprejen e punës21
- Kllëzime penale.....7
- Konsultime me palë 105

Gjeodeti

- Matje dhe Evidentime në teren10
- Kopje planit.....8
- Asistime gjatë inspektimeve me Inspektorin e Ndërtimitaris në objektet me leje ndërtimore .. 25
- Asistime gjatë inspektimeve me Inspektorin e Ndërtimitit në objektet pa leje ndërtimore..20
- Asistimi gjatë inspektimit me udhëheqësin e inspektimeve.....10

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë ka punuar me kapacitete të plota në ofrimin e shërbimeve komunale për qytetarët për ambient më të pastërt, infrastrukturë më funksionale dhe ndërhyrje sa më efikase në paraqitjen e emergjencave. DSHPE-ja në bazë të organogramit është e përbërë nga dy sektorë: Sektori për Shërbime Publike dhe Sektori për Emergjencë. Sektori për Shërbime Publike ka katër zyrtarë, ndërsa Sektori për Emergjencë ka tre zyrtarë. Në kuadër të drejtorisë, Sektori për Emergjencë është edhe shërbimi i njësitit të zjarrfikësve, që ka 25 punëtorë profesional, si dhe inspektorin e preventives ndaj zjarrit.

1. Sektori për Shërbime Publike

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2022, ky sektor ka pranuar gjithsej 324 kërkesa të protokoluara të natyrave të ndryshme, të cilat janë kryer në afatin ligjor. Kemi lëshuar vendime të ndryshme, leje për parkim, shfrytëzimin e hapësirave publike, dëftesa për pagesa për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave, vazhdimi i lejeve për auto-taxi rreth 55, etj. Gjatë kësaj periudhe kemi përcjellur punët e operatorëve të kontraktuar nga Komuna, të cilët kanë kryer shërbime për Komunën.

1.1 Buxheti i drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencë

DSHPE-ja për vitin 2022 ka pasur buxhetin e aprovuar dhe atë në shumë prej 110,5457.85, përderisa alokimi i mjeteve është 110,5457.85 €, ndërsa është shpenzuar 105,5988.64 €, në përqindje 95.00%.

Shpenzimet për komunal:

Për shpenzime komunale kemi të aprovuara 177,000.00 Euro. Shuma e përgjithshme e shpenzuar për komunal është 138,059.92 Euro, shpenzimi për komunal në përqindje është 78.00 %, duke mos i përfshirë obligimet e muajit Dhjetor të vitit 2022, për PTK, ECO-Higjiena, Hidromorava, KES/CO, të cilat barten për vitin 2023.

Shpenzimet për mallëra dhe shërbime:

Për mallëra dhe shërbime kemi pasur buxhet të aprovuar prej 711,967.90 Eurove, të alokuara 711,967.90 €, të shpenzuara 710,683.40 €, duke mos përfshirë edhe obligimet për muajin dhjetor të vitit 2022. Pra, Drejtoria gjithsejtë për mallëra dhe shërbime nga mjetet e alokuara ka shpenzuar 99% për vitin 2022, duke mos i përfshirë edhe disa fatura të vitit 2022 të cilat barten në vitin 2023.

Të hyrat vetanake

Tabela e të hyrave vetanake të planifikuara dhe të realizuara 2022

Nr	Përshkrimi i të hyrave	Realizimi vjetor për 2022	
1	Qiraja	14,044.00 Euro	
2	Shfrytëzim të hapësirës publike	14,664.30Euro	
3	Reklamat	843.50 Euro	
4	Taksa për licenca tjera për afarizëm. (leje per autotaksi) dhe shërbime të tjera profesionale.	490.00 Euro	
5	Parkimi publik	708.00 Euro	
6	Gjoba	25.00 Euro	
	Gjithsej	30,774.80€	

Të hyrat vetanake, të planifikuara për vitin 2022 kanë qenë gjithsej 33,355.00€ Euro. Janë të realizuar 30,774.80 Euro, në përqindje janë realizuar 92.00 % të të hyrave vetanake.

1.2. Mirëmbajtja verore – dimërore e rrugëve lokale

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor janë përcjellur punët e kompanisë për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve, si: pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, mbushja e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt, pastrimi i bankinave të rrugëve lokale nga barnishtat dhe shkurret, vendosjen e mbrojtëseve në disa ura, etj.

1.3 Transporti publik

- Organizimi i transportit publik në Komunën e Vitisë është i rregulluar sipas rregullores për organizimin e transportit brenda territorit të komunës, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë me dt. 27.05.2014. dhe Ligjin për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179;
- Transporti publik i udhëtarëve në Komunën e Vitisë është i organizuar në transport urban dhe urban – periferik, i cili realizohet përmes kompanive private të transportit, pasi që komuna nuk ka kompani publike të transportit të udhëtarëve;
- Transporti urban është i organizuar me auto-taksi brenda qytetit, pasi transport urban nuk kemi;
- Transporti publik për periudhën Janar–Dhjetor 2022 është bërë organizimi i rrethit të operatorëve për transportit publik urban dhe Urban – periferik, njëherit është përcjellur mbikqyrja e transportit publik. Në Komunën e Vitisë. Transporti publik ka këto vendbanime: Pozharan, Sllatinë e Poshtme, Sllatinë e Epërme, Tresenik, Sodovinë e Qerkezve, Sodovinë e Jerlive, Drobesh, Smirë, Verban, Gushicë, Gërmovë, Gjylekarë, Terpezë, Lubishtë, Ramnishtë, Remink, Radivojc, Letnicë Stubëll, Budrikë.

1.4 Mirëmbajtja e Hapësirave të hapura publike (HHP)

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, hapësirave gjelbëruese, trotuarëve, mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parkut të qytetit të Vitisë. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor janë mirëmbajtur gjithsej 110,496.00 m² hapësira publike. Lloji i hapësirave publike: sheshe janë 172,68.00 m²; parqe janë 44,952.00 m²; HHP pranë lapidarëve janë 7,764.00m² ; varrezat e dëshmorëve në Viti, varrezat e martirëve në Skifteraj 10,941.00 m²; varrezat e qytetit 18,553.00 m²; shëtitëria Viti-Binçë 3,521.00 m²; shtrati i lumit “Morava” nga stacioni i autobusi janë 7,437 m². 20. Hapësira publike janë me ndriçim publik; Rrugë dhe trotuar janë 122,934.00 m² dhe vetëm trotuar janë 68,200.00 m².

Me hapësira të hapura publike (HHP) të përfshira në këtë projekt nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rendësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytet e Komunës së Vitisë, siç janë: parqet, sheshet, shëtitorja Viti-Binë, shtrati i lumit "Morava", sipërfaqe gjelbëruese, hapësirat për parkim automjesh, rrugët në qytet, trotualet në qytet dhe lokalitetet e komunës, tregjet, lapidarë, pllakat përkujtimore, varrezat e dëshmorëve dhe varrezat e qytetit të Vitisë. Është bërë edhe krasitja e drunjëve dekorativ në qytet, mbjellja e drunjëve dekorativ, mbjellja e luleve në qytet etj.

1.5 Mirëmbajtja e objekteve të administratës komunale, shëndetësore dhe arsimore

Gjatë kësaj periudhe Janar - Dhjetor janë mirëmbajtur dhe pastruar objektet e administratës komunale, shëndetësore dhe arsimore. Në këtë projekt janë paraparë hapësira të brendshme dhe të jashtme, të mirembahen si dhe pastrohen. Janë mirëmbajtur gjithsej 71,489.00 m², ku hapësira të brendshme janë 15,873.00 m² dhe hapësira të jashtme (oborret e objekteve) janë 55,616.00 m². Në këtë projekt janë të punësuar 30 punëtorë nga Komuna e Vitisë.

1.6 Mirëmbajtja e ndriqimit publik dhe dekorimi i qytetit.

Në komunën tonë kemi gjithsej 10,882.00 copë llampa elektrike, të cilat janë të vendosura në shtylla elektrike druri, betoni dhe shtylla metalike të zinguar. Kemi tre llojë të llampave elektrike: llampa me natrium-(zhivë)-100 copë, poça ekonomik 65 Ë- 4,233.00 copë dhe të llojit LED 100Ë, 50V, 11Ë, 16Ë - gjithsej 6,549.00 copë. Në këtë raport nuk janë përfshirë dhe llogaritur trupat ndriqes që komuna këtë vit i ka bërë në ndriqimin publik, qe do të thotë se kemi diku mbi 11,000.00 trupa ndriqes në territorin e komunës sonë, të cilët mirëmbahen, ndërsa për ndriqimin dekorativ për këtë vit është shfrytëzuar materiali i vitit të kaluar me punëtorët e hapësirave gjelbëruese dhe është dekoruar sheshi i qytetit. Në këtë mënyrë kemi kursyer një vlerë të konsiderueshme të mjeteve, duke ju falënderuar zyrtarit për menaxhimin e ndriqimit.

1.7 Ujësijellësi dhe kanalizimi

Në komunën e Vitisë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësijellësit dhe kanalizimit, përgjegjëse është kompania regjionale "Hidromorava", njësi në Viti. Komuna dhe kompania "Hidromorava" kanë një bashkëpunim të ndersjelltë. Kompania në fjalë bënë edhe furnizimin me ujë të pijshëm dhe mirëmban kanalizimin në qytetin e Vitisë, fshatërave Drobesh, Ramnishtë, Pozharan, Qifllak dhe Letnicë, ndërsa në lokalitetet tjera rrjetet e ujësijellësve dhe kanalizimeve mirëmbahen nga operatori ekonomik e cili është kontraktuar nga Komuna e Vitisë. Gjatë periudhes Janar-Dhjetor janë përcjellur punët e kompanisë për mirëmbajtjen e ujësijellësve dhe kanalizimeve nga ana e drejtorisë dhe gjatë kësaj periudhe raportuese janë bërë 106 intervenime në rregullime të kanalizimit dhe ujësijellësit, zhbllokime të kanalizimit, ndërrim të gypave, vendosje të pusëve, vendosje të kapakëve nga betoni, vendosja e kapakëve nga metali etj.

1.8 Mbeturinat

Eco-Higjiena si kompani publiko-private, njësi në Viti bënë mbledhjen, transportimin e mbeturinave në deponinë regjionale në Velekincë të Gjilanit dhe atë nga këto vendbanime të Komunës: Qyteti i Vitisë, Drobesh, Smirë, Terpezë, Pozheran, Sllatinë e Eperme, Sllatinë e Ulët, Radivojc, Fshati i Ri, Budrikë, Remnik, Ramjan, Beguncë, Kabash, Gërmovë, Sodinë e Jerlive, Sadovinë e Qerkezeve, Verban, Ramnishtë, Goshicë, Skifteraj, Tërstenik, Podgorc, Stubëll e Epërme, Lubishtë, Binçë, Devajë dhe Qifllak.

Fushëveprimi: Të gjitha pikat në Komunën e Vitisë janë identifikuar sipas raportit të vitit 2022 dhe janë shfrytëzuar si të dhëna përfundimtare për identifikimin e deponive aktuale.

Përkufizime: "Deponi ilegale" - përkufizohet çdo pikë jashtë deponive të përcaktuara në nenin 33 të Ligjit Nr. 04/60 për Mbeturina. Deri më tani, termi "deponi ilegale" nuk është dalluar ligjërisht nga "hedhja e mbeturinave pa vend". Për qëllime të krijimit të një standardi të njëjtë të qasjes gjatë implementimit të metodologjisë, deponia do të përkufizohet si çdo sasi e mbeturinave që e tejkalon vëllimin prej 200 litrave l (d.m.th. e krahasueshme me një karrocë standarde), e cila do të gjendet në një vend të pacaktuar.

Koordinatat gjeografike: Secila deponi e evidentuar është përcaktuar sipas koordinatave gjeografike përkatëse, duke e treguar gjerësinë dhe gjatësinë.

Tabela e koordinatave gjeografike të secilës deponi aktuale

Nr	Madhësia	Vendi ku ndodhet	Gjerësi	Gjatësi	Komuna	Data	Vërejtje
1.	E madhe	Drobesh			Viti	18.03.2022	E kryer
2.	E madhe	Pozheran	42.352099	21.9132	Viti në hartë	02.04.2022	E kryer
3.	E madhe	Beguncë	42.35619	21.354725	Viti në hartë	04.04.2022	E kryer
4.	E mesme	Kabash			Viti	04.04.2022	E kryer
5.	E madhe	Devajë	42.393815	21.395977	Viti në hartë	07.04.2022	E kryer
6.	E mesme	Smirë			Viti	12.04.2022	E kryer
7.	E mesme	Viti-Pozheran			Viti	18.04.2022	E kryer
8.	E madhe	Sllatinë e Ultë	42.297151	21.390048	Viti në hartë	20.04.2022	E kryer

Me datë 31.04.2022 jemi dalë në terren në bashkëpunim me një ekip nga GIZ-i gjerman dhe dy punëtorë nga drejtoria jonë, ku janë evidentuar deponitë e kryera e që figurojnë në hartën e deponive si të kryera, për momentin komuna jonë nuk ka asnjë deponi të evidentuar në hartë.

1.9 Punët me Skipin e Komunës

Për periudhën raportuese Janar - Dhjetor janë bërë gjithsejt 143 intervenime me skipin e Komunës, nëpër lokalitete të ndryshme të Komunës sonë, si: hapja e kanaleve të ndryshme, largimin e borës nga rruga në disa rrugica të qytetit dhe në disa lokalitete rurale, largimin e mbeturinave inerte, varrosjen e kafshëve të ngordhura, mbyllja e rrugëve malore me kërkesë të Drejtorisë së Bujqësisë, rregullimi i hapësirave publike dhe rregullimi i rrugëve nga gërryerjet erozive. Pra, me skipin e komunes janë kryer punë të ndryshme dhe atë në total 484 orë pune janë bërë për periudhën raportuese.

2. Sektori për Emergjencë

NJPZSH-ja në Viti nga data 01.01.2022 deri më datën 28.12.2022 ka pasur gjithsejt 304 dalje të përgjithshme, ku nga këto janë zjarre 200; intervenime teknike 29; shërbime të ndryshme 56; aksidente rrugore 8; dalje në vërshime 9.

Tab. 1: Numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int. tjera janar-dhjetor 2022.

	Nr. i përgj.	Nr. i	Nr. i	Nr. i	Aksidente	Vërshime	Të	Të lënduar			Të vdekur			Gjithsejt
	i daljeve	zjarreve	Teknike	shërbimeve	rrugore		rrugore	zj.	qyt.	tot.	zj.	qyt.	tot.	
Janar	12	9	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12
Feb	11	9	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	0	11
Mars	43	40	0	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	43
Prill	28	22	1	4	1	0	0	3	3	3	0	0	0	28
Maj	18	10	2	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	18

hor	31	13	8	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	31
ik	67	49	3	9	3	3	0	3	3	3	0	0	0	67
it	41	21	1	17	0	2	0	0	0	0	0	0	0	41
tor	8	3	2	0	3	0	0	2	2	2	0	0	0	8
r	17	12	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	17
or	11	4	4	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0	11
tor	17	8	5	3	0	1	0	0	0	0	0	0	0	17
sejth	304	200	29	56	8	9	2	8	8	16	0	0	0	304

Pasqyra e numrit të përgjithshëm vetëm i zjarreve për periudhën janar -dhjetor-2022

Zjarre në objekte ndërtimore						Zjarre në objekte ekonomike				Zjarre në pajisje elektrike				Zjarre në sipërfaqe të hapura				Zjarr. Auto.	Gjith.
Banesa / shtëpi	Objekte ndimse	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Të tjera	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	Të tjera	Pajisje elektrike	Pajisjet shpërndarëse	Gjeneratora	Të tjera	Mal	Bari i that	Sipërfaqe bujqësore	Të tjera	Automjete motorike	
18	2	1	1	7	0	0	2	0	0	6	6	0	0	43	73	0	32	9	200

- Zjarre në objekte ndërtimore 29;
 - Zjarre në objekte ekonomike 02;
 - Zjarre në pajisje elektrike 12;
 - Zjarre në sipërfaqe të hapura 148;
 - Zjarre në automjete 9.
- Gjithsej 200 zjarre**

Zjarret vetëm në sipërfaqe të hapura kanë qenë:

- Zjarre malore 43;
- Zjarre fushore 73;
- Zjarre në mbeturina 32.

Gjithsej 148

Zjarre vetëm në sipërfaqe të hapura:

- Të lënduar qytetar në aksidente- Rrugore -8

Trajnimet e pjestarëve të NJPZSH-së në Viti gjatë viti 2022:

Kemi pasur disa lloj trajnimesh, ku disa janë mbajtur në bazën e zjarrfikësve në Viti, disa në Qendrën e Trajnimit në Vushtrri dhe një trajnim ka qenë me datën 23.06.2022 nga ora 8.30 në Aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" në Prishtinë, ku zjarrfikësit janë trajnuar për reagim në emergjencë për aksidente dhe incidente ajrore të aviacionit civil.

Donacione në vitin 2022, kemi marrë nga KFOR-i Amerikan, si:

- Zorra shtytëse 52 mm / 15 m, SPECIAL 500, me lidhëse 20 copë;
- Çantë shpine Ermak 20 l, për zjarre në terren/mal 34 copë;

- Maskë e plotë, maskë me dy filtra (tipi MBKO5-SE156C) 34;
- Bateri me ndriçim-elektrik dore, për Zjarrfikësit.

Nga Komuna jemi furnizuar me:

- Këpucë verore për 27 Zjarrfikës;
- Shpinore për fikjen e zjarreve fushoro-malore 20 L-7 copë;
- Fryrëse ajri me benzin për fikjen e zjarreve fushoro-malore 4 copë;
- Kove të plastikës nga materiali plastik, për bartjen e ujit në terrene të vështira për fikjen e zjarreve fushoro-malore.

Furnizim me uniforma nga AME-ja, verore dhe dimërore për 7 zjarrfikës të rinj, që janë pranuar përmes Karitasit, të cilët i kemi furnizuar me uniforma nga AME-ja (Agjencioni i Menaxhimit të Emergjencave-Prishtinë).

Bashkëpunimi me Policinë, Shëndetësinë, Kryqin e Kuq, dhe NJPZSH-të e tjera të Gjilanit, Ferizajit, Kamenicës dhe Kaçanikut ka qenë shumë i mire, poashtu kemi pasur edhe takime.

2.2. Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe ka kontratën për shërbimet e mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit dhe furnizim me aparate të reja për nevojat e NJPZSH-së si dhe Administratës Komunale me numër VI657-21-029-236, me vlefshmëri nga data 13.12.2021 e deri me datën 12.12.2022, e që në muajin Dhjetor janë servisuar të gjithë aparatet.

Servisimi i tyre bëhet çdo 6 muaj.

2.3 Inspektori i preventivës ndaj zjarrit kryen

Inspektime të përgjithshme.....	54
Inspektime në sektorin privat.....	51
Inspektime në sektorin shoqëror	3
Nr. i vërejtjeve	158
Nr. i propozim masave.....	158
Shikime në vendngjarje të zjarreve.....	15
Raporte zjarri për Njësitin Hetues në Polici....	9
Kërkesa nga palët.....	7
Vërtetime zjarri për palët e dëmtuara.....	5
Pelqime.....	1

Sfidat e paraqitura

- Ndër sfidat më të mëdha ka qenë numri i vogël i zjarrëfikësve dhe mosha e tyre e shtyer;
- Gjendja e rëndë në ndërtesën ekzistuese të njësisë;
- Ndërtesa e njësisë së zjarrëfikësve ende nuk ka përfunduar dhe zvarritet edhe më tej si projekt i MPB-së.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale


Vitin 2022 QKMF në Viti e ka filluar me ofrim të shërbimeve shëndetësore, si dhe me realizimin e planit vjetor dhe aktivitete tjera duke u fokusuar në:

- Ofrim të shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë, përfshirë qytetarët e Komunës së Kllokotit që kërkojnë shërbime në QKMF;
- Implementimi i mjekësisë familjare, duke zbatuar konceptin e mjekësisë familjare dhe duke u bazuar në normat ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëzimeve Administrative;
- Ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet shëndetësore;

- Furnizim më të mirë me terapi sipas listës esenciale të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- Furnizim me barna, të cilat nuk janë pjesë e listës esenciale;
- Furnizim me aparaturë mjekësore dhe inventar për kushte me të mira të punës;
- Trajnime dhe ligjerata të stafit shëndetësorë, bazuar në planin vjetor të ZHVP-së, si dhe trajnime tjera nga organizata të ndryshme si dhe nga niveli qendror, si të mjekëve ashtu edhe të infermiereve;
- Menaxhim i pandemisë Covid-19 dhe menaxhim i vaksinimit kundër Covid -19.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka kryer shërbime që të jetë sa më afër qytetarëve dhe të jenë në shërbim të kërkesave të tyre, duke u munduar që të rregulloj sadopak mirëqenien e tyre, si në aspektin shëndetësor, ashtu edhe në atë social dhe psikologjik. Komuna e Vitisë ka rreth **46989 banorë rezident**, sipas ASK të vitit 2011. QKMF në Viti ka filluar punën në vitin 1954. Në fillim kanë **qenë 17 punëtorë, 4 mjek, 10 infermier dhe 3 punëtorë teknik**. Sot QKMF në Viti ka të punësuar **132 punëtorë, prej tyre 30 mjek, 85 infermier dhe 17 punëtorë teknik dhe administratë**.

Më poshtë është i paraqitur organogrami i QKMF-së në Viti:



Sipërfaqja e institucioneve shëndetësore në Komunën e Vitisë:


Nr	Emri I Institucionit	Njesia	Siperfaqja	
1	QKMF-Viti	m2	2380	
2	QMF-Pozheran	m2	852	
3	Urgjenca -Viti	m2	381.36	
4	QMF-Sadovine eJerlive	m2	121.5	
5	QMF-Sllatine e Eperme	m2	161.71	
6	QMF-Smire	m2	138	
7	AMF-Skifteraj	m2	124.25	
8	AMF-Letnice	m2	425	
9	AMF-Stubell	m2	311.5	
10	AMF-Zhiti	m2	121.5	
11	AMF-Goshice	m2	161.75	
12	AMF-Begunce	m2	178.65	
	Totali	m2	5357.22	

Institucionet shenëtesore në teren

QMF-të dhe AMF-të të cilat kanë funksionuar gjatë kësaj periudhe në Komunën e Vitisë janë:

1. QMF-Pozheran
2. QMF-Sllatinë e Epërme
3. QMF-Smirë
4. QMF- Sadovinë e Jerlive
5. AMF-Beguncë
6. AMF-Skifteraj
7. AMF-Stubëll
8. AMF-Tërpezë
9. AMF -Letnicë
10. AMF- Remnik
11. AMF Zhiti-jofunksionale

Me poshte eshte i paraqitur organogrami i institucioneve shendetesore ne Komunen e Vitise:



Gjendja në terren:

- Në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Pozheran punohet 24 orë pandërprerë. Në kuadër të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare si dhe shërbime stomatologjike, por edhe kryhen analiza të ndryshme laboratorike gjatë ndërrimit të parë, gjithashtu ka funksionuar hapësira e veçantë për COVID-19;
- Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme ofron shërbime infermierike dhe mjeku 1 ditë në javë;
- Në QMF-në në fshatin Smirë punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike, ndërsa mjeku një ditë në javë;
- Në QMF-në në fshatin Sadovinë të Jerlive punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike, ndërsa mjeku një ditë në javë;
- Në AMF-në e Skifterajt punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë punë nga ana e infermierëve përveç vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë;
- Në AMF-në e fshatit Beguncë ofrohen shërbime infermierike çdo ditë pune përveç vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë;
- Në fshatin Tërpezë shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë pune nga infermierët, ndërsa mjeku dy ditë në javë;

- Në AMF-në në fshatin Stubëll e Epërme punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë;
- Në AMF-në në Letnicë shërbimet shëndetësor nga infermierja ofrohen çdo ditë dhe mjeku ofrohen njëherë në javë;
- Në AMF-në në fshatin Remnik punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, ndërsa mjeku një ditë në javë.

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë sipas këtyre kategorive mjekësore:

1. Shërbimet primare:

- a. Mjekësia Familjare,
- b. Emergjenca,
- c. Stomatologjia,
- d. Imunizimi dhe vaksinimi,
- e. Diagnostika (Laboratori dhe Shërbimi Radiologjik),
- d. Barnatorja.

2. Shërbimet specialistike:

- a. Pediatria,
- b. Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (Internisti),
- c. Gjinekologjia.

Në QKMF në qytetin e Vitisë punohet 24 orë. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrike, interne, radiologjike dhe laboratorike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të parë të orarit të punës. Qendra e emergjencës punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës, ndërsa mjekësia familjare ka punuar në orarin 8:00-22:00 (deri në muajin nëntor, tani punon në orarin 08-15).

1.1. Mjekësia Familjare

- Ka ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë dhe të një numër të konsiderueshëm të Komunës së Killokotit të të gjitha moshave pa dallim. Në këtë periudhë janë ofruar 40655 vizita mjekësore;
- Gjithashtu është kryer kontrolla sistematike e nxënësve të klaseve të I, V dhe të IX të të gjitha shkollave të Komunës së Vitisë. Jane kontrolluar 1418 nxënës, ku janë vlerësuar 29 parametra shëndetësor dhe 13 parametra të shëndetit oral.

1.2. Emergjenca

- Shërbimi i Urgjencës ofron shërbime shëndetësore **24 orë** ditë gjatë tërë javës;
- Në shërbimin e urgjencës kryhen të gjitha shërbimet e ndihmës së parë, kontrolla mjekësore, këshilla, vizita në teren dhe gjatë traumave dhe aksidenteve të ndryshme, kirurgji e vogël, ndërrim kateteri, lidhje dhe pastrim i plagëve, ordinimi dhe trajtimi me terapi parenterale, oksigjenoterapia etj;
- Në këtë shërbim janë të organizuara edhe kujdestaritë gjatë natës, vikendeve dhe festave, në bazë të orarit të planifikuar më parë;
- Autoambulancat janë monitoruar në vazhdimësi nga ekipet kujdestare dhe vozitësit, në drejtim të funksionimit sa më të rregullt të saj. Në dispozicion kemi 6 autoambulanca në funksionalitet të plotë
- Në këtë periudhë janë ofruar 51410 vizita mjekësore në shërbimin e urgjencës.

1.3. Stomatologjia

Shërbimi i stomatologjisë ka ofruar shërbime stomatologjike në orarin 8:00-15:00. Këto shërbime ofrohen në QKMF-Viti dhe QMF- Pozheran,

Shërbimet të cilat ofrohen janë:

- Preventivë,
- Shërim i dhembit,
- Drenim,
- Incizion i dhëmbit të infektuar,
- Mbushje e dhembit,
- Shërbimet e pedodoncise,
- Nxjerrje e dhembit, etj.

Gjatë këtij viti janë ofruar 4499 shërbime stomatologjike.

1.4. Shërbimi i Vaksinimit

- Shërbimi i vaksinimit në mënyrë të vazhdueshme ka punuar në ngritjen e cilësisë profesionale të stafit shëndetësor. Po ashtu edhe në edukimin e qytetareve në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e promovimit dhe parandalimit të sëmundshmërisë së fëmijëve dhe rëndësinë e vaksinimit në fëmijëri;
- Ka bërë planin vjetor dhe ka realizuar planin në perpikmeri në vaksinimin e fëmijëve parashkollor dhe shkollor në tërë teritorin e Komunës së Vitise dhe Komunës së Kllokotit;
- Gjithashtu shërbimi i vaksinimit, me ardhjen e vaksinave në Kosovë kundër Covid -19, me ndihmen e stafit shëndetësor të dërguar nga Ministria e Shëndetësisë ka bërë vaksinimin e qytetarëve me vaksinën anticovid. Gjithashtu është bërë vaksinimi i popullatës edhe me vaksinën e gripit sezonal;
- Gjatë këtij viti janë planifikuar të vaksinohen 2617 fëmijë, ndërsa janë vaksinuar 2532 fëmijë, në përqindje 96.75%, kurse me vaksinën anticovid janë vaksinuar 2595 qytetarë, ndërsa me vaksinën e gripit sezonal janë vaksinuar 2128 qytetarë;
- Gjithsej në shërbimin e vaksinimit janë ofruar 11054 shërbime.

1.5. Laboratori dhe shërbimi radiologjik

- Shërbimi i laboratorit ofron shërbime në orarin 8:00-15:00. Këto shërbime ofrohen në QKMF-Viti dhe QMF- Pozheran;
- Është bërë furnizimi me material të nevojshëm për funksionimin normal të laboratorit;
- Janë ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë pacientët të cilët kanë kërkuar shërbime laboratorike në institucionin tone;
- Gjatë vitit 2022 janë bërë 172789 analiza;
- Janë bërë 2158 teste rapide në këtë periudhë;
- Rentgeni punon në orarin e rregullt 8:00-13:00, gjithashtu edhe ditën e shtunë. Disa muaj shërbimi radiologjik nuk ka punuar për shkak të defektit;
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë 1098 incizime radiologjike.

1.6. Barnatorja

- Është bërë planifikimi me kohë për furnizim me barna dhe material hargjues për vitin 2022;
- Janë kryer në mënyrë të rregullt porositë mujore për furnizim me barna dhe material hargjues nga Ministria për Shëndetësi, kryesisht përmes sistemit SMFK;
- Është bërë distribuimi i barnave dhe materialit hargjues në QKMF dhe QMF-Pozheran si dhe te gjitha AMF-të;
- Është bërë furnizimi i pacientëve me barna esenciale dhe insulin;

- Gjatë kësaj periudhe kemi blerë me mjete vetanake, përmes kontratës me operatorin ekonomik në kuadër të shërbimeve dhe mallrave terapi dhe material hargjues në raste specifike në vlerë prej 99637.00 euro;
- Është bërë asgjësimi i të gjitha barnave me afat të skaduar, sipas kontratës.

2. Shërbimet specialistike

2.1. Pediatria

Shërbimi i pediatriisë ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00 çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore ofrohen edhe këshillat mjekësore. Gjatë këtij viti janë ofruar 3814 vizita mjekësore dhe 443 këshilla mjekësore. Gjithashtu është bërë edhe renovimi i hapësirës së brendshme, si dhe ngjyrosja e mureve në mënyrë vullnetare nga KFOR-i dhe “Vullnetarët e Anamoravës”.

2.2. Mjekësia interne

Shërbimi i mjekësisë interne ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore kryesisht për të sëmurët kronik. Sëmundjet më të shpeshta kronike të evidentuara në shërbimin e mjekësisë interne janë sëmundjet kardiovaskulare, reumatologjike dhe diabetit. Gjatë këtij viti janë ofruar 795 vizita mjekësore, si dhe janë realizuar 448 EKG. Gjithashtu shërbimi internistikes është furnizuar me EKG-e të re.

2.3. Gjinekologjia

Shërbimi i gjinekologjisë ofrohet në QKMF-Viti në orarin 8:00-15:00, çdo ditë pune. Përpos vizitave shëndetësore, ofrohen edhe këshillat mjekësore për gratë shtatzëna. Gjatë këtij viti janë ofruar 1814 vizita mjekësore dhe 772 ultrazë, 212 kontrolla gjinekologjike dhe 579 këshilla. Në tërësi janë ofruar 3718 shërbime shëndetësore.

Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë

- Kujdesi për nëna dhe fëmijë ka vazhduar me vizita në shtëpi, ku gjatë këtij viti janë kryer 1268 vizita;
- Përpos këshillave mjekësore, në raste të veçanta përmes donatorëve familjet janë ndihmuar edhe me pako ushqimore dhe higjienike;
- Përpos infermiereve për vizita shtëpiake, kemi angazhuar edhe logopede për të ofruar ndihmë për fëmijët që kemi hasur në probleme në të folur gjatë këtyre vizitave.

Sistemi Informativ Shëndetësor

- Janë raportuar me kohë të gjitha raportet në të gjitha institucionet përgjegjëse, si: IRSHP-Gjilan, IKPSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Është përcjellur gjendja e sëmundshmërisë përmes formularëve të caktuar dhe është raportuar me kohë në institucionet përgjegjëse;
- Gjithashtu është përcjellur dhe raportuar në mënyrë ditore edhe procesi i testimeve me RAT si në IRSHP-Gjilan, poashtu dhe IKPSH.

Tabela e raportit të SISH për periudhën janar -dhjetor 2022

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE "NENE TEREZE" VITI
RAPORT VJETOR

JANAR - DHJETOR 2022

Reportet	Vizita	Vizita shtëpiake	Vizita Covid	Theritje	Infuzione	Transferime	Transtr Dog	Lidhje	Infalme	Kenita	Ekg	Nr Analizav	Nr orin i ushete	Testimet Covid	Utramarat	Kontrolat gjinekologjike	Dhuna famijale	Nr Akutitet	Paga	L. Pag
Emergjence	81410	1309	6	17031	20011	4884		1437			1201					4			10089.5	41237
Mjeksis Familjare 1	26236			8747		3366													10489	24389
Mjeksis Familjare 2	9226					1637													2097	8884
Mjeksis Familjare 3	6193					851													1311	3886
Stomatologjia	2819																	699	366	2668
RTG	1093													Kerrik-Nentor					1362	713
Testimet Covid														2158						2168
Dhoma e Inf Covid			3371	323	1071															3428
Dhoma e Infuzioneve					2266														664	1602
Laboratori	12139										122874								8161	9331
Pediatri	3614				38	66			443											3814
Interne	796										448								437.5	1059
Ekipa e terent Caritas		1197		400	369			166					367							1197
Ekipa e terent QKMF		1413		276	863			48					191			Kerrik-Nentor				1413
Matematik	1814			264		87				679					772	212			1238	2088
Vizita per nene dhe femijen		1268																		1268
Shërbimi i Vakcinimit	3603			7461																3603
Vakcinimi Covid	4998			8609					396											4998
Inhalime ne QKMF Viti								2663											332	2639
Lidhja																				396
TOTALI	123141	6187	3377	80091	24670	10886	66	4303	396	1022	1649	122874	648	2168	772	212	4	699	36606	118342
NUMRI I VIZITAVE NE AMBULLANTAT E QENDRES KRYESORE TE MJEKESISE PRIMARE																				
Amb. Smirë	26			148				60	7	496									18	737
Amb. Baderin	7			24				24	6	36									11	91
Amb. Slatin	57			320	374			322	10	68									61	1090
QKMF Peshëran Covid			364	125	114															420
QKMF Peshëran	41677			15800	10266	5188		3803	213	291	379								14338	27050
Laboratori Peshëran	5455											49915							1998	4754
Stomatologjia peshëran	699																	282	86	656
Amb. Tërpez	51			170	104			175	31	234									37	740
Amb. Gjylekar	44			116	23			29	1	230									35	411
Amb. Begunë	23			51	29			163	15	152									15	434
Amb. Remink	2			36	34			36		7									3	80
Amb. Lotin	169	10		40				1		8									2	201
Amb. Stubei	755	230		349				83	7	140									11	1123
TOTALI	48986	240	384	16967	10924	6188		3193	289	1662	379	49916	0					282	16613	37780
GJITHSEJ SHËRBIMET																				
	123141	6187	3377	80091	24670	10886	66	4303	396	1022	1649	122874	648	2168	772	212	4	699	36606	118342
QJTHSEJ TOTALI	172126	6427	3761	77058	35494	16043	66	7496	686	2684	2028	2E+05	648	2168	772	212		981	63119	2E+05
GJITHSEJ SHËRBIMET 484219																				

Kordinatori i S.I.S.H
Zakaria Mustafa

Drejtori QKMF
Dr. Vjollca Kadeti Halili

Kujdesi palativ

- Shërbimi i kujdesit palativ ka kryer me profesionalizëm shërbimet shëndetësore ndaj pacientëve me sëmundje kronike dhe atyre të palëvizshëm, jo vetëm në Komunën e Vitisë, por edhe në Komunën e Klllokotit. Në QKMF Viti funksionojnë dy ekiye në teren, në orarin 8:00-15:00, ndërsa prej orës 15:00 vizitat në teren i kryen shërbimi i urgjencës, gcvjithashtu, është edhe mjeku në permanencë, i cili aktivizohet në punë varësisht nga rastet ditore, kur ka nevojë për shërbim të mjekut.
- Varësisht nga kërkesat janë kryer edhe vizitat në shtëpi për të sëmurët me Covid-19,
- Gjatë këtij viti janë ofruar 6578 shërbime shtëpiake.

Situata me Covid-19 në Komunën e Vitisë

- QKMF në Viti në vazhdimësi ka qenë e fokusuar në menaxhimin e situatës me COVID-19. Ka ndarë hapësirën për trajtimin e pacientëve me COVID dhe autoambulancën, e cila ka shërbyer për transportin e pacientëve me COVID-19;
- Është bërë raportimi ditor i rasteve të testuara për COVID-19 në IRSHP dhe në IKSHP. Është marrë anketa e secilit qytetarë të infektuar dhe është bërë përcjellja e gjendjes shëndetësore për secilin pacient dhe janë organizuar vizita dhe këshilla varesisht nga nevoja;
- Në tabelë mund të shohim numrin e personave të prekur nga Covid-19 që nga 13.03.2020- 31.12.2022.

Rastet e testuara për COVID-19 në Komunën e Vitisë prej 13.03.2020	
Komuna e Vitisë	Nr.
Testime në Komunën e Vitisë	19561
Raste Pozitive	4988
Raste negative	14573
Raste pozitive vetëm gjatë vitit 2022	2159
Të vdekur	106

Edukimi i vazhdueshëm profesional

Ka vazhduar edukimi i vazhdueshëm profesional nga ana e mjekëve dhe infermierëve sipas planifikimit të temave profesionale që janë dërguar më parë për akreditim në Odën e Mjekëve dhe Infermierëve (OMK dhe OIK).

- **Nga mjekët janë mbajtur 20 ligjërata;**
- **Nga Infermierët janë mbajtur 12 ligjërata me 2 grupe nga 30 infermier, në total 780 infermier të trajnuar;**

Promovimi dhe edukimi shëndetësor në komunitet -Janë realizuar këto aktivitete:

- **Më 04 shkurt është shënuar Dita Botërore në Luftën Kundër Kancerit;**
- **Më 22 Shkurt në QKMF-Viti shënohet “Dita Botërore e CA” e ligjëruar nga Dr.Beqir Ramadani. Në këtë ligjeratë kanë marrë pjesë 20 mjekë të QKMF-së dhe 30 infermier;**
- **Më 24 Mars është shënuar dita botërore e Tuberkulozit, ku DSHMS në bashkpunim me QKMF-në në qytetin e Vitisë ka zhvilluar disa aktivitete të vedijësimit të qytetarve rreth kësaj sëmundje. Fillimisht në qytetin e Vitisë një ekip e QKMF-së ka shperndarë disa fletushka rreth menyres se parandalimit por edhe te mjekimit dhe shërmimit të sëmundjes së tuberkulozit;**
- **Më 21 Mars në QKMF -Viti është mbajtur ligjerata me temen “Dita Botërore e Shendetit Oral”;**
- **Më 7 Prill Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Viti ka shënuar, Ditën Botërore të Shëndetit, ky aktivitet është shënuar nga ekipa shëndetësore e QKMF-së, ku fillimisht kanë vizituar shtëpinë e të pensionerëve në Viti, ku kane diskutuar së bashku për shëndetin në tërësi, si dhe iu është mat glikemia dhe tensioni arterial. Pastaj, ka vazhduar aktiviteti në qytet me shpërndarjen e broshurave të ndryshme rreth sëmundjeve kronike;**
- **Më 29 Prill shënohet dita e imunizimit, ku në këtë ditë u zhvillua aktiviteti në kuadër të Javës Botërore të Imunizimit, ku epidemiologu Dr.Ismail Bektashi bashkë me ekipën e vaksinimit në QKMF-Viti informuan qytetarët e rastit për rolin dhe rëndësinë e vaksinimit të fëmijët nga mosha 0 deri në 18 vjet. Gjithashtu tek qytetarët e rastit janë shpërndarë edhe fletushka rreth rëndësisë së vaksinimit;**
- **Më 11 Maj Shënohet Dita Ndërkombëtare e Infermierit në Viti. Qendra e Mjekësisë Familjare në Viti në bashkëpunim me kolegjin “Universum”, me një aktivitet kanë shënuar Ditën Ndërkombëtare të Infermierit. Në këtë aktivitet nga infermierët e QKMF-së në Viti dhe studentët e rinj të këtij kolegji, është bërë matja e tensionit, sheqerit në gjak, si dhe nivelit të saturimit, për qytetarët të cilët kanë shprehur interesim që të jenë pjesë e këtij aktiviteti;**
- **Më 19 Maj shënohet Dita Botërore e Mjekut Familjar. Me këtë rast një ekip i QKMF-së së Vitisë, ka zhvilluar sot një aktivitet në sheshin e qytetit në Viti, ku qytetarët kanë mundur nga afër të marrin këshilla mjekësore. Gjithashtu ky ekip ka shpërndarë edhe fletushka rreth kujdesit të shëndetit, ofrimit të shërbimeve shëndetësor nga mjeku familjar dhe të tjerë.**

- **Me 31.05.2022 është shënuar Dita Botërore kundër Duhanit**, në Komunën e Vitisë janë zhvilluar disa aktivitete për promovimin, ndërgjegjësimin, ngritjen e njohurive dhe motivimin e të rinjve, kundër konsumimit të duhanit. Këto aktivitete, janë realizuar nga ekipet mjekësore të QKMF-së në Viti, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, menaxhmentin e shkollave dhe institucionet komunale. Për nderë të kësaj dite, fillimisht u mbajt ligjëratë në SHFMU “Bafti Haxhiu“, me nxënësit e klasave të IX-ta, duke vazhduar me SHFMU “28 Nëntori”, në Vërban dhe Sadovinë të Jerlive;
- **Më 02 Shtator është shënuar dita Dhurimit të Gjakut me moton “Dhuro Gjak shpëto jetë “** në bashkëpunim mes DSHMS dhe qendres së Transfuzionit në Prishtinë është organizuar aksioni për dhënien vullnetare të gjakut në qytetin e Vitisë;
- **Më 29 Shtator është Shënuar i Ditës Botërore të Zembrës.** Fillimisht është mbajtur një takim në QKMF me qytetarë ku janë dhënë këshilla për sëmundjet e zembrës, ushqyeshmërinë dhe aktivitetin fizik. Pastaj, në qendër të qytetit të Vitisë, një ekip i QKMF-së ka bërë matjen e tensionit dhe sheqerit e 26 qytetarëve. Gjaktë kësaj dite janë shpërndarë qytetarëve fletushka që përmbajnë këshilla për shëndetin dhe aktivitetin fizik, konkretisht se si të parandalojmë shtypjen e lartë të gjakut;
- **Me moton “EKZAMINOHU ME KOHË, VRAPO PËR JETËN” filluan aktivitetet për muajin e luftës kundër kancerit të gjirit;**
- Me datën 05 Tetor deri më 14 tetorë janë mbajtur ligjëratat në Tërpezë, (në AMF), Sllatinë e Epërme (në QMF), Smirë (në QMF), Beguncë, (në AMF), Remnik (në AMF), Sadovinë e Jerlive (në shkollë), Skifteraj (shkollë), shkollën “Kongresi i Manastirit” në Pozheran me nxënësit e klasëve të XI dhe XII dhe arsimtarët e kësaj shkollë, si dhe Goshicë (shkollë) (e cila është realizuar pas kërkesës së qytetarëve të fshatit Goshicë). Vlen të theksohet se ligjëruese në të gjitha ligjëratat ishte dr. Gentianë Ferati, mjeke e përgjithshme në QKMF-Viti. Gjatë çdo ligjëratë janë shpërndarë edhe fletëpalosje me informata rreth sëmundjes dhe parandalimit të saj;
- Gjatë ligjëratave me prezencën e tyre na kanë ndihmuar edhe gratë e prekura nga kanceri i gjirit, të cilat kanë prezantuar para pjesmarreseve përvojën e tyre me sëmundjen si dhe sfidat nëpër të cilat kanë kaluar.
- **Më 10 Tetorë shënohet Dita Botërore e Shëndetit Mendor.** Ky aktivitet është realizuar përmes ligjëratës “Burnout Syndroma”, e mbajtur nga dr. Gentiana Ferati për punëtorët shëndetësorë të QKMF-së në Viti. Në këtë ligjëratë kanë marrë pjesë 16 mjekë dhe 36 infermier;
- **Më 25 Tetor kemi organizuar Marshin sensibilizues me moton “Ekzaminohu me kohë, Vrapo për jetën”,** i cili marsh është mbajtur në qendër të qytetit. Përpos qytetarëve të shumta, në këtë marsh kanë marrë pjesë Kryetari i Komunës z. Sokol Haliti, drejtoreshën e DSHMS-së, Merrushe Ahmeti, Drejtoresha e QKMF-së, Vjollca Kadolli, edhe gratë e prekura me kancer si dhe Grupi i Grave të Vitisë, administratës komunale, punëtorët e shëndetësisë, arsimi, gratë asambleiste, forumet e grave të partive politike, policinë e Kosovës, OJQ etj;
- **Më 14 Nëntor shënohet dita Botërore e Diabetit.** Me këtë rast një ekip i QKMF-së, në qendër të qytetit të Vitisë, ka shpërndarë fletushka informative mbi këtë sëmundje si dhe kanë bërë matjen e sheqerit në gjak si dhe matjen e tensionit arterial për 33 qytetarë të rastit;
- **Me datën 1 Dhjetor është shënuar Dita Botërore e HIV/AIDS,** ku janë mbajtur ligjëratat me nxënësit e shkollave të mesme “Kuvendi i Lezhës” në Viti, Shkolla teknike “Jonuz Zejnullahu” në Viti dhe Shkolla e mesme mikse “Kongresi i Manastirit” në Pozheran. Ligjëruese ka qenë Dr. Gentiana Ferati. Jane shpërndarë edhe fletushka;
- Gjithashtu është bërë përcjellja e të gjitha aktiviteteve sportive në Komunën e Vitisë;

Donacionet

- Donacion për objektin e ri të AMF në Goshicë nga donatori “Kuëait Society for Relief”, në vlerë prej 94700 euro;
- Donacionet nga Unicef për qendrën e vaksinimit, material higjienik;
- Donacion nga Caritas Kosova, 20000 maska për fytyrë;
- Donacion nga Rotary Club Vitia, maska, dorëza, termometra, pulsoksimetra, dezinfektues dhe çarçafë;
- Donacion nga Unicef 2 frigorifer për vaksinim dhe 50 karrika për Qendrën e Vaksinimit në Viti;
- Donacion nga Ministria për Shëndetësi, pajisje mjekësore si EKG, otoskopa, termometer digjital, termometra të veshit, qekan neurologjik, pulsoksimetra, glikometra, peshore për të rritur dhe fëmijë, teste për analiza urinare, lampa egzaminimi, inhalator dhe manzhetë me stetoskop për matjen e tensionit arterial;
- Donacion nga UNICEF për qendrën e vaksinimit, pajisje teknike si laptop, printer, invertor, gjenerator, frigorifera etj;
- Donacion nga UNICEF për QKMF pajisje bazike mjekësore kryesisht për urgjencën mjekësore. Jemi furnizuar me dy sete (çanta) emergjente, ku keto qanta në përberje kanë termometra digjital, termometra të veshit, pikfloë metër, pulsoksimetra, glikometra, ambubalon, çekan neurologjik, manzhetë me stetoskop për matje të tensionit arterial, dorëza, alkool dhe shiringa;
- Donacion nga Ministria për Shëndetësi me pajisje mjekësore përfshihen EKG, Defibrilator, aspirator, sete për kirurgji të vogël si dhe pajisje tjera për shërbimin e urgjencës, oftalmoskopa, bartese për paciente, çanta për mjek, sete të ndihmes së parë;
- Donacion nga AQH, televizor për QKMF;
- Donacion nga AMC, inventar komplet për dhomen “Klasa për nena dhe fëmijë” që përfshijnë laptop, karrige, tavolina, pulsoksimeter, glikometer, tensiometer etj.

Investimet

- Është bërë renovimi i QKMF në Viti, ku është bërë ndërrimi komplet i kulmit, është bërë ngjyrosja e të gjithë objektit të QKMF- dhe urgjencës në Viti, ndërrimi i kanalizimit të vjetruar, intervenime në sistemin e ngrohjes qendrore, funksionalizimi i nyjeve sanitare etj;
- Ka filluar ndërtimi i AMF-së në Goshicë, përmes përkrahjes e donatorit;
- Përmes investimeve komunale objekti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Viti, shërbimi i urgjencës si dhe oborri i saj janë futur nën monitorimin e kamerave vëzhguese;
- Përmes investime kapitale është furnizuar me aparaturë biokimike si dhe aparat hematologjik QMF-në e Pozheranit. Gjithashtu, është blerë edhe një aparaturë EKG, e cila do të jetë në shërbim të repartit të internistikës;
- Është bërë furnizimi me inventar të ri në QKMF, QMF dhe AMF-të;
- Po vazhdon investimi edhe në objektet tjera shëndetësore, pasi që projekti është dyvjeçar.

Shërbimet shëndetësore të ofruara gjatë periudhës Janar-Qershor 2022, shih tabelat në vijim

Tab.2.1. Tabela Kryesore e të gjitha shërbimeve për periudhën janar-qershor 2022

Nr	Shërbimet	Totali	Nr.referimeve dhe %
1	Vizita në mjekësinë familjare	19961	
2	Vizitat në Emergjencë	51410	
3	Vizitat shtëpiake – Shërbimi Emergjent	1309	
4	Vizita Stomatologjike		
5	Shërbime laboratorike	172789	
6	Shërbime të Kujdesi Paliativ	6578	
7	Vizitat ne QMF Pozheran dhe AMF	41677-Pozherani 3821 AMF tjera	
8	Vaksinimi i femijeve	2532	
9	Vaksinimi anticovid	2595	
10	Vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë	1268	
11	Participimi i përgjithshëm	60051.3	
12	Totali i Vizitave	172126	
13	Shërbimet tjera shëndetësore	149299	
14	Totali i ofrimit të shërbimeve nga QKMF për qytetaret e Komunes se Vitisë	484219	

Në QPS -Viti punët kanë rrjedhë në përputhshmëri me planifikimin dhe masat e ndërmarra. Janë përmbushur të gjitha detyrat shtesë, në ofrimin të shërbimeve për kategoritë e rrezikuara, që përfshihen në domenin e punës sociale, siç janë shpërndarja e 200 pakove ushqimore të dhuruara nga organiyata humanitare “Jetimet e Bakllkanit”. Numri i punëtorëve të angazhuar në QPS gjatë kësaj kohe është tre punëtorë me kontratë të përkohshme. Nga trembëdhjetë punëtorët e angazhuar një, 1 ka shkuar në pension, njëres punëtorë me kontratë i ka skanduar afati kontratës. Për momentin janë të angazhuar gjithsej 12 punëtorë aktiv. Drejtori i QPS-së, katër punëtorë të shërbimit social dhe një, udhëheqs i shërbimit, tre punëtorë të shërbimit të asistencës dhe një udhëheqësi i shërbimit, një punëtor i administratës dhe financave dhe dy punëtorë me kontratë ende punojnë. Njëres nga tri punëtorët e angazhuar nga ministria, nga prilli 2021 deri në prill 2022 i ka skaduar kontrata. Gjatë këtij viti kishte konkurs të brendshëm dhe të hapur, për plotësimin e vendit të punës, udhëheqës i shërbimit social në sistemim i mbrendshëm. Po ashtu është plotësu edhe vendi i punës mbetur vaçant, në shërbim me rastin e kalimit në vendin e punës udhëheqës i shërbimit Social të njërit nga punëtorët e shërbimit. Duhet njoftuar se vitin në vijim njëri nga punëtorët e QPS-së del në pension, konkretisht Milaim Tahiri, zyrtar i administratës financiare.

SHËRBIMI SOCIAL

Kategoritë e shërbimeve simbas rasteve	Raste te reja	Përseritës	Të bartura nga vitet tjera	Gjithësejt	Vendosja në institucione - Vërejtje
Raporte te qrrregulluara bashkshortore-Besim i fëmijve	6	0	8	14	
Te mitur ne konflikt me Ligjin	22	7	48	101	
Dhuna ne familje	41	0	15	56	
Te mitur me sjellje asociale	5	3	8	16	
Fëmijët e keqetrajtuar fizikisht	0	1	5	6	
Kujdestari e fëmijeve	3	1	21	25	
Fëmijët ne strehim.familjar tek të afermit	0	0	9	9	
Fëmijët e vendosur ne famil.strehues	0	0	2	2	
Adoptimi i fëmijeve	2	0	3	5	
Kontaktimet prind-fëmij	4	0	15	19	
Keqtrajtimet-ngacmimet sex.te fëmijëve	4	0	2	6	
Te moshuar pa perkujdesje familjare	4	0	4	8	3-SHPMPF
Fëmijët me nevoja te veqanta	7	0	49	56	Në Shtime 2, Në Ferizaj 2 dhe ne Kamenicë 1

Te rritur me nevoja te veqanta	1	0	5	6	100 euro mujore 2 muaj plus 60 euro
Ftesa gjyqesore per te mitur	18	0	0	18	
Ftesa gjyqesore per territor	21	0	0	21	
Lypes te rruges	1	0	0	1	
Masat e shqiptuara per te mitur;M.SH.P	3	0	0	3	
M.O.K	2	0	0	2	Organi Kujdestaris
Qortim	8	0	0	8	
Burg	2	0	0	2	
Vertetime per nenshtetësi	49	0	0	10	
Vertetime të zotsis së veprimit - për armë	201	0	0	201	
Vërtetime të zotësis së veprimit - për punë	24			24	
Fëmijët në punë të rënda	0	0	0	0	
Ankesa koms.mj.shk.II	1	0	0	0-1	
Fëmijet e vendosur ne institucionet mbrojtese	0	0	1	1	
Vendosja stre-dhun familje	1	0	0	1	
Regjistr.i mevonshem i fëmijve	0	0	0	0	
Perdorues te narkotikeve	0	0	1	1	
Martesa e parakoheshme	2	0	0	4	
Urdher mbrojtje per viktimat e dhunes ne familje	3	2	2	7	
Sherim i detyrushem psikiatrik	1	0	0	1	
Kërcnim	3	0	0	3	
Trafikim	0	0	0	0	
Fëmijët e braktisur të posalindur	0	0	0	0	
Raste tjera në nevojë për sherbime	2	0-2	0	2	
Aktvendime të kujdestaris	1	0	0	1	
Referime nga gjykat	18	0	0	18	
Referime nga Prokuroria	4	0	0	4	
Njoftime nga Spitali i gji8nkologjis	1	0	0	1	
Gjithësejt raste te trajtura dhe sherbimet e ofruara	466	8	189	655	8 perseritsa hyn në të njejtin numër

SHËRBIMI ASISTENCËS

Pasqyra e pagesave nga shërbimi i asistencës gjatë këtij nëntëmujori

Nr.	Muaji	Numri familjeve anëtar	-	Pagesa mujore
1.	Janar	463	2,002	59,830.00 €
2.	Shkurt	461	1,995	59,870.00 €
3.	Mars	457	1,958	59,110.00 €
4.	Prill	448	1,921	116,040.00 €
5.	Maj	447	1,927	57,990.00 €
6.	Qershor	440	1,898	57,230.00 €
7.	Korrik	425	1,817	55,250.00 €
8.	Gusht	432	1,871	57,140.00 €
9.	Shtator	424	1,838	109,800.00 €
10.	Tetor	412	1,775	53,335.00 €
11.	Nëntor	398	1,711	52,605.00 €
12.	Dhjetor	397	1,713	52,200.00 €
Gjithsejt	12 muaj	429,5 1,698.8	mesatarja	790,400.00 € në total

Gjitha rastet e shqyrtuara për Asistencë Sociale

Rastet e shqyrtuara	Gjithësejt	Aprov	Refuzuara
Aplikim për herën e parë	33	27	6
Riaplikim	595	495	100
Gjithësejt	628	522	106

Lëndët e shqyrtuar nga komisioni mjekësor

Të shqyrtuar	Të aprovuara	Të refuzuara – në shqyrtim
312	236	66 10

Lëndët e shqyrtuara simbas ankesës

Te trajtura	Aprovuara	Refuzuara	Gjithësejt
Të trajtuaraë	2 dy në gjykat 1një, në shqyrtim një 1	26	30

Kërkesa për suvencione nga DPSF-DSAS

Gjithësejt	Të aprovuara	Të refuzuara
3	2	1

Vërtetime të lëshuar brenda 5 muajve

Me pagesë	Papagesë	Gjithësejt
193	00	193

Të atakuar nga ATK 20 familje

Vertetima për student

Gjithësejt	0
------------	---

Propozim pelqimi për autorizim për tërheqjen e mjeteve

Gjithsejt	1
-----------	---

RAPORTI FINANCIAR

Të hyrat vetanake financiare nga taksat komunale në QPS:

Të inkasuara	Të dorzuara	Gjithësejt
4,070.00 €	4.070.00 €	4,070.00 €

Sa i përket shpenzimeve në shërbime të mallra, mirëmbajtje, rrymë, komunali nuk kemi evidencë, raporti gjendet në Drejtori pasi që jemi në të njëjtin objekt.

Drejtorja për Arsim

Në Komunën e Vitisë procesi mësimor zhvillohet që nga edukimi i hershëm, çerdhet, parashkollorët, mësimi fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë. Gjatë kësaj periudhe zhvillimi i procesit mësimor ka qenë i rregullt po edhe me sfida, si: në fillim kemi pasur sfidat me mësimin online. Sipas rekomandimeve të institutit dhe në koordinim me taskforcat e shkollave dhe të DKA-së, kemi arritur të bëjmë një organizim. Po ashtu edhe testime në masë nga QKMF-ja për nxënësit, duke u kujdesur për shëndetin e tyre dhe të mësimdhënësve. Gjatë periudhës së tretë mësimi është zhvilluar pa asnjë pengesë, përpos mësimin dhe aktivitetet shkollorë dhe jashtëshkollorë janë organizuar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Testi i arritshmërisë dhe ai maturës janë organizuar në mënyrën më të mirë e me rezultatet të mira mbi 80% kalueshmëria.

Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/23 janë bërë me kohë, duke i përgatitur shkollat si në aspekt teknik dhe logjistik, sipas kërkesave të shkollave dhe prioriteteve të DKA-së.

Janë zhvilluar një sërë aktivitetshe edukative në Institucionet shkollorë:

- Ngritja e kapaciteteve në mësimdhënie dhe mësimnxënie si dhe krijimin e kushteve më të mira në gjithë përfshirjen dhe në ngritje të cilësisë;

- Rritja e kapaciteteve për gjithë përfshirje, angazhimi i psikologëve, mësuesve mbështetës, asistenteve, logopedëve dhe vlersimi pedagogjik i fëmijeve me nevoja të veçanta konsiderohet si një nga rezultatet për 2022;
- Përfundimi me sukses i procesit mësimor me rezultate të kënaqshme në testin e arritshmerisë dhe testit të matures me kalushmeri mbi 80 %, si dhe organizimi i testit Pisa, times e garave sportive dhe aktivitete të ndryshme gjatë vitit;
- Renovimit të objekteve shkollore dhe çerdheve dhe përgaditja për fillimin e viti të ri shkollor 2022/23;
- Renovimit të SHFMU "Bafti Haxhiu", "Nder Mjeda" dhe "Hysen Terpeza" në projektin e Eficiencies;
- Fillimi i renovimit të qendrës së ndërmarrsisë tek objekti i vjetër i IAAP "Januz Zejnullahu";
- Inventarizim i shkollave me: banka, karrige, perde, tepi, tabela dhe dollap sipas kërkesave të shkollave;
- Ndarja e bursave për student;
- Vendosja e rrethojave në oborret shkollore;
- Rregullimi i fushave sportive dhe furnizimi i shkollave me mjete konkretizimi për zhvillim të aktiviteteve sportive;
- Rregullimi i parqeve dhe ambienteve në oborret e shkollave;
- Inventarizim dhe rregullim i bibliotekave dhe kabineteve të informatikës;
- Furnizimi i shkollave me projektor;
- Furnizimi i shkollave me lëndë për ngrohje;
- Është bërë dezinfektimi i objekteve shkollore dhe çerdheve;
- Furnizim i shkollave me mjete pune dhe didaktike sipas kërkesave;
- Zhvillimi i shumë aktiviteteve jashtëshkollore;
- Shënimi i datave sipas kalendarit shkollor;
- Aktivitete në promovim të barazisë gjinore, të drejtave të njeriut, etj;
- Ligjërata me karakter edukues dhe preventive;
- Bashkëpunimi me donatorët ka qenë prioritet i yni, duke qenë bashkëpunues në projekte.

2 Realizimi i Aktiviteteve të detajuar për Janar – Dhjetor

Janë organizuar aktivitetet të ndryshme sipas planit të punës së DKA-së dhe shkollave

Përgatitjet për fillimin e periudhës së dytë	Janar	DKA/IA
Shënimi me aktivitet të 17 shkurtit Ditës së Pavarësisë së Kosovës	Shkurt	DKA/IA
Shënimi i 7 Marsit Ditës së Mësuesit	Mars	DKA/IA
Shpallja e Javës "Edukimi për Barazi Gjinore"	Mars	DKA/IA

Raportim për Mungesa të Nxënësve dhe mësimdhënësve	Çdo muaj	DKA/IA
Aktivitet dhe gara në fusha të ndryshme	Mars/Prill	IA
Shënimi i Ditës Ndërkombëtare DON SINDROM	Mars	DKA/IA
Pjesëmarrje në aktivitet e “Flakadanit të Karadakut”	21-26 Mars	DKA/IA
Shënimi i Ditëve të Shkollave	Sipas ditës	DKA/IA
Aktivitetet për Ditët e Ambientit	Prill	DKA/IA
Përfundimi i periudhës së dytë dhe përgatitjet për periudhën e tretë	Prill	DKA/IA/MASHT
Aktivitete për Ditën Ndërkombëtare të Librit	23 Prill	DKA/IA/DKRS
Ligjërata nëpër shkolla, tematika edukative dhe shënimi i datave me rendësi	Çdo muaj	DKA/Psikolog/Policia/QKMF/QPS
Organizimi I testit Pisa	Prill/Maj	DKA/IA/MASHT
Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të fëmijëve	I Qershori	DKA/DKRS/IA
Organizimi i Testit te Arritshmërisë	Qershor	DKA/IA/MASHT
Organizimi i Aktiviteteve për ditën e Çlirimit	14 qershori	Komuna/DKA/IA
Organizimi I testit te maturës	Qershor	DKA/IA/MASHT
Aktivitete të tjera sipas kalendarit të MASHT, Institucioneve Lokale dhe akteve të tjerë që janë në interes për sistemin edukativo arsimor	Çdo muaj	DKA/IA/MASHT
Oranizimi i tetstit të matur dhe testit të arritshmërisë	Qershor/gusht	DKA/IA/MASHT
Regjistrimi i nxënësve në klasa të para, shkolla të mesme	Qershor/gusht	DKA/IA/MASHT

- Vizitë në shkolla dhe monitorimi i rregullt për vijueshmërinë e personelit arsimor dhe nxënësve;
- Testi Pisa është mbajtur më 17, 18, 19. 05 2022, për tri ditë me këto shkolla: SHFMU “Ahmet Hajdari”, SHFMU “Dëshmorët e Vitisë”, SHFMU “Njazi Rexhepi”, SHML Gjimnazi “Kuvendi i

Lezhës”, SHML Profesionale “Januz Zejnullahu”, me 161 nxënës, të cilët kanë marr pjesë në testin PISA;

- Testi TIMS është mbajtur me nxënësit e klasës së katërt të SHFMU “Bafti Haxhiu”, me gjithsej 42 nxënës;
- Testi ICILS është mbajtur me nxënësit e klasës së tetë të SHFMU “Ndre Mjeda”, me gjithsej një klasë e tetë 22 nxënës;
- Testi i Arritshmërisë me nxënësit e klasës së nëntë këtë vit është mbajtur në dy pjesë. Pjesa e parë është mbajtur më 04.06.2022 dhe pjesa e dytë është mbajtur më 14.06.2022. Në këtë test kanë marrë pjesë 590 nxënës;
- Testi i Maturës është mbajtur më 18.06.2022, në katër qendra, ku morën pjesë 422 nxënës maturant dhe kalueshmëria është mbi 80 %;
- Janë mbajtur trajnime për ngritjen profesionale të mësimitdhënësve;
- Është fuqizuar roli i qendrave të karrierës në shkollat e mesme dhe praktikantët profesionale për nxënësit.

3. Shërbimi psikologjik

- Është bërë evidentimi i rasteve (nxënësve), të cilët kanë nevojë për shërbim psikologjik;
- Vazhdim i psikoedukimit me nxënës, duke përfshirë fusha të ndryshme;
- Administrimi i testeve psikologjike (vlerësimi psiko-fizik i pjekurisë për klasën e parë);
- Mbajtja e seancave psikoterapeutike. Nxënësit janë trajtuar me këshillim psikologjik; teknika biheviorale, psikoterapi pozitive, psikoterapi trupore, psikoterapi familjare etj.
- Punë e vazhdueshme me klasën e bashkëngjitur me nxënësit me nevojë të veçanta;
- Punë rreth parandalimit dhe braktisjes së shkollës;
- Takime me ekipin për vlerësim pedagogjik të nxënësve;
- Vlerësime pedagogjike për nxënësit me nevojë të veçanta arsimore;
- Takime me prindërit e fëmijëve që kërkojnë mbështetje psikologjike për fëmijët e tyre;
- Bashkëpunim me QPS-në;
- Bashkëpunim me zyrtarët nga Policia e Kosovës;
- Vizita nëpër shkollë;
- Prezantim në takime, punëtori dhe trajnime;
- Takime në MASHT;
- Organizimi, mbajtja e trajnimit për kurrikulën për të gjitha fushat për vitin shkollor 2022/23;
- Vlerësimi i dosjeve të mësimitdhënësve;
- Punë rreth recensimit të librave shkollor në bashkëpunim me MASHT-in;
- Ligjëratë me Policinë e Kosovës në kuadër të kampanjës “Së bashku kundër bullizmit”.

4. Sektori për Financa

- Brenda kësaj kohe kemi kryer obligimet nga viti 2021 në vlerë 113776.93€ (96758.00€ kapitale);
- Po ashtu janë kryer obligimet financiare për të gjitha furnizimet dhe mirembajtjen e objekteve shkollore, si: Të gjitha shkollat me kohë janë furnizuar me material higjienik, material hargjues, material pune për zyra sipas kërkesave të shkollave;

- Po ashtu në këtë sektor janë bërë edhe ndryshimet në regjistrat e pagave, si: Futja e punëtorëve të rinj në listat e pagave, largime, pagesa retroaktive, ndryshime tjera, ndërrimet e llogarive bankare për punëtorët etj;
- Furnizimi me inventar për shkollat “Safet Rexhepi”, “Dëshmoret e 5 Prillit” në “Kongresi i Manastirit”, “28 Nëntori”, “Nazmi Pajaziti”, “Bafti Haxhiu”, “Kenan Halimi”, “Mirali Sejdiu” Çerdhja “Gëzimi Ynë” dhe “Nijazi Rexhepi”, “Ahmet Hajdari” “Don Mikel Tarabolluzi” Dëshmoret e Vitisë “Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës”, “Dëshmoret e Lubishtës”, “Skender Emerllahu “, “Jonuz Zejnullahu “dhe “Hysen Terpeza “etj;
- Kemi bërë furnizimin e shkollave me lende djekse për vitin shkollor 2022/23, sipas kërkesave të shkollave, ku parashihet sasia prej 3250M/H;
- Kemi furnizuar Çerdhet me shporet elektrik industrial dhe rrobatharse;
- Kemi furnizuar shkollat me perde tepison sipas kërkesave të tyre;
- Kemi furnizuar gjitha shkollat me paralele të ndara me internet;
- Furnizimin e shkollave me pajisje për kabinete (projektor) në vlerë prej 37000.00€
- Është përgatitur korniza afatmesme buxhetore për vitet 2023-2025;
- Janë pranuar dhe shpërndarë listat e pagave dhe janë kompletuar me nënshkrime nga shkollat;
- Janë bërë pagesat e transportit për nxënësit me largësi nga shkollat fillore;
- Është bërë furnizimi me pajisje të imta, të nevojshme për shkollat dhe mirëmbajtja e tyre;
- Është bërë dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore.

5. Sektori për Administratë

Për këtë periudhë kohore në Sektorin për Administratë janë kryer një numër i madh i shërbimeve administrative dhe juridike. Gjithsej janë shqyrtuar mbi 1821 të natyrave të ndryshme:

kontrata, vendime, propozim - vendime, përgjigje në padi, kërkesa nga palët, përgjigje në kërkesa, pëlqime, njoftime të ndryshme, vërtetime, urdhëresa, autorizime, përfaqesime në gjykata.

Me kohë kemi kërkuar nga Zyra për Burime Njerëzore për të shpallur konkurse publik për kuadër arsimor për vendet e lira të punës dhe ndryshimet në listat e pagave, futjen në sistemin e pagesave i kemi bërë me kohë në fillim të ç’do muaji;

Kemi bërë një planifikim të mirë, pasi që të gjithë punëtorët arsimor janë të pajisur me kontrata të punës dhe të gjithë të punësuarit në Sektorin për Arsim janë të futur në sistemin e pagave;

Gjatë punës ky sektor gjithmonë ka parasysh parimin e efikasitetit në punë, me rastin e shqyrtimit të kërkesave, ankesave dhe veprimeve tjera procedurale, duke respektuar afatet ligjore.

6. Sfidat e paraqitura

- Fillimisht Pandemia dhe mësimi në distancë;
- Rënia e numrit të nxënësve dhe sfidat me formulën e financimit;
- Shkolla e Pozheranit “Halil Alidema”;
- Mungesa e sallave sportive për të zhvilluar lëndën e Edukimit Fizik gjatë sezonës së Dimrit;
- Obligimet e Kontratës Kolektive dhe vendimet e përmbareshve;
- Greva në muaj Shtator dhe mos fillimi i vitit të ri shkollor me kohë;
- Rënia e numrit të nxënësve.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit janë kryer të gjitha detyrat dhe obligimet në bazë të përgjegjësisë që i ka kjo drejtori sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të Republikës së Kosovës. Numri më i madh i kërkesave për vitin 2022 ka të bëjë me legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, afati për këtë proces është mbyllur me 04.09.2022, si dhe për informata urbanistike, kurse kërkesa për çështje të tjera ka pasur relativisht më pak.

Më poshtë keni një raport të shkurër për secilin sektor të DUPMM-së:

Sektori për Urbanizëm

Gjatë vitit 2022, në Sektorin për Urbanizëm kryesisht ka pasur aplikime për legalizim, kurse më pak për leje ndërtimore dhe kërkesa të tjera.

Leje ndërtimore Janar-Dhjetor 2022

Leje Ndertimore	Kategoria I	Kategoria II	Pelqime Urbanistike
1	1	/	2

Procesi I legalizimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022

Legalizime të objekteve pa leje ndërtimore sipas Ligjit Nr. 06/L-024

Aplikime	Cerifikat Legalizimi	Kategoria I	Kategoria II	Lista e Pritjes
103	36	23	/	5

Sektori për Planifikim

Në sektorin e planifikimit janë shqyrtuar 22 kërkesa të ndryshme

Kërkesa për dhënie të informatave urbanistike: Nga 11 kërkesa gjithsejt 11 të shqyrtuara, s'ka në proces.

- Informatë urbanistike me pagesë 6x60 euro = 60 euro.
- Informatë urbanistike të liruar nga pagesat, 5

Kërkesa për dhënie të kushteve urbanistike – ndërtimore, nga 11 kërkesa, gjithsejt 11 të shqyrtuara, s'ka në proces.

- Vendime për kushte të ndërtimit të aprovuara, 4;
- Vendime për kushte të ndërtimit të refuzuara, 3;
- 2 Pëlqime ne Parim;
- 2 Leje Ndërtim-Renovimi.

Sektori për Mjedis

- Gjatë vitit 2022 janë lëshuar 3 leje mjedisore komunale;
- Është bërë regjistri i objekteve të kategorizuara për leje mjedisore komunale;

- Viti 2022 nga Kryetari i Komunës është shpallur vit i ambientit;
- Shënimi i datave me rëndësi mjediorë, siç është “Dita e Tokës” më 22 Prilli dhe 5 Qershori apo “Dita e Mjedisit”;
- Jemi në përfundim të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal;
- Jemi në proces të hartimit të Planit të Veprimit Lokal në Biodiversitet;
- Eliminimi i 6 deponive të mëdha ilegale nëpër fshatrat. Në komunën tonë në sistem të menaxhimit të mbeturinave nga ndërmarrja “Ekohigjiena” janë të përfshira qyteti dhe 19 fshatra mbi 2000 klient të faturuar;
- Problem në vete janë fshatrat të cilat nuk janë nën sistemin e menaxhimit të cilat grumbullojnë mbeturinave e bëjnë në deponi të egra dhe vend e pa vend, të cilat paraqesin rrezik permanent të ndotjes mjedisore. Këto 6 muajt e fundit së bashku me Drejtorinë e Inspektionit dhe Shërbimeve Publike janë larguar 5 deponi të mëdha të “egra”, të krijuara në fshatrat Pozheran, Remnik, Beguncë, Smirë, Kabash si dhe në qytetin e Vitisë. Gjithashtu bashkë me Drejtorinë për Arsim, këshillat e fshatrave dhe shkollat fillore e të mesme, nëpër të gjitha lokalitetet e Komunës së Vitisë janë marrë aksione pastrimi nëpër rrugët dhe lagjet e këtyre vendbanimeve, janë mbjell bimë dekorative duke e zgjeru fondin e gjelbër në zonën urbane dhe në zonat rurale; dhe detyra e përgjegjësi të tjera që bien në kompetencat e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Ambientit.

Sektori për Adresa

Në Sektorin për Adresa gjatë kësaj periudhe kohore, në bashkëpunim me Agjensionin Kadastral të Kosovës (AKK-në) dhe komunën tonë, kemi përfunduar këto aktiviteteve:

- Kontrollimi i hyrjeve (numrave) dhe i tabelave me emra të rrugëve në sistemin ARIS dhe në terren, në afat çdo 3 muaj;
- Takime sipas nevojës dhe interesit me Agjensionin Kadastral të Kosovës (AKK), me qëllim të pëfitimit të ndonjë donacioni nga shteti norvegjez (BE) për vendosjen e numrave edhe në zonat rurale;
- Kemi pasur fatin të fitojmë përsëri donacion për vendosjen e numrave në të gjitha objektet e territorit të Komunës së Vitisë dhe kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi mes AKK-së dhe komunës sonë, ku nënshkrimi i kësaj marrëveshje është bërë në objektin e Komunës së Vitisë. Nga ana e AKK-së, prezent ishte zyrtari Berat Preniqi me bashkëpunëtorë, ndërsa nga ana jonë prezent ishin kryetari i Komunës sonë Sokol Haliti, nënkryetari Hasan Aliu, drejtori i Urbanizmit dhe Planifikimit, Visar Demiri dhe Sadat Sejdiu si zyrtar i adresave. Implementimi i kësaj marrëveshje dhe vendosja e numrave në terren është planifikuar nga AAK-ja së bashku me zyrën e adresave të komunës sonë, që të bëhet në mars të vitit 2023;
- Lëshimi i letrave informuese me numra të objekteve dhe emrave të rrugëve, qytetarëve që na i kërkojnë;
- Mbajtja e trajnimeve shtesë sipas interesit tonë dhe sipas kërkesës së AKK-së;
- Gjatë kësaj periudhe kemi bërë dy herë inspektimin e të gjitha tabelave me emra të rrugëve dhe me numra të objekteve në Komunën e Vitisë.

- Oragnizimi i 10 trajnimeve në bashkpunim me shërbimin këshillimor të MBPZHR-së
- Menaxhimi i fermave bujqësore, mbajtja e kontabilitetit dhe librave në ferma (këshilla praktike);
- Grumbullimi i të dhënave statistikore;
- Vizitë e të gjithë kombajnerëve rreth përgatitjes teknike të kombajnave dhe verifikimi i numrit të tyre, gjithsej në komunën tonë janë 100 kombajna;
- Takime me organizata të ndryshme, si: IKC, IADK, Fondacioni Kosovë Luxemburg, Caritasi Zvicrran, etj;
- Me datën 1 dhe 2 Gusht është mbajtur panairi i XI tradicional i organizuar nga Drejtoria për Bujqësi, GLV-Vitia dhe IKC, ku kanë marrur pjesë mbi 30 shoqata.

Të hyrat nga taksat komunale që i përkasin Drejtorisë për Bujqësi

Duke u bazuar në të hyrat që krijohen nga grumbullimi i taksave komunale nga domeni i bujqësisë, paraqitet kjo gjendje. Të hyrat nga:

- Ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore, 8,116.00 €;
- Vertetime për veprimtari bujqësore, 70 €;
- Të hyrat nga shitja e masës drunore të konfiskuar, 2,380.00 €.

Gjithsej të hyra, 10,566.00 €

Shqyrtimi i kërkesave të drejtuara përmes arkivit të komunës

Gjatë këtij viti nga arkivi i komunës kanë arritur gjithsej 160 kërkesa, prej tyre:

Të bartura nga viti paraprak	Të pranuar në vitin 2022	Të miratuara	Të refuzuara	Të hedhura poshtë	Të Pezulluara	Të Anuluara
/	160	150	4	2	1	2

Kurse sa i përket kërkesave që i drejtohen drejtorisë pa procedurë të arkivit, numri i tyre është i madh dhe kryesisht kanë të bëjnë me shqyrtimin e mundësisë së subvencionimit të kulturave bujqësore që kultivohen nga ana e tyre.

Investimet nga komuna dhe organizatat (donatorët) në fushën e bujqësisë gjatë vitit 2022

Komuna e Vitisë dhe Organizata IKC:

Komuna dhe Organizata IKC kanë shpërndarë 40 serra me sipërfaqe 50m² dhe mbulimi i tyre me foli plastike në participim prej 25% fermeri. Ky projekt ka qenë i vitit të kaluar, por i realizur në këtë vit. Përfituesë kanë qenë 40 fermerë të Komunës së Vitisë:

Komuna: 75 % 19,050.00€.

Fermerë: 25 % 6,350.00€.

Vlera e projektit: 25,400.00 €.

Komuna e Vitisë me Caritasin Zvicrran:

- Komuna e Vitisë me Caritasin Zvicrran kanë përkrahur fabrikën për përpunimin e perimeve “GRASEP” në Sllatinë të Epërme, me pajisjet: Pasterizator Tunel – kapaciteti 1000 kavanoza dhe makinë për etiketimin e produkteve – kapaciteti 1000 etiketa.

Komuna 25,000.00 €.

Caritasi Zvicrran 16,225.00 €.

Fermerë 7,275.00 €.

Vlera e projektit 48,500.00€.

Komuna e Vitisë me DBPZHR :

- Komuna e Vitisë me DBPZHR ka shpërndarë serra me sipërfaqe 50m2 dhe mbulimi i tyre me foli plastike, në participim prej 25% fermeri. Përfituesë 100 fermerë të Komunës së Vitisë

Komuna: 75 %, 52,125.00€.

Fermerët: 25%, 17,375.00€.

Vlera e projektit, 69,500.00€.

- Komuna e Vitisë me DBPZHR ka shpërndarë foli polietileni e zez për 50 fermerë të kësaj komune, që merren me kultivimin e shalqirit, pa participim të fermerëve.

Komuna 9,000 €.

Vlera e projektit 9,000 €.

- Komuna e Vitisë me DBPZHR ka shpërndarë motokultiavotorë për fermerët kultivues të perimkulturës, projekti ka qenë me participim të fermerit prej 20%.

Përfitues 50 fermerë të Komunës së Vitisë.

Komuna 80%, 14,380.00€.

Fermerët 20%, 3,595.00€.

Vlera e projektit 17,975.00€.

- Komuna e Vitisë me DBPZHR shpërndarë për 18 fermerë përfitues nga 5 koshere me bletë, ku gjithsej janë shpërndarë 90 koshere me bletë pa participim të fermerëve. Ky projekt ka qenë nga viti kaluar, por është realizuar këtë vit.

Komuna, 8,460€.

Vlera e projektit, 8,460€.

Po ashtu kemi bërë përzgjedhjen e 30 përfituesve me nga 5 koshere me bletë, ku gjithsej janë 150 koshere me bletë dhe fermerët kanë participuar 20% .

Komuna 80%, 11,880.00€.

Fermerët 20%, 2,970.00€.

Vlera e projektit 14,850.00€

- Drejtoria e Bujqësisë ka bërë shpërndarjen e 50 makinave mjelëse për lopë qumshtore, pa participim të fermerëve.

Komuna 10,720.00€.

Vlera e projektit 10,720.00€.

- Drejtoria e Bujqësisë ka bërë shpërndarjen e 40 inkubatorëve për qeljen e zogjëve, pa participim të fermerëve.

Komuna 6,880€.

Vlera e projektit 6,880€.

- Drejtoria e Bujqësisë ka bërë shpërndarjen e makinave spërkatëse 400 l, dhe përfituesë kanë qenë 60 fermerë të Komunës së Vitisë, dhe fermerët kanë participuar 20%.

Komuna 80%, 22,704.00€.

Fermerët 20%. 5,676€.

Vlera e projektit 28,380.00€.

- Drejtoria e Bujqësisë ka bërë shpërndarjen e makinave për shpërndarjen e plehut artificial dhe përfitues kanë qenë 50 fermerë të Komunës së Vitisë dhe fermerët kanë participuar **20%**.

Komuna 80%, 8,880€.

Fermerët 20%, 2,220€.

Vlera e projektit 11,100.00€.

- Drejtoria e Bujqësisë ka bërë shpërndarjen e makinave për rrotullimin e barit (grebuja), dhe përfitues kanë qenë 30 fermerë të Komunës së Vitisë dhe fermerët kanë participuar **20%**.

Komuna 80%, 16,680.00€

Fermerët 20%, 4,170 €

Vlera e projektit 20,850.00€

- Drejtoria e Bujqësisë gjithashtu ka bërë përzgjedhjen për 30 fermerë përfituesë për spërkatëse 40 L, pa participim të fermerëve, mirëpo shpërndarja do të realizohet gjatë vitit 2023.

Komuna 4,860€.

Vlera e projektit 4,860€.

Investimet e Komunës së Vitisë në infrastrukturën rrugore bujqësore dhe pastrimi i prrockave dhe kanaleve:

- Gjatë vitit 2022 janë rregulluar **9625m** rrugë bujqësore;
- Vlera totale është **152,736.1€**;
- Gjatë vitit 2022 janë pastruar rreth 7/km prrocka dhe kanale bujqësore;
- Vlera totale është rreth **30,000**.

Shuma e përgjithshme e investimeve në bujqësi nga Komuna dhe donatorët gjatë vitit 2022

INVESTUESI	SHUMA
Komuna e Vitisë dhe donatorët	269,595 .00€
Investimet e Komunës së Vitisë në infrastrukturën rrugore bujqësore	182,736.00€
Totali i investimeve për vitin 2022	452,331.00 €

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi

Në kuadër të DKPGJ-se ekzistojnë tre sektor:

- Sektori i Kadastrit
- Sektori i Pronës, dhe
- Sektori i Gjeodezisë

Sektori për Kadastër

Puna në Sektorin për Kadastër është e bazuar në dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë sektor, i cili është përgjegjës për kujdesen dhe mirëmbajtje të të gjitha regjistrave kadaslral, ku përfshihet e gjithë paluajtshmeria komunale, si dhe regjistri i paluajtshmerive, hipotekave, servituteve digjitale dhe manual, si shërbim kryesor për qytetarët si shërbimi me lëshimin e fletave poseduese, çertifikatave personale dhe social.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime :

Tabela nr.1 Shërbimet kadastrale 2022

	Lënda	Nr. l lëndve
1	Kontrata shitje	577
2	Kontrata falje	388
3	Trashigimi	164
4	Aktgjykime	41
5	Hipoteka	59
6	Lirim hipoteke	37
7	Kontrata këmbimi	12
8	Kontratë mbajtjes	3
9	Qiramarrje	4
10	Ndarje fizike	2
11	Korigjime	15
12	Vendime përmbarimi	3
13	Lëndë zyrtare	15
14	Bashkëpronësi	75
15	Të ndyshme	29
16	Përgjigjëje në kërkesa	24
	Gjithësejt:	1448

Shërbime tjera kadastrale:

FLETA POSEDUESE	KOPJE PLANI ME PAGES	NUK POSEDON PASURI	RASTE SOCIALI	FLETAPOSEDUSE ZYRTARISHT	KOPJE PLANI ZYRTARISHT	VETERAN	GJITHSEJT
3424	1096	93	1096	153	65	63	5990

Sektori për Pronë

- Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik në Zonën Kadastrale në Viti - parkingjet publike;
- Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale afatshkurtër përmes ankandit publik në Zonën Kadastrale në Devajë;
- Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale afatshkurtër përmes ankandit publik në Zonën Kadastrale në Smirë;
- Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale afatshkurtër përmes ankandit public, barnatorja në objektin e QKMF-së në Zonën Kadastrale në Viti.

Propozim vendimet për formimin e komisioneve:

- Propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për ankandin publik të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, parkingjet publike;
- Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës palujtshme të komunës në shfrytëzim në Zonën Kadastrale në Devajë;
- Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës palujtshme të komunës në shfrytëzim në zonën kadastrale në Smirë;
- Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës palujtshme të komunës në shfrytëzim, barnatores në Zonën Kadastrale në Viti;
- Për plotësimin ndryshimin e vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale me nr.01-110/05-100, të datës 01.03.2021 (parkingjet publike).

Propozim- vendimet për shpalljen me interes përgjithshëm :

- Propozim vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01-110/05-1067, të datës 28.09.2022, për shpalljen interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale në Zonën Kadastrale në Viti, Radivojc dhe Sllatinë;
- Propozim vendim për shpalljen interes të përgjithshëm Ngastrën Kadastrale me Nr.00002-3 në Zonën Kadastrale në Letnicë;
- Propozim vendim për shpalljen interes të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në Zonën Kadastrale në Sllatinë;
- 4. Propozim vendim për shpalljen interes të përgjithshëm Ngastrën Kadastrale me Nr.3765-1, në Zonën Kadastrale në Viti.

Propozim vendimet për caktim të lokacioni janë:

- Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekt të ambullantës në fshatin Gushicë;
- Propozim vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit të martirit, Milaim Tahiri në fshatin Gërmovë;
- Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhës së femijëve në Viti;
- Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekt të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti;
- 5 Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ngritjen e obeliskut "Madelein Albrght" në qytetin e Vitisë;
- Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për personat me aftësi të kufizuar në fshatin Pozheran;
- Propozim vendim për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash;
- Propozim vendim për shfuqizimin e Vendimit paraparak me Nr.01-110/05-477, të datës 04.05.2022, për shpalljen me interes të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në Zonën Kadastrale në Sllatinë;
- Propozim vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 01-110/05-110, të datës 01.02.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekt të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti;
- Propozim vendim për miratimin e listës së veçantë të pronave të palujtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2023;

Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë për gjatë vitit ka kryer këto shërbime për palët dhe Komunën, si ka: mirëmbajt kadastrën digjital në sistemin kosovare f01; ka përcjell vektorizimin e raster planeve; ka përgatit dhe mbikëqyrë të dhënat për kompanitë dhe gjeodetët e licencuar; ka përgatitë raportet ditore për Agjencinë Kadastrale të Kosovës; ka pranuar lëndët e kryera nga kompanitë dhe gjeodetët e licencuar dhe të njëjtat i azhurnon në sistemin zyrtar (Geomedia profesional 5.2); ka bërë azhurnimin e ndarjeve fizike në librat e regjistrimeve të ndarjeve kadastrale; ka bërë hartimin e kopjeve të planit; kontroll të vazhdueshme kualitetit të të dhënave grafike kadastrale dhe atyre tekstuale; projektim të rrjeteve referente; të rendit të tretë të shtruar me GPS; mirëmbajtje për rrjetat referente të rendit të tretë për tërë zonat kadastrale në kuadër të Komunës së Vitisë; identifikim i parcelave në zyrë; futja e të dhënave grafike në datamodelin zyrtar (Geomedia Professional & Geospro); konsulta dhe këshilla profesionale në lëmin e Gjeodezisë dhe Kadastrës për palët e interesuara në kuadër të shërbimeve kadastrale; ekspertiza kadastrale për nevoja të gjykatave.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime:

Bashkim parcelave	82 lëndë
Ri-rregullim kufiri	4 lëndë
Ndarje parcelave	281 lëndë
Historiate parcelave	1 lëndë
Ndërrim kulture	5 lëndë
Regjistrim banesave	6 lëndë
Gjithësejt:	379 lëndë

Nr.	Propozim - vendimet	sasia
1	Propozim vendime për dhënjën në shfrytëzim pronës komunale	4
2.	Propozim vendime për formimin e komisioneve për dhënjën në shfrytëzim pronës komunale	6
3.	Propozim vendime për shpalljen me interes ë përgjithshëm	4
4.	Propozim vendime për caktim lokacionit	7
5.	Propozim vendime për plotësim të vendimit	1
6.	Propozim vendime për shfuqizim të vendimit	1
7.	Propozim vendime për listen e veqant për dhënjën në shfrytëzim pronës komunale	1
	Gjimthsejt:	24 propozim vendime

Të hyrat financiare për 2022

Gjatë vitit 2022 Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi kemi arrit të tejkalojmë planifikimin e të hyrave financiare dhe të arrim të përmbushim një nga objektivat kryesore të punës së kësaj drejtorie.

Të hyrat e planifikuara për vitin 2022 kanë qenë 57,400.00 E

Të hyrat e realizuara në vitin 2022 janë 93,732.00 E

Të shprehura në përqindje realizimi ka qenë 163.3%

Në këtë drejtori gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 7841 kërkesa.

Sfidat

Pengesat të cilat i përcjell këta Sektor janë:

- Mungesa e shënimeve prej vitit 1985 – 1999;
- Lidhjet e dobëta digjitale në bazën e të dhënave dhe shpeshherë ndërprerja e tyre kohë pas kohe me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës;
- Mungesa e shënimeve gjeodezike nga viti 1985 – 1999;
- Mungesa e planeve/skicave për zonat kadastrale të cilat janë pjesë të komasacionit.

Propozim masat të cilat duhet të merren për efikasitet janë:

- Insistimi i faktorëve institucional vendor dhe ndërkombëtar tek institucionet e Serbisë për kthimin e shënimeve kadastrale dhe gjeodezike, respektivisht planeve gjeodezike;
- Insistimi i institucioneve vendore dhe i mekanizmave ndërkombëtar tek institucionet e Serbisë, për kthimin e dokumentacionit kadastral, të konfiskuar (grabitur gjatë luftës);
- Përpjekjet për përmirësimin e lidhjeve digjitale në bazën e të dhënave me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport

Në bazë të kompetencave që ushtron DKRS, ka kryer këto aktivitete:

Përkrahja e ansambleve dhe grupeve dhe shoqatave kulturore të cilat funksionojnë në Komunën tonë.

Subvencionet:

Nr.	AKV, SHKA & OJQ-të kulturore	Shuma
1.	SHKA "Jonuz Ramadani" -Smirë	€ 1,900.00
2.	OJQ -Qendra Kulturore "Anamorava"-Viti	€ 4,200.00
3.	AKV "Kemajl Azizi"-Viti	€ 5,000.00
4.	OJQ " Kori Qytetit"- Viti	€ 3,650.00
5.	Manifestimi tradicional Kulturo-shkencor takimet "Dom Mikelit"	€ 490.00
6.	OJQ – IMADNJ – Viti	€ 1,300.00
Totali:	-----	€ 16540.00

SHPËRNDARJA E BUXHETIT TE KLUBET SPORTIVE NË %




Tabela grafike tregon përqindjet e përfituesve bazuar në shumën e ndarë nga Komisioni Vlerësues prej 28,000€ Klubeve Sportive ose 56% nga shuma totale e buxhetit prej 50,000.€

Viti, Janar 2023

Kryetari i Komunes
Sokol HALITI

